



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale

Analizë e shpejtë gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale

**Analizë e shpejtë gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm
gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë**

Nga Ada Shima dhe Nicole Farnsworth

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë
2014

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2014

Autore: Ada Shima dhe Nicole Farnsworth

Përkthyer nga: Translation Company

ISBN 978-9951-8848-5-3

Printuar nga Night Design me printim ekologji

www.womensnetwork.org

MIRËNJOHJE

Autorët e këtij raporti, para së gjithash, dëshirojnë ta falënderojnë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pastaj përfaqësuesit e të gjitha departamenteve, drejtorive, dhe të organeve të tjera, si dhe Qendrat për Punë Sociale në nivel komunal, për gatishmërinë e tyre që ta fillojnë planifikimin buxhetor nga perspektiva gjinore. Kjo analizë u mundësua falë angazhimit aktiv të tyre përmes shkëmbimit të informatave dhe diskutimit të të gjeturave. Në veçanti, e falënderojmë ministrin Nenad Rašić dhe z. Nexhat Sylja për mbështetjen që i dhanë kësaj iniciative.

Po ashtu, i jemi mirënjohës projektit të GIZ-it për “Reformimin e Sistemit Publik Financiar”, të cilët i dhanë mbështetje këtij projekti. Edhe Dr. Elisabeth Klatzerna ka ofruar udhëzime të dobishme gjatë tërë kohës, për të cilat i jemi mirënjohës.

E falënderojmë Nerila Qarri-G rgrin, Donjeta Morinën, dhe Nikki Morin për ndihmën e dhënë në zhvillimin e hulumtimit, si dhe Ariana Qosaj-Mustafën për rishikimin e raportit.

Përmbajtja

AKRONIMET	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
HYRJE	7
Pse të bëhet një buxhetim i përgjegjshëm gjinor?.....	7
Relevanca e BPGJ-së në Kosovë	7
Metodologjia.....	9
Raporti	10
Korniza ligjore dhe politikat relevante.....	11
Barazia gjinore	11
Buxheti.....	11
Mirëqenia sociale.....	12
Prioritetet ministrore	13
Struktura organizatve e MPMS-së	14
Analiza gjinore e buxhetit dhe e shërbimeve të departamenteve, divizioneve dhe organeve të tjera të mpms-së.....	16
Këshilli i Përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare	16
Trupa ekzekutive e inspektoratit të punës.....	17
Divizioni për çështjet e trashëgimisë së trupave mbrojtëse të Kosovës.....	19
Departamenti për politika sociale dhe i familjes	19
Departamenti i familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	32
Departamenti i pensioneve.....	35
Departamenti për punë dhe punësim	43
Një analizë e shpejtë gjinore e kategorive kryesore të shpenzimeve	50
Pagat dhe mëditjet.....	50
Mallrat dhe Shërbimet.....	52
Komunalitë	52
Shpenzimet kapitale	52
Drejt së ardhmes: vlerësimet buxhetore 2015-2017	53
Këshilli i përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare	53
Trupa ekzekutive e inspektoratit të punës.....	53
Divizioni për çështjet e trashëgimisë së TMK-së	54
Departamenti për politika sociale dhe i familjes	54
Departamenti i familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	56
Departamenti i pensioneve.....	57
Departamenti për punë dhe punësim	61
Bibliografia	64
Shtojcat	69
Shtojca 1: Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor: Një uhdërrëfyes praktik për përdorues	69
Shtojca 2: Buxheti për financim të QPS-ve sipas komunave dhe përfituesit të shërbimeve sociale sipas gjinisë	72
Shtojca 3: Llojet e aftësimeve profesionale sipas QAP-ve në komunat përkatëse	75

AKRONIMET

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
APK	Administrata Pensionale e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
DAP	Divizioni për Aftësi Profesionale
DKMZP	Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Zyrave të Punësimit
DMS	Departamenti për Mirëqenie Sociale
DNS	Divizioni për Ndihma Sociale
DPP	Departamenti për Punë dhe Punësim
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes
DSHS	Divizioni për Shërbime Sociale
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
GIZ	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH</i>
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MAPL	Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NDI	Instituti Kombëtar për Demokraci
NPS	Ndërtesa e Përkohshme e Sigurisë
OJQ	Organizatë jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PATP	Politika Aktive e Tregut të Punës
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRP	Qendrat Rajonale të Punësimit
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
SAS	Skema e Asistencës Sociale
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SHPP	Shërbimi Publik i Punësimit
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZP	Zyra e Punësimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është strategji për integrimin e perspektivës gjinore në politikat ekonomike dhe në buxhetin qeveritar. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave në bazë të një analize gjinore në secilën fazë të planifikimit, programimit, dhe realizimit të buxheteve qeveritare. Andaj, një buxhet i këtillë nuk duhet të shihet si buxhet shtesë, por si një mënyrë më e mirë e planifikimit buxhetor, bazuar në informata më specifike sa i përket të dy gjinive që janë përfituese të politikave dhe buxheteve të ndryshme. Një qasje e suksesshme ndaj BPGJ-së siguron një analizë të hollësishme sa i përket ndikimeve të ndryshme ndaj burrave dhe grave që kanë politikat për gjenerimin e të ardhurave, si dhe ato për ndarjen e mjeteve financiare. Pabarazitë brenda një shoqërie mund të rriten ose zvogëlohen varësisht prej mënyrës se si ndahen fondet publike. Zbatimi i suksesshëm i qasjes së BPGJ-së në kuadër të buxhetit qeveritar mund ta rrit efikasitetin e ndarjes së mjeteve. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve i mundëson qeverisë të ndajë fonde të mjaftueshme për realizimin e rolit dhe të përgjegjësive të cilat i ka. Për më tepër, në qarkoren buxhetore 2014/01, drejt “rritjes së efektivitetit dhe transparencës së parasë publike”, institucionet janë inkurajuar t’i “ndajnë treguesit dhe masat që kanë të bëjnë me individë sipas burrave dhe grave”.

Kjo analizë gjinore përqipet t’i ndihmojë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që ta realizojë një gjë të këtillë, pra: vlerësimin dhe planifikimin e buxhetit të saj nga perspektiva gjinore. Për këtë qëllim, raporti ka nga një nënkapitull të veçantë për secilin prej departamenteve, divizioneve dhe organeve të kësaj ministrie. Të gjeturat kryesore dhe rekomandimet e raportit janë dhënë këtu në formë të përmbledhur.

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare mund të hartojë dhe të zbatojë standarde për licencimin e ofruesve të shërbimeve; të sigurohet që ka barazi gjinore në mesin e anëtarëve të Këshillit; dhe të sigurohet që strategjia e tij e komunikimit të ketë në fokus gratë dhe burrat; dhe t’i inkurajojë gratë që të aplikojnë për licencim për nivelet bazike, të mesme dhe të larta në proporcion të barabartë me burrat.

Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës mund të mbledhë të dhëna të detajuara sipas gjinisë sa i përket lëndimeve dhe vdekjeve që kanë të bëjnë me vendin e punës; ta rris nivelin e inspektimit për zbatimin e pushimit të lehonisë dhe të inspektimit të diskriminimit të mundshëm ndaj grave në vendin e punës; të sigurojë barazi të inspektorëve burra dhe gra për realizimin e inspektimeve; dhe ta monitorojë për së afërmi ndikimin që mund të ketë zvogëlimi i buxhetit tek gratë dhe burrat.

Divizioni për Çështjet e Trashëgimisë së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) mund t’i shqyrtojë nevojat unike të ish-luftëtarëve gra dhe burra në programet e ri-sistemimit dhe në strategjitë e komunikimit. Sigurimi i barazisë gjinore në kuadër të këtij divizioni mund ta lehtësojë ofrimin e shërbimeve, të cilat i përbushin nevojat e grave dhe të burrave.

Në vitin 2011-2013, pjesa më e madhe e përfituesve të shërbimeve sociale ishin burra (62-65%). Kjo nënkupton se Qendrat për Punë Sociale (QPS) kanë shpenzuar më shumë kohë dhe mjete për burra. Divizioni i Shërbimeve Sociale mund ta krijojë një tregues lidhur me numrin e përfituesve gra dhe burra për secilin lloj të shërbimit social prej të cilit përfitojnë, si dhe të sigurohet që strategjia e saj e komunikimit t’i përfshijë si gratë edhe burrat në mënyrë që të dy palët të jenë në dijeni për ekzistencën e këtyre shërbimeve.

Përveç tri strehimoreve, MPMS-ja i ka mbështetur me fonde të barabarta nëntë strehimore për persona që kanë përjetuar dhunë familjare dhe u janë ekspozuar trafikimit. Strehimoret nuk kanë numër të barabartë të klientëve. Kjo sugjeron që MPMS-ja mund ta shfrytëzojë buxhetin e vet për strehimore në mënyrë më efektive dhe më efikase, duke e bazuar financimin e tyre sipas numrit të klientëve që i shërbejnë, si dhe sipas një kosto të strehimoreve për secilin klient që pranon shërbime. Në kosto duhet të përfshihen shpenzimet

operative dhe ato për personel, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e strehimoreve. Nëse strehimoret marrin fonde prej burimeve të tjera, atëherë duhet të shihet se cili është qëllimi i një financimi të tillë (shih më poshtë). Fakti që nuk ka asnjë strehimore për burra është një formë e diskriminimit gjinor, pasi raportet policore sugjerojnë se ekziston dhuna edhe ndaj djemve dhe burrave.

Në shtëpi të personave të moshuar dhe në Institutin në Shtime jetojnë më shumë burra sesa gra. Në shtëpi të komunitetit jetojnë më shumë gra. Nuk ekziston ndonjë udhëzim i ndjeshëm gjinor për institucionet e shëndetit mendor, ndërsa ekzistojnë raporte të sulmit seksual dhe të formave të tjera të abuzimit kundër grave rezidente. Nevojiten më shumë hulumtime për t'i ushqyer me informata praktikatat buxhetore.

Shkalla e Skemës së Asistencës Sociale (SAS) nuk është përcaktuar sipas kushteve ekonomike në Kosovë. Ajo nuk i përmbush nevojat themelore të individit, dhe duhet të rritet në bazë të shportës minimale të ushqimit të indeksuar. Aktualisht, përderisa në njërin anë burrat si kryesues të ekonomive familjare përfitojnë më shumë fonde të asistencës (71%), në anën tjetër gratë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të ekonomive familjare dhe varen nga kjo asistencë (58%). Fakti që burrat e përfitojnë asistencën si "kryefamiljar" mund të çojë në diskriminim të disbursimit të fondeve për anëtarët e familjes, posaçërisht për gratë. Treguesit dhe aktivitetet e veçanta që pasqyrohen në buxhet mund ta synojnë rritjen e proporcionit të përfituesve gra të fondeve SAS.

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe i Invalidëve të Luftës e ka bërë ndarjen e përgjithshme të buxhetit në mënyrë të barabartë për përfituesit gra dhe burra. Megjithatë, nga ky fond kanë përfituar më shumë gra sesa burra. Burrat përfitojnë më shumë për person sesa gratë. Ndoshta kjo lidhet me kriteret e llojeve të ndryshme të beneficioneve, të cilat mund t'i privilegjojnë tërthorazi burrat. Gratë po ashtu mund të kenë informata lidhur me përfitimet të cilat mund t'i gëzojnë. Ato mund të informohen përmes aktiviteteve të ndryshme informative. Në buxhetin e vitit 2015 duhet të kihet parasysh kompensimi për personat, të cilët iu kanë nënshtruar dhunës seksuale gjatë luftës.

Sa i përket Departamentit të Administrimit të Pensioneve, kjo analizë gjinore sugjeron se me kalimin e viteve gratë marrin më shumë pensione se burrat. Megjithatë, gratë në mënyrë konstante kanë marrë më pak fonde se burrat. Kjo mund t'i atribuohet pjesërisht faktit se burrat përfitojnë aso lloje të pensioneve që janë më të larta në shumë (p.sh. Trepça, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Kontributi pensional bazë) sesa pensionet të cilat i përfitojnë gratë (p.sh. Pensioni bazë). Departamenti i Pensioneve mund të përpilojë tregues dhe të zhvillojë aktivitete të veçanta (p.sh. në strategjitë komunikuese) për t'i informuar gratë dhe për t'u siguruar që ato të informohen për të drejtat e tyre, e në veçanti gratë me aftësi të kufizuara, gratë e verbra, gratë të cilat kanë punuar në Trepçë, si dhe pranueset potenciale të kontributeve pensionale.

Në Zyrat për Punësim (ZP), të dhënat sugjerojnë se burrat përfitojnë më shumë sesa gratë prej shërbimeve të ofruara. Në pajtim me ligjin aktual të punës, beneficionet e pushimit të lehonisë, të cilat distribuohen prej ZP-ve, përbëjnë diskriminim ndaj burrave si baballarë, dhe se i pengojnë mundësitë e barabarta të grave për punësim. Përveç kësaj, përfitimet kanë qenë dukshëm më të vogla sesa që duhet të jenë sipas *anketave të tregut të punës*. Rishikimet e ligjit të punës për përfshirjen edhe të pushimit atësor, përmirësimi i qasjes ndaj kujdesit të fëmijëve, dhe realizimi i më shumë inspektimeve të punës mund të kontribuojnë në trajtimin e drejtë të këtyre çështjeve.

Sa i përket trajnimeve të ofruara nga Qendrat për Aftësim Profesional (QAP), ku kemi një numër pak më të vogël të grave sesa burra që marrin pjesë në trajnime, përqindja e grave, megjithatë, që marrin certifikata është paksa më e lartë sesa përqindja e burrave. Treguesit dhe aktivitetet e veçanta mund të kontribuonin në rritjen e numrit të grave pjesëmarrëse në trajnime.

Në përgjithësi, në kuadër të MPMS, kemi një përqindje më të madhe të buxhetit të pagave që shkon për burra krahasuar me gratë, gjë që përkon me numrin e punonjësve në këtë

ministri. Kjo varet në masë të madhe nga fakti se burrat, si tendencë, marrin rroga më të larta sesa gratë. Një pjesëmarrje më e barabartë e grave dhe burrave në të gjitha nivelet mund të kontribuonte në shpenzime më të barabarta nga aspekti gjinor, si dhe do të mund ta përmirësonte cilësinë e shërbimeve që u ofrohen klientëve gra dhe burra.

Duke u bazuar në analizën e kapitujve fillestar, kapitulli i fundit përfshinë vlerësime për ta plotësuar me informata buxhetin e vitit 2015, si dhe shpenzimet afatmesme 2016 dhe 2017. Po ashtu propozon riformulimin dhe shtimin e disa objektivave, treguesve, dhe aktiviteteve për trajtimin e pabarazive gjinore dhe të përmirësimit të mëtejshëm të barazisë gjinore.

HYRJE

PSE TË BËHET NJË BUXHETIM I PËRGJEGJSHËM GJINOR?

Buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është një strategji për integrimin e perspektivës gjinore në politikat ekonomike dhe në buxhetin qeveritar. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë sesi të përmirësohet barazia mes grave dhe burrave në bazë të një analize gjinore në secilën fazë të planifikimit, programimit, dhe realizimit të buxheteve qeveritare. Andaj, ky buxhet nuk duhet të shihet si buxhet shtesë, por si një mënyrë më e mirë e planifikimit buxhetor në bazë të informatave më specifike sa i përket të dy gjinive që janë përfituese të politikave dhe buxheteve. Një qasje e suksesshme e BPGJ-së i analizon ndikimet e ndryshme që mund të kenë tek burrat dhe gratë politikat për gjenerimin e të ardhurave dhe të ndarjes së mjeteve.

Pabarazitë brenda një shoqërie mund të rriten ose të zvogëlohen varësisht prej mënyrës se si ndahen shpenzimet publike. Zbatimi i suksesshëm i qasjes të BPGJ-së në kuadër të buxhetit qeveritar mund ta rrisë efektivitetin e ndarjes së mjeteve. Mund të ndihmojë në trajtimin e nevojave dhe interesave të ndryshme që i kanë burrat dhe gratë, dhe t'i përmbush këto nevoja në mënyrë më efikase. Për më tepër, zyrtarët për buxhet, departamentet për buxhet, dhe institucionet në nivel komunal dhe shtetëror mund ta shfrytëzojnë qasjen e BPGJ-së për të komunikuar më mirë dhe për t'i mbështetur nevojat e departamenteve të tyre për institucionet dhe palët e tjera, duke përfshirë Ministrinë e Financave.

Në vendet e tjera, integrimi i perspektivës gjinore në proceset buxhetore ka dëshmuar se e rrit transparencën, e rrit efektivitetin e shpenzimeve publike, si dhe e lehtëson monitorimin e realizimit të buxhetit. Anë e këndë botës janë marrë iniciativa të ndryshme nga perspektiva e BPGJ-së.¹ Ekzistojnë mundësi për të mësuar prej shumë praktikave të mira në vendet përreth, duke përfshirë Elbasanin në Shqipëri,² Maqedoninë, Bosnje dhe Hercegovinën, Serbinë,³ Berlinin në Gjermani, si dhe Austrinë.

RELEVANCA E BPGJ-SË NË KOSOVË

Në Kosovë, BPGJ-ja mund të jetë tejet e dobishme për qeverinë për rritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të shpenzimeve. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit janë me rëndësi duke i pasur parasysh burimet e kufizuara të Kosovës. Në fakt, tash së voni, Banka Botërore ka rekomanduar:

Duke i pasur parasysh mungesat e dokumentuara mirëfilli të shërbimeve publike në Kosovë, atëherë kërkohet një përmirësim i cilësisë së shpenzimeve publike – një përmirësim në efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike e jo zvogëlimin e sasisë apo të cilësisë së shërbimeve.⁴

BPGJ-ja mund ta përmirësojë cilësinë e shpenzimeve publike, duke i vënë në pah dhe duke ndihmuar në trajtimin e boshllëqeve të mundshme.

¹ Për shembuj nga vende të ndryshme, shih Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), *Overview of gender-responsive budget initiatives*, the ILO Bureau for Gender Equality, 2006, në:

http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/publication/wcms_111403.pdf.

² Ministria e Financave e Shqipërisë, *Gender Responsive Budgeting Initiatives, Manual*, UNDP Shqipëri.

³ UNIFEM, *GRB South Eastern European Experiences*, 2010.

⁴ World Bank, *Kosovo Public Expenditure Review*, Report No. 53709-XK, Poverty Reduction and Economic Management Unit, 2010.

Shpenzimi më efikas dhe më efektiv i mjeteve ekzistuese shtetërore është me rëndësi themelore që të sigurohet zbatimi i ligjeve dhe i politikave në Kosovë. Ekzistojnë një varg ligjesh dhe planesh veprimi për zbatimin e të cilëve ka pasur mungesë të buxhetit.⁵ Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në shpenzime i mundëson qeverisë që të ndajë fonde të mjaftueshme për realizimin e rolit dhe të përgjegjësive të veta. Në vitet e fundit, disa partnerë ndërkombëtarë kanë ofruar trajnime për komuna dhe për disa zyrtarë të ministrive lidhur me BPGJ.⁶ Qeveria e Kosovës i ka ndërmarrë disa iniciativa lidhur me BPGJ-në. Në nëntor të vitit 2012, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka organizuar një konferencë ndërkombëtare, e cila synonte (1) ofrimin e informatave për praktikën më të mira që kanë të bëjnë me BPGJ, si dhe zgjerimin e njohurive lidhur me BPGJ në nivelin lokal dhe qendror; dhe (2) shkëmbimin e instrumenteve dhe udhëzimeve se si të zbatohet BPGJ-ja në nivelin lokal.⁷ ABGJ-ja e ka propozuar edhe rishikimin e ligjit aktual për barazi gjinore, i cili do t'ju kërkonte institucioneve ta përvetësonin një qasje të BPGJ-së në politikën e tyre zhvillimore. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në vitin 2015.

Në ndërkohë, në qarkoren buxhetore 2014/01, për "rritjen e efektivitetit dhe transparencës të shpenzimit të parasë publike", Ministria e Financave i ka inkurajuar institucionet që t'i "ndajnë treguesit dhe masat lidhur me individët sipas grave dhe burrave". Në të ardhmen e afërt dhe duke i pasur parasysh këto zhvillime, mund t'u kërkohet nivelit qendror dhe lokal që të shkojnë përtej diskutimit të BPGJ-së dhe *ta bëjnë* atë, në të vërtetë, pjesë të proceseve të tyre buxhetore.

Ministria e Financave dhe MPMS-ja kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përfshirjen e një perspektive gjinore në kuadër të objektivave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitet 2015-2017. Kjo analizë e shpejt gjinore përpiket që t'i avancojë këta hapa të rëndësishëm, duke ofruar të dhëna që do të shërbejnë për planifikimin e ardhshëm afatmesëm prej një perspektive gjinore, si dhe do ta mbështet MPMS-në për përgatitjen e buxhetit të MPMS-së për vitin 2015. Të dhënat në këtë raport mund ta ndihmojnë zbatimin e kapitullit të KASH-it për MPMS-në, duke e përkrahur përkufizimin e treguesve të ndjeshëm gjinor. Analiza gjinore është e rëndësishme për themelimin e treguesve të qartë dhe të veçantë të performancës, të cilët mundësojnë monitorimin e progresit në përmirësimin e barazisë gjinore, si dhe të rritjes së efektivitetit dhe transparencës në shpenzimin e fondeve publike.

Kjo analizë gjinore e MPMS-së ka për synim ta ndihmojë ministrinë në vlerësimin dhe planifikimin më të mirë të buxhetit të saj nga perspektiva gjinore. MPMS-ja u zgjodh në mesin e ministrive të tjera të qeverisë së Kosovës për ta pilotuar BPGJ-në, duke e pasur parasysh mandatin e saj ligjor dhe ndikimin që ka tek një pjesë e madhe e popullsisë së Kosovës (p.sh. pensionistët, përfituesit e ndihmave sociale, të mbijetuarve të dhunës familjare, etj.). Një analizë gjinore në këtë ministri mund ta ketë ndikimin më të madh në jetën e burrave dhe të grave të vendit. MPMS-ja u përzgjedh gjithashtu duke e pasur parasysh faktin e mbledhjes së statistikave mjaft gjithëpërfshirëse dhe të ndara sipas gjinisë nga ana e saj, e që e ndihmon analizën si pjesë e BPGJ-së. Mbase me më rëndësi është se kjo analizë pilote ka ndodhur në kuadër të MPMS-së falë vullnetit politik të ministrit Nenad Rashed dhe shërbyesve civilë të kësaj

⁵ Për shembull, hulumtimi i vitit 2012 i RrGGK e ilustron përkushtimin e qeverisë për mbrojtjen, rehabilitimin dhe integrimin e grave dhe fëmijëve të cilët kanë vuajtur nga dhuna familjare nuk mund të përmbushen në kuadër të KASH-it aktualë (RrGGK, *Me çfarë çmimi? Alokimi buxhetor për zbatimin e kornizës ligjore kundër dhunës në familje në Kosovë*, Prishtinë: UNDP, 2012, f. 1).

⁶ UN Women, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Helvetas, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Instituti Kombëtar për Demokraci (NDI), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), dhe Zhvillimi dhe Bashkëpunimi Zvicëran (SDC) kanë ofruar që të gjitha trajnime në BPGJ.

⁷ Konferenca Ndërkombëtare: "Buxhetimit e përgjegjshëm gjinor: sfidat dhe praktikën," 2011, në: <http://helvetas-ks.org/wp/wp-content/uploads/2011/10/GRB-Conference.pdf>.

ministrie, të cilët ishin të interesuar që të bashkëpunonin me *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH* dhe Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) në përfshirjen e BPGJ-së në procesin buxhetor.

Për fund, BPGJ-ja nuk duhet të jetë një proces i padobishëm dhe të praktikohet vetëm njëherë. Mirëpo, analiza e përshkruar këtu duhet të integrohet në proceset e buxhetit aktual. Edhe ministritë e tjera mund t'i përdorin metodat e zbatuara si dhe mësimet e nxjerra nga kjo përvojë në aplikimin e BPGJ-së.

METODOLOGJIA

Ky raport është rezultat i një analize të shpejtë gjinore të MPMS-së, duke iu referuar KASH-it të mëparshëm, dhe duke e përfshirë edhe buxhetin e planifikuar dhe shpenzimet aktuale buxhetore të vitit 2011 deri 2013. Kur informatat ishin në dispozicion, në këtë raport janë përfshirë edhe shpenzimet gjatë tremujorit të parë të vitit 2014. Raporti i përfshinë dy hapat e parë të metodologjisë së BPGJ-së që janë hartuar nga RrGGK dhe një eksperte ndërkombëtare për BPGJ, Dr. Elisabeth Klatzer, me mbështetjen e GIZ (shih aneksin I). Këtu përfshihet edhe shfrytëzimi i analizës gjinore për të shërbyer si informacion për krijimin e treguesve specifik që mund të futen në dokumentet buxhetore në vitet e ardhshme, dhe në mënyrë të veçantë në vitin 2015.

Kjo analizë gjinore u realizua si hap i parë në procesin e BPGJ-së. RrGGK filloi me analizimin e përgjegjësive ligjore të ministrisë, duke e përfshirë secilin departament. Pas kësaj analize të dokumenteve, janë mbajtur një varg takimesh me secilin departament në kuadër të MPMS-së me qëllim që të mblidhen statistika sipas gjinisë. Në bazë të kornizës ligjore dhe politikave aktuale, ky raport ka analizuar numrin e grave dhe burrave, të cilët kanë përfituar prej programeve të veçanta që janë ofruar nga secili departament dhe divizion. Analiza fillestare e përhapjes ka ndihmuar në identifikimin e dallimeve në numrin e pjesëmarrësve gra dhe burra në një program apo që kanë përfituar prej tij. Hapi tjetër ishte përlllogaritja e shumës së shpenzimeve buxhetore të cilat i kanë përfituar burrat dhe gratë. Kjo shërbeu si bazë për analizat e bëra për të shikuar nëse ekzistonte ndonjë hendek në mënyrën se si kanë kontribuar shpenzimet në rritjen e barazisë mes grave dhe burrave.

Kapitulli i fundit i këtij raporti ofron një vlerësim për buxhetin e vitit 2015, si dhe një parashikim për periudhën afatmesme të vitit 2016-2017. Vlerësimet janë bazuar në trendet e mëparshme të përfituesve të programeve të identifikuar përmes analizës gjinore, trendeve gjeografike kur dihetin këto të dhëna, dhe të hulumtimit ekzistues, duke përfshirë edhe bërjen e analizave të kostos dhe indeksimit.⁸ Ato mund të shfrytëzohen në vitin e ardhshëm për ta furnizuar me informata KASH-in për vitin 2016-2018. Vlerësimet e tilla, të bazuara në hulumtime, janë me rëndësi të veçantë dhe çojnë në shpenzime më efikase dhe më efektive. Kur këto bazohen edhe në analiza gjinore, ato mund të ndihmojnë përparimin drejt arritjes së objektivave afatmesme që kanë për synim përmirësimin e mëtejshëm të barazisë gjinore. Ky raport i shfrytëzon të gjeturat për formulimin e rekomandimeve për secilin departament në mënyrë që të përmirësohet barazia gjinore.

Gjatë tërë procesit janë bërë konsultime me të gjitha departamentet e MPMS-së. Shefi i departamentit për buxhet e financa u caktua si personi kryesor kontaktues në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e procesit. Në të ardhmen shabllonet e përpiluara për mbledhjen e të dhënave mund të përdoren për planifikime buxhetore të cilat bazohen në mbledhje të informatave.

Duke e pasur parasysh se kjo është një analizë e përshpejtuar gjinore, raporti nuk i ka përfshirë të gjitha të dhënat e MPMS-së që kanë qenë në dispozicion. Për shembull, disa të dhëna të vitit 2011 nuk janë regjistruar në bazën e të dhënave të krijuar pas vitit 2011. Po

⁸ UNDP-ja dhe Banka Botërore e kanë bërë indeksimin e shportës minimale ushqimore. Ky raport bazohet edhe në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

ashtu, nuk ka mjaftuar koha që të analizohen të dhënat ekzistuese në bazë të treguesve demografikë, si mosha, përkatësia etnike, apo vendndodhja gjeografike. Metodologjia e përdorur mund të shfrytëzohet në të ardhmen për analizimin e shpenzimeve për grupe të tjera të veçanta. Analiza e realizuar për ta plotësuar me informata procesin e planifikimit buxhetor nuk duhet doemos të kufizohet vetëm në të dhëna gjinore. Kjo analizë është kryesisht kuantitative. Duhet të plotësohet me analiza kualitative, posaçërisht kur kemi të bëjmë me grupe të caktuara përfituese me qëllim që të mësojmë më shumë për nevojat e tyre, për preferencat dhe sa janë të kënaqur me shërbimet e ofruara. Realizimi i një analize të tillë do të përbënte një hap më tutje për MPMS-në karshi planifikimit të buxhetit dhe të përcaktimit të treguesve sipas informatave që dalin nga hulumtimet.

Përveç kësaj, ky raport e analizon vetëm buxhetin e shpenzuar nga MPMS-ja. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar prej ministrive dhe komunave të tjera, duke përfshirë edhe zbatimin efektiv të programeve dhe shërbimeve të MPMS-së, nuk janë të përfshira në këtë raport. Duke i pasur parasysh kategoritë e shpenzimeve që i përdor MPMS-ja në planifikimin buxhetor për programet dhe nën-programet e saja del se disa departamente nuk kanë të dhëna për buxhetet. Këtu përfshihet Divizioni për Shërbime Sociale, Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar, Divizioni për Aftësi Profesionale, dhe Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Zyrave të Punësimit. Për ta përlogaritur buxhetin e shpenzuar prej secilit departament do të na nevojitej më shumë kohë dhe kjo mund t'u mbetet analizave të tjera më vonë.

RAPORTI

Pas një përshkrimi të shkurtër të kornizës ligjore dhe të politikave aktuale, raporti merret me secilin departament dhe divizion, mandatin e tyre ligjor, përfituesit, si dhe buxhetin e tyre nga perspektiva gjinore. Këtu janë përfshirë, ku ka qenë e mundur, edhe rekomandimet për hapat e mundshëm që secili departament ose divizion mund t'i ndërmerret për ta përmirësuar edhe më tej barazinë gjinore. Raporti pastaj merret shkurtimisht me diskutimin se në çmasë janë shpenzuar kategoritë e përgjithshme të shpenzimeve të MPMS-së, si për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, dhe shpenzime kapitale. Në kapitullin e fundit, autorët bazohen në analizën gjinore të bërë në kapitujt paraprak për ta bërë një vlerësim të buxhetit për vitin 2015-2017, si dhe i propozon treguesit potencialë për përmirësimin e barazisë gjinore për dokumentet buxhetore. Aneksi I e shpjegon metodologjinë që mund të përdoret si instrument i BPGJ-së në të ardhmen.

KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKAT RELEVANTE

BARAZIA GJINORE

Kosova e ka krijuar kornizën ligjore si dhe i ka themeluar disa mekanizma për barazinë gjinore. Kosova e ka deklaruar përkushtimin e saj ndaj konventave ndërkombëtare lidhur me barazinë gjinore, duke përfshirë edhe “Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave” (CEDAW)⁹, si dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁰ Këto marrëveshje ndërkombëtare, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, aplikohen drejtpërdrejtë në Kosovë.¹¹ Kushtetuta e Kosovës e garanton barazinë gjinore si dhe ofrimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha fushat e jetës.¹²

Ligji Kundër Diskriminimit nr. 2004/3 garanton trajtim të barabartë të njerëzve të gjinive të ndryshme, si dhe i parandalon të gjitha format e diskriminimit.¹³ Ligji për Barazi Gjinore përcakton udhëzime dhe përgjegjësi të qarta për promovimin dhe mbrojtjen e barazisë gjinore.¹⁴ Ligji e institucionalizon barazinë gjinore si “vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë kosovare, duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore”.¹⁵ Politikat duhet ta kenë parasysh aspektin gjinor, duke përfshirë edhe buxhetet.¹⁶ Si qeveria, ashtu edhe komunat, mund të ndër marrin masa të veçanta për përmirësimin e barazisë gjinore dhe krijimin e mundësive të barabarta,¹⁷ të cilat mund të përfshihen në kuadër të dokumenteve buxhetore.

Sa i përket mekanizmave institucionalë, ABGJ-ja luan një rol të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e barazisë gjinore. Është një agjenci ekzekutive, përgjegjëse për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e ekonomisë, politikës, dhe jetës shoqërore. Zyrtarët për barazi gjinore funksionojnë si në nivel komunal ashtu edhe atë ministror.

Përderisa korniza ligjore dhe e politikave përpiqet të sigurojë trajtim të barabartë të burrave dhe grave në shoqëri, problematike mbetet mbikëqyrja dhe zbatimi i duhur i këtyre instrumenteve.

BUXHETI

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, qeveria e propozon buxhetin,¹⁸ ndërsa Kuvendi i Kosovës e miraton atë.¹⁹ Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë,

⁹ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, në:

<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>.

¹⁰ Këshilli i Evropës, Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Romë: 1950.

¹¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Prishtinë; 2008 në:

<http://www.kushtetutakosoves.info/?cid=2,247>, neni. 22.

¹² Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni. 7.

¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji kundër diskriminimit, ligji nr. 2004/3*, Prishtinë; 2004, në:

http://www.unmikonline.org/regulations/2004/re2004_32ale04_03.pdf.

¹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për barazi gjinore, ligji nr. 2004/2*, Prishtinë; 2004, në:

<http://www.womensnetwork.org/documents/20130510160346132.pdf>, neni 2.1.

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Ibid., Neni. 1.4.

¹⁷ Ibid., Neni. 4.8 dhe 4.14.

¹⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 2008, Neni. 92.

njësia e buxhetit qendror në kuadër të departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave e ka autoritetin për përgatitjen e projektbuxhetit të konsoliduar, përgatitjen e KASH-it, dhe zbatimin e buxhetit.²⁰ KASH-i është dokumenti kryesor planifikues i politikave ekonomike qeveritare. Qeveria e Kosovës e harton KASH-in në pajtim me vizionin e saj të zhvillimit të shtetit, që përfshinë rritjen e qëndrueshme ekonomike, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, zhvillimin e kapitalit njerëzorë, dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.²¹ Kapitulli i MPMS-së në KASH-in aktual e inkurajon mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë për ta furnizuar me informata përkufizimin e treguesve të ndjeshëm gjinor.

Ligji për “Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014” është miratuar.²² Në pajtim me *Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë*, ministri i Financave është përgjegjës për nxjerrjen e qarkores buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore, duke përcaktuar udhëzime për përgatitjen e buxhetit të Kosovës.²³ Në qarkoren buxhetore 2014/01, për “rritjen e efektivitetit dhe transparencës të shpenzimit të parasë publike”, institucionet janë inkurajuar që t’i ‘ndajnë treguesit dhe masat që kanë të bëjnë me individë sipas gjinisë’.²⁴

Projekt-KASH-i e ka krijuar bazën për buxhetin e ri të MPMS-së për vitin 2015-2017. Buxheti është harmonizuar me vendimin e qeverisë 01/176 në mars të vitit 2014.²⁵ Në pajtim me këtë vendim është rritur skema pensionale për vitin 2015 e më tej. Përveç kësaj, brenda kornizës kohore të KASH-it, MPMS-ja planifikon të themelojë dhe ta funksionalizojë Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës me një fond shtesë prej 86,000 eurosh në vit.²⁶ Të gjitha planet e tjera të MPMS-së mbesin në formën e njëjtë sipas të dhënave të vitit 2014.

MIRËQENIA SOCIALE

Një sërë ligjesh dhe udhëzimesh administrative e rregullojnë sistemin e mirëqenies sociale në Kosovë. MPMS u themelua në vitin 2000 përmes rregullores së UNMIK-ut 2000/24. MPMS-ja është kryesisht përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të punës dhe punësimit, si dhe për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në pajtim me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.²⁷ Hartimi i politikave të mirëqenies sociale dhe zbatimi i legjislacionit në këtë fushë është po ashtu përgjegjësi e MPMS-së. Sipas rregullores nr. 02/2011 për fushën e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive, MPMS-ja

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 2008, neni 65, para. 5.

²⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë*, ligji nr. 03/L-048, Prishtinë; 2003, në: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56. neni. 5.

²¹ Ibid. Neni 19.

²² Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014*, ligji nr. 04/L-233, Prishtinë; 2013, në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20budget%20of%20Kosovo%202014.pdf>

²³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë*, ligji nr. 03/L-048, neni. 20.

²⁴ Republika e Kosovës, Ministria e Financave, *Qarkorja buxhetore 2014/01*, Prishtinë: 2014, f. 7.

²⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi i Qeverisë 01/176, 2014, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_176-te_te_Qeverise_2014.pdf.

²⁶ KASH 2015-2017, Kapitulli i MPMS.

²⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare*, ligji nr. 02/L-17, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2005, në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf, Neni. 2.2.

ka kompetenca dhe përgjegjësi për hartimin, zbatimin, dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e politikave të punës dhe të mirëqenies sociale, në mënyrë jo diskriminuese.²⁸

Që prej vitit 2009, pushtetet lokale e kanë marrë përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve sociale në pajtim me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.²⁹ Kjo rregullohet më tej përmes Memorandumit të Mirëkuptimit për “Decentralizimin e Shërbimeve të Mirëqenies Sociale” të nënshkruar nga MPMS-ja dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.³⁰ Qendrat për Punë Sociale (QPS) funksionojnë në nivel komunal dhe i raportojnë drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve sociale dhe financimi i tyre mbetet mjaft i centralizuar, kryesisht nën kompetencat e MPMS-së.³¹

Sistemi për mbrojtjen sociale në Kosovë është një rrjet social për njerëzit në nevojë, i cili përbëhet prej sigurimit social, asistencës sociale për grupe të caktuara, programe të tjera të vogla që u dalin në ndihmë grupeve të rrezikuara, dhe të asistencës sociale në formën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Rregullorja e MPMS-së nr. 30/2013 për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të punëve në kuadër të MPMS-së e parashikon transformimin e Departamentit të Mirëqenies Sociale (DMS) në Departament për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), i përbërë prej Divizionit për Politika Sociale, Divizionit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale, Divizionit për Shërbime Sociale, Divizionit për Ndihma Sociale dhe Divizionit për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar. Këto ndryshime janë duke vazhduar edhe më tej. Një Shtëpi për Personat e Moshuar në Prishtinë, dy Shtëpi Rajonale të Komunitetit (Skenderaj dhe Istog), Instituti Special në Shtime, dhe shtatë shtëpi të komunitetit për njerëz me nevoja të veçanta ekzistojnë në nivel rajonal.³² Në vitin 2014, u hap një shtëpi e re e komunitetit në Graçanicë.

MPMS-ja, së bashku me komunat, është përgjegjëse për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes sociale. Në seksionin më poshtë janë dhënë informata më të hollësishme për përgjegjësitë ligjore të secilit divizion dhe departament.

PRIORITETET MINISTRORE

Vizioni i qeverisë së Republikës së Kosovës dhe MPMS-së për vitin 2020 është “që Kosova të jetë një shoqëri ku garantohet mbrojtja dhe përfshirja sociale e çdo qytetari të cilësdo kategori sociale dhe moshe, në mënyrë që të kenë një jetë me dinjitet shoqëror dhe ekonomik, ku të gjithë njerëzit e moshës së punës dhe të aftë për punë janë të trajnuar dhe kanë mundësi të barabartë të punësimit.”³³ MPMS-ja synon të punojë për përmbushjen e këtij vizioni, duke i arritur këto objektiva strategjike gjatë periudhës 2014-2020:

- (1) rritja e punësimit, zhvillimi i shkathtësive dhe funksionimi i përmirësuar i tregut të punës;
- (2) rritja e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë grupet e rrezikuara;
- (3) zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm pensional dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për realizimin e të drejtave për beneficione dhe shërbime më të mira për

²⁸ Rregullorja Nr. 02/2011 mbi Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtina, 2005, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miratur nga_Qeveria-finale.pdf.

²⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Art. 1.*

³⁰ HMO Solutions, *Social Services in Kosovo: Legal and Budget Assessment*, Save the Children Alliance in Kosovo, në: http://resourcecentre.savethechildren.se/sites/default/files/documents/2007_august_social_services_in_kosovo_legal_and_budget_assesment_report1.pdf.

³¹ Ibid.

³² MPMS, *Strategjia sektoriale 2009-2013*, 2009, at: <https://mpms.rks.gov.net/Portals/0/Aktiviteti%20javor/Strategjia%20Sektoriale%20MPMS-se%202009-2013%20Ang.pdf>.

³³ MPMS, *Strategjia sektoriale 2014-2020*, Prishtinë: janar 2014.

pensionistët dhe kategoritë e luftës, dhe (4) forcimi i rolit të partnerëve socialë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike të vendit, përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët dhe reduktimin e punësimit joformal.

KASH 2015-2017 i përgatitur nga MPMS-ja i paraqet po ashtu objektivat specifike të cilat i trajtojnë nevojat e ndryshme të grave dhe të burrave.


Në strategjinë sektoriale, analiza e nevojave përmban të dhëna të detajuara nga aspekti gjinor. Megjithatë, kjo analizë nuk u reflektua në objektivat strategjike. Objektivat strategjike duhet t'i kenë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, si: 1) rritja e punësimit të **grave dhe burrave**, zhvillimi i shkathtësive dhe funksionimi më i mirë i tregut të punës, (2) rritja e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë grupet e rrezikuara **dhe barazinë gjinore**, (3) zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm pensional dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për realizimin e të drejtave për beneficione dhe shërbime më të mira për pensionistet **gra dhe burra**, dhe kategoritë e luftës, (4) forcimi i rolit të partnerëve socialë në hartimin e politikave socio-ekonomike të vendit, duke i përmirësuar kushtet e punës për punonjësit dhe zvogëlimin e punësimit joformal **tek gratë dhe burrat**. Për më tepër, mënyra se si janë formuluar objektivat strategjike në KASH dallojnë prej formulimit në strategjinë sektoriale të MPMS-së. MPMS-ja duhet të sigurohet që këto të harmonizohen.

Me qëllim të monitorimit adekuat të progresit do të ishte e dobishëm po që se strategjia do të përmbante tregues të veçantë për gratë dhe burrat. Të gjithë treguesit e përdorur për vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave strategjike duhet të ndahen sipas gjinisë. Përveç kësaj, do të ishte e dobishme që të përfshihen edhe tregues të tjerë relevantë gjinorë për trajtimin e mangësive kryesore gjinore, të cilat janë identifikuar përmes analizës gjinore. Treguesit e tillë në të ardhmen do ta ndihmojnë MPMS-në që ta përmirësojë në vazhdimësi vlerësimin buxhetor, të hartojë politika të reja, të realizojë hulumtime të bazuara në informata, të zhvillojë aktivitete të bazuara në nevoja për arritjen e objektivave të veta, t'i zbatojë më me efikasitet aktivitetet aktuale, dhe ta matë progresin e përmbushjes së objektivave.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E MPMS-së

Edhe pse struktura organizative e MPMS-së ka ndryshuar në vitin 2014, MPMS-ja nuk i ka pasqyruar ende këto ndryshime në dokumentet buxhetore të saj. Aktualisht, MPMS-ja i ka shtatë departamente (shih figurën 1): Departamentin për Punë dhe Punësim (DPP), Departamentin për Politika Sociale dhe i Familjes (DPSF), Departamentin e Pensioneve, Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës, Departamentin e Integriteteve Evropiane dhe Koordinim të Politikave, Departamentin Ligjor, dhe Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Divizionet në kuadër të secilit departament i raportojnë drejtpërdrejtë shefave të departamenteve. Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës vepron si organ i veçantë, i cili i raporton drejtpërdrejtë ministrit. Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare vepron si organ i pavarur, por i raporton ministrit.

Figura 1. Organogrami i MPMS-së



ANALIZA GJINORE E BUXHETIT DHE E SHËRBIMEVE TË DEPARTAMENTEVE, DIVIZIONEVE DHE ORGANEVE TË TJERA TË MPMS-SË

Ky kapitull merret me analizimin veç e veç të secilit departament, divizion, dhe organ në kuadër të MPMS-së në pajtim me vijat buxhetore të buxhetit të Kosovës. Për secilin është ndarë një nën-seksion, duke përfshirë edhe një përmbledhje të mandatit të tyre ligjor. Më pas bëhet analiza gjinore e përfituesve të tyre gjatë periudhës së KASH-it të mëparshëm, pra për vitin 2011 deri 2013. Aty ku ka qenë e mundur, janë ofruar të dhëna për tremujorin e parë të vitit 2014 (mars). Analiza gjinore e përfituesve u përdor për t'i parë shpenzimet e bëra për burra dhe gra deri në periudhën e përmendur. Kjo mundëson identifikimin e diskriminimit të mundshëm gjinor në programe dhe në shpenzimet buxhetore. Kjo analizë më pas përdoret për nxjerrjen e rekomandimeve për trajtimin e diskriminimit gjinor dhe përmirësimin e barazisë gjinore si në programe ashtu edhe në planifikim të buxhetit.

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Këshilli i përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare u themelua me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe me udhëzimin administrativ nr. 01/2006.³⁴ I përbërë prej 21 anëtarëve, ai është përgjegjës për mbikëqyrjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Dy punonjës të këtij këshilli veprojnë si sekretariati i tij, ndërsa anëtarët e tjerë janë punonjës të MPMS-së, Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, QPS-së, Institutit për Politika Sociale (tani Divizioni për Politika Sociale), Asociacionit të Komunave, Universitetit të Prishtinës, dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Buxheti për financimin e pjesëmarrjes së anëtarëve të Këshillit ndahet prej kategorisë së mallrave dhe shërbimeve (shih tabelën I). Buxheti i këshillit nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë tek përfituesit,

edhe pse puna e tij mund të ndikojë tërthorazi drejt këtij qëllimi (shih më poshtë). Kufizimet kohore kanë bërë që kjo analizë të mos merret me shpenzimet e dhe shumat e sakta.

Këshilli i përgjithshëm është përgjegjës për licencimin e organizatave dhe institucioneve si ofrues të shërbimeve sociale. Zgjedhja e anëtarëve të komisionit të licencimit për

Tabela I. Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare: buxheti i planifikuar sipas kategorisë së shpenzimeve

Buxheti i planifikuar	Nr. i përgjithshëm i punonjësve	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet
2013	2	€ 8,212	€ 5,000	€ 1,000	€ 20,000
2014	2	€ 8,639	€ 5,000	€ 1,000	€ 20,000

³⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ No 01/2006 mbi themelimin e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, Prishtina, 2006 <http://mpms.rks.gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.01-2006%20on%20Establishment%20of%20General%20Council.pdf>.

institucionet që ofrojnë shërbime sociale u bë në vitin 2012.³⁵ Megjithatë, ende ka mbetur që të vendoset se kur do të fillon procesi i licencimit. Procesi i licencimit do të krijojë standarde minimale për ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe do të themelojë një mekanizëm më të mirë për monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Kjo do të ndikojë në jetën e grave, burrave, vajzave, dhe djemve që marrin shërbime nga organizatat joqeveritare (OJQ), të cilat ofrojnë shërbime sociale për grupe të rrezikuara. Këtu përfshihen, mes tjerash, individët që iu kanë nënshtruar dhunës familjare, personat me aftësi të kufizuar, dhe fëmijët e braktisur. Në të ardhmen, OJQ-të ose ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale, të cilët nuk i plotësojnë këto standarde minimale, nuk do të marrin licencë, dhe nuk do të kualifikohen për fonde qeveritare as nga niveli qendror e as nga ai lokal.

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes i licencon ofruesit e shërbimeve sociale në nivelin themelor, të mesëm, dhe të lartë/superior. Deri në muajin maj të vitit 2014 kanë aplikuar 242 persona për licenca të nivelit të lartë, prej tyre 227 ishin miratuar (114 gra dhe 128 burra); 31 kishin aplikuar dhe kishin marrë licenca të nivelit të mesëm (10 gra, 21 burra); dhe 29 kishin aplikuar për licenca të nivelit bazik, 28 prej të cilave ishin miratuar (24 gra, 4 burra).³⁶ Përderisa kemi një numër të njëjtë të grave dhe burrave të kualifikuar për licenca të nivelit të lartë/superior, për atë të mesëm kemi më shumë burra, dhe më shumë gra për licencat e nivelit bazik.

Rekomandime

- Të themelohen standardet për licencimin e ofruesve të shërbimeve në vitin 2014; të zbatohen ato me qëllim që të sigurohemi që gratë, burrat, vajzat dhe djemtë të kenë shërbime të larta cilësore, dhe të cilat përkojnë me nevojat e mundshme dhe unike të tyre.
- Të sigurohet se ekziston një bilanc gjinor në kuadër të anëtarëve të Këshillit, të cilët i licencojnë individët dhe ofruesit e shërbimeve institucionale.
- Të sigurohet se strategjia e komunikimit t'i informojë si gratë ashtu edhe burrat, duke i inkurajuar që të aplikojnë në përpjesëtim të barabartë për licenca të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë.
- Të sigurohet që licencat e ofruesve të shërbimeve sociale të jenë duke vepruar në hapësira të ndryshme gjeografike të Kosovës.

TRUPA EKZEKUTIVE E INSPEKTORATIT TË PUNËS

MPMS-ja e ka themeluar Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të punës sipas konventës nr. 81 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), dhe të ligjit të punës të Kosovës.³⁷ Ky trup vepron si organ i pavarur në kuadër të ministrisë, dhe i raporton drejtpërdrejtë ministrit. Është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të plotë të Ligjit të Punës 2001/27 dhe të Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës 2003/19. Trupa e ka kryeinspektorin; tre zëvendës të kryeinspektorit që janë përgjegjës për marrëdhëniet e punës, siguri në punë, dhe mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit në punë; dhe inspektorët e punës. Funksionin e vetë e ushtron në 30 komuna dhe i ka 52 inspektorë të

³⁵ Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, Vendimi për themelimin e Komisionit për Licencim. http://www.kpshsf-rks.net/web/sites/kpshsf-rks.net/files/Vendim_per_themelimin_e_komisionit_per_licencim.pdf.

³⁶ Të dhënat e ofruara nga MPMS-ja, maj 2014.

³⁷ International Labour Organization, C081 – Konventa e punës për Inspektim (No. 81), ILO, Gjenevë; 1947, at: http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO:12100:P12100_INSTRUMENT_ID:312226:NO.

punës. I inspekton marrëdhëniet në punë, duke i analizuar shënimet e punësimit, ambientin e punës, dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve. Po ashtu ofron informata relevante dhe specifike për punëdhënësit dhe punëmarrësit; siguron se nuk ka diskriminim, dhe se punësimi është bërë në pajtim me ligjin e punës; dhe i inspekton rastet e vdekjes që ndodhin në ambientin e punës. Ky trup është, po ashtu, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të pushimit të lehonisë në pajtim me ligjin e punës.³⁸

Tabela 2. Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës, Rezultatet vjetore të Inspektimeve¹

	Inspektimet në total	Punonjësit që kanë vdekur në punë	Nr. i punonjësve që kanë pësuar lëndime serioze	Nr. i punonjësve të inspektuar	Nr. i inspektimeve të grave të punësuar	Nr. i burrave të inspektuar
2011	6,396	10	31	53,935	NA	NA
2012	7,074	17	45	38,067	8,319 (22%)	29,748 (78%)
2013	8,378	17	37	37,517	9,310 (25%)	28,207 (75%)

Tabela 2 e ilustron numrin e përgjithshëm të rasteve të inspektuara që janë rritur me kalimin e viteve. Megjithatë, numri i njerëzve të punësuar dhe buxheti për shpenzimet e inspektimeve (mallra dhe shërbime) ka mbetur në nivel të njëjtë (tabela 3). Megjithëse të dhënat për vitin 2011 nuk ishin në dispozicion, në vitin 2012 dhe 2013 kishte më pak inspektime të grave të punësuar (22% dhe 25%, përkatësisht) sesa të burrave të punësuar (78% dhe 75%). Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë sa i përket numrit të punonjësve që kanë vdekur ose që janë lënduar në vendin e punës.

Tabela 3. Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të punës: buxheti i planifikuar sipas kategorisë së shpenzimeve

Buxheti i planifikuar	Nr. i punëtorëve	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Shpenzimet kapitale
2011	60	€ 381,812	€ 135,000	€ 38,260	€ 10,000
2012	65	€ 381,812	€ 135,000	€ 38,260	€ 10,000
2013	65	€ 328,213	€ 135,000	€ 33,260	€ 15,000
2014	65	€ 348,927	€ 135,000	€ 33,260	€ -

Edhe pse koha e kufizuar bëri që të përjashtohet një analizë e një niveli të këtyllë, inspektorati mund të merr në konsideratë, në të ardhmen, mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre, duke përfshirë informata se cili sektor është inspektuar, si janë zgjedhur këta sektorë për inspektim (p.sh. në bazë të kërkesës apo fokusit për sektor në secilin vit), dhe implikimet gjinore të një përzgjedhje të tillë. Për shembull, a u kushtojnë inspektorët vëmendje sektorëve dhe/ose bizneseve të caktuar, të cilët janë të dominuar prej burrave ose grave?

Vendimi i qeverisë për zvogëlimin e buxhetit për mallra dhe shërbime për 20% do të ndikojë në punën e këtij trupi.⁴⁰ Ndryshimet buxhetore mund të ndikojnë në numrin e inspektimeve që inspektorët janë në gjendje t'i realizojnë. Kjo mund të ketë ndikim në veçanti tek gratë e punësuar, duke pasur parasysh që inspektorët duhet ta monitorojnë zbatimin e të drejtave të grave për pushimin e lehonisë dhe diskriminimit në punë (shih më poshtë). Hulumtimet e mëtejme do të mund ta analizonin ndikimin e zvogëlimit të buxhetit nga perspektiva gjinore.

Rekomandimet

- Të mblidhen të dhëna të ndara sa i përket lëndimeve dhe vdekjeve që rezultojnë prej marrëdhënies së punës, si dhe sa i përket sektorëve të inspektuar.
- Të sigurohet që sektorët dhe bizneset, të cilat njihen tradicionalisht për punësimin e burrave ose grave, të inspektohen në masë të njëjtë.

³⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji i Punës, Ligji Nr. 03/L-212, Prishtina 2010, në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>, Art. 17.

³⁹ Të dhënat sipas ndarjes gjinore janë në dispozicion për tërë ministrinë në kuadër të seksionit të pagave dhe mëditjeve më poshtë.

⁴⁰ Qeveria e Kosovës Vendimi i qeverisë së Kosovës nr. 01/176, 2014.

- Të shtohen inspektimet e zbatimit të pushimit të lehonisë, si dhe të diskriminimit të mundshëm ndaj grave për shkak të pushimit të lehonisë (shih po ashtu seksionin më poshtë sa i përket pushimit të lehonisë)
- Të sigurohet një bilanc në mesin e inspektorëve gra dhe burra të cilët bëjnë inspekte.
- Të monitorohet nga afër ndikimi i mundshëm i zvogëlimit të buxhetit tek gratë dhe burrat.

DIVIZIONI PËR ÇËSHTJET E TRASHËGIMISË SË TRUPAVE MBROJTËSE TË KOSOVËS

Divizioni për Çështjet e Trashëgimisë së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) është përgjegjës për propozimin, hartimin dhe sigurimin e politikave dhe strategjive për risistemimin e ish pjesëtarëve të TMK-së. I trajton çështjet që ndërlidhen me trashëgiminë materiale dhe jo-materiale të TMK-së dhe harton raporte periodike; divizioni është, po ashtu, përgjegjës për informimin e ish-pjesëtarëve të TMK-së për të drejtat e tyre për kompensim material dhe jo material. Megjithatë, Departamenti i pensioneve në kuadër të MPMS-së është përgjegjës për planifikimin buxhetor të kompensimit material dhe shpërndarjes së tij. Ky divizion e mirëmban, po ashtu, edhe bazën e të dhënave për ish-pjesëtarët e TMK-së. Ky divizion i raporton drejtpërdrejtë ministrit dhe përbëhet prej një personeli prej gjashtë zyrtarëve. Buxheti për këtë divizion ka mbetur pothuajse i njëjtë prej vitit 2011 deri në 2014.

Tabela 4. Divizioni për Çështje të Trashëgimisë së TMK-së: buxheti i planifikuar sipas kategorisë së shpenzimeve

Viti	Nr. i përgjithshëm i punonjësve	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale
2011	6	€41,216	€ 49,525	€ 3,000
2012	6	€41,216	€ 49,525	€ 3,000
2013	6	€40,216	€ 49,525	€ 3,000
2014	6	€40,216	€ 49,525	€ 3,000

Rekomandime

- Divizioni mund t'i ketë parasysh nevojat unike të ish-luftëtarëve, si gra ashtu edhe burra, në programet e veta të risistemimit dhe të strategjive komunikuese.
- Të sigurohet një bilanc gjinor në kuadër të divizionit, i cili do ta lehtësonte ofrimin e shërbimeve që i përmbushin nevojat e grave dhe të burrave.

DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE I FAMILJES

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave sociale, zbatimin e legjislacionit, monitorimin dhe zbatimin e standardeve, trajtimin e kërkesave për licencim, administrimin e skemave të përfitimeve dhe hartimin e analizave në fushën e politikave dhe shërbimeve sociale dhe familjare. Po ashtu, i mbikëqyr mbi 40 QPS të shtrira në tërë territorin e Kosovës. Ky departament i ka dy divizione, atë për shërbime sociale, dhe ndihmë sociale.

Divizioni i Shërbimeve Sociale

Divizioni i Shërbimeve Sociale (DSHS) është përgjegjës për monitorimin e punës së ofruesve të shërbimeve sociale, duke përfshirë QPS-të dhe OJQ-të. DSHS-ja po ashtu propozon, harton, dhe e monitoron zbatimin e standardeve dhe procedurave të shërbimeve sociale në pajtim me standardet e BE-s.⁴¹ Që prej vitit 2009, në pajtim me procesin e decentralizimit, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.⁴²

⁴¹ MPMS, *Strategjia sektoriale 2014-2020*.

⁴² Memorandumi i mirëkuptimit (MM) i nënshkruar në shkurt të vitit 2009 mes MPMS-së, Ministrise së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës për kalimin e shërbimeve sociale në komuna.

Megjithatë, procesi i decentralizimit mbetet sfidues si për komunat ashtu edhe për MPMS-në. Të dyja janë të paqarta lidhur me burimin e të ardhurave sa i përket shërbimeve sociale, dhe të përgjegjësive që i ka secila prej tyre. Një varg shërbimesh sociale mbeten të centralizuara, duke përfshirë shërbimet rezidenciale për të moshuarit, shërbimet e bazuara në komunitet për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, shërbimet sociale të ofruara nga OJQ-të, përfitimet për kujdesin ndaj fëmijëve të braktisur, dhe përfitimet për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara. QPS-të vazhdojnë të kenë lidhje administrative me nivelin qendror.

Tabela 5 ofron një pasqyrë të përgjithshme të buxhetit të planifikuar për këtë divizion sipas viteve. Një rritje e dukshme prej shtatë punëtorëve më shumë u bë në vitin 2013, të cilët janë përgjegjës për administrimin e shërbimeve

sociale në nivelin qendror. Buxheti për subvencione dhe transfere i financon përfitimet e kujdesit ndaj fëmijëve të braktisur, përfitimet e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, shërbimet sociale të ofruara nga OJQ-të, si dhe projektet e reja pilote për shërbimet sociale.

Të gjitha QPS marrin fonde për shërbimet sociale drejtpërdrejtë nga komunat (përveç Mitrovicës veriore), që financohet kryesisht prej grantit të përgjithshëm i

cili i jepet komunave nga buxheti i Kosovës (shih tabelën 6). Prej 37 QPS-ve të Kosovës, 24 nga komunat i kanë ofruar ekipit të hulumtimit informata sa i përket financimit që e marrin nga komunat. Vetëm 18 QPS ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Komunat ua kanë financuar shpenzimet operative në vlerë prej €1,844,785 këtyre QPS-ve në 2011. Kjo shumë u rrit prej 72% në 2012 dhe me 11% në 2013. Shumat ndryshojnë sipas komunës (shih Shtojcën 2).

QPS-të ofrojnë tri lloje të shërbimeve: shërbime sociale, skema të ndihmave sociale, dhe shërbime administrative dhe financiare. Klientët e shërbimeve sociale, mes tjerash, janë fëmijët e braktisur, fëmijët pa kujdes familjar, fëmijët e abuzuar, fëmijët që bien ndesh me ligjin, fëmijët e trafikuar, personat e përfshirë në martesat e hershme, fëmijët me aftësi të kufizuara, të rriturit me aftësi të kufizuara, personat e moshuar pa kujdes familjar, prindërit që dëshirojnë të birësojnë, çiftet e ndara, prindërit që kujdesen për fëmijët e braktisur dhe viktimat e dhunës familjare. Përveç kësaj, QPS-të pranojnë aplikacione për ndihmë sociale; vendosin për secilin rast nëse i plotëson kushtet; dhe i monitorojnë kushtet e jetesës së familjeve që marrin ndihma sociale për t'u siguruar që ato i përmbushin kriteret.

Tabela 7 e ilustron numrin e përgjithshëm të përfituesve që marrin shërbime sociale nga QPS-të në 18 komuna. Duke e pasur parasysh se kjo është një analizë e shpejtë, shifrat e pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të përfituesve për të gjitha shërbimet sociale dhe buxhetin e përgjithshëm në 18

Tabela 5. Buxheti i planifikuar i DSHS sipas kategorisë së shpenzimeve

Viti	Nr. i punonjësve	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere
2011	17	€ 61,492	€ 92,593	€ 9,000	€ 3,300,003
2012	17	€ 61,492	€ 129,432	€ 9,000	€ 4,326,233
2013	24	€ 113,039	€ 155,844	€ 11,500	€ 3,504,000
2014	24	€ 112,516	€ 130,000	€ 11,500	€ 3,672,000

Tabela 6. Buxheti i QPS-ve në 18 komuna sipas kategorisë së shpenzimeve

Viti	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Buxheti i përgjithshëm
2011	€ 903,905	€ 461,618	€ 203,601	€ 260,662	€ 15,000	€ 1,844,785
2012	€ 2,260,331	€ 329,869	€ 111,933	€ 396,601	€ 75,000	€ 3,173,735
2013	€ 2,259,598	€ 380,802	€ 110,732	€ 675,317	€ 85,000	€ 3,511,499

Tabela 7. Klientët e shërbimeve sociale në 18 komunat

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i grave	Nr. i burrave
2011	8,391	3,155 (38%)	4,906 (62%)
2012	10,907	3,791 (35%)	6,644 (65%)
2013	10,037	3,536 (35%)	6,304 (65%)

komunat.⁴³ Tabela nuk e pasqyron numrin e përfituesve që e marrin secilin lloj të shërbimit social veç e veç. Në të ardhmen, do të ishte e dëshirueshme që të analizohet numri i grave dhe i burrave që e marrin secilin lloj të shërbimit.

Siç ilustron në tabelën 7, në vitin 2011-2013 shumica e pranuesve të shërbimeve sociale ishin burra (62-65%). Kjo sugjeron se koha dhe mjetet e QPS-ve (të financuara përmes buxhetit të tyre) është shpenzuar në shpërpjesëtim për burrat. Observime nga zyrtarë të këtij departamenti sugjerojnë se kjo mund të jetë për shkak të patriarkalizmit, sipas të cilit burrat e kanë më të lehtë t'i qasen shërbimeve në krahasim me gratë. Megjithatë, duhet realizuar hulumtime të tjera për të zbuluar pse burrat përfitojnë më shumë se gratë nga shërbimet sociale.⁴⁴ Duke e pasur parasysh mandatin e tyre mjaft të gjerë, shërbimet sociale duhet të ndahen në mënyrë më të barabartë midis grave dhe burrave. Analizat e mëtejme do të mund t'i ekzaminonin se cilët përfitues janë në grupet e caktuara të cilat MPMS-sja mendon t'i përfshijë si përfitues, por të cilat nuk janë ende në mesin e grupeve përfituese. Analiza gjinore mund të ndihmojë në hulumtimin se cilat shërbime priren që t'i marrin burrat dhe/ose gratë dhe pse. Hulumtimet e mëtejme, po ashtu, do të mund t'i analizonin nevojat e ndryshme që kanë përfituesit gra dhe burra.

Rekomandime

- Të përfshihet si tregues numri i grave dhe i burrave përfitues që marrin secilin prej llojeve të shërbimeve sociale.
- Të sigurohet një strategji e komunikimit që përfshinë mënyra se si t'i informojë gratë dhe burrat, në mënyrë që të jenë të informuar sa i përket shërbimeve në dispozicion të tyre dhe si të kenë qasje në ato shërbime.
- Të realizohen anketa për vlerësimin e nevojave të ndryshme dhe të nivelit të kënaqshmërisë së përfituesve me ofruesit e shërbimeve. Të sigurohet që të gjeturat janë të ndara sipas gjinisë dhe llojit të shërbimit të ofruar.

Ndihma për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Konventa për të drejtat e fëmijëve u miratua në vitin 1989 dhe hyri në fuqi në vitin 1990.⁴⁵ Ajo i mbron të drejtat, interesat dhe liritë e të gjithë fëmijëve, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre, dhe përmes së cilës fëmija është përkufizuar si secili person nën moshën 18 vjeçare. Konventa përcakton udhëzime dhe përgjegjësi të qarta për personat që merren me kujdesin ndaj fëmijëve. Në Kosovë, kushtetuta i përcakton të drejtat që i gëzojnë fëmijët, mekanizmat mbrojtës, dhe liritë.⁴⁶ Ekzistojnë disa shërbime dhe skema të ndihmave për mbrojtjen dhe sigurimit e të drejtave të fëmijëve.⁴⁷ Personat që i plotësojnë kriteret janë familjet e “fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme”, të përkufizuar si “të gjithë fëmijët nga lindja deri në

⁴³ Janë kontaktuar të 37 QPS-të, dhe vetëm 24 janë përgjigjur. Komunat që nuk kanë ofruar të dhëna apo buxhete të ndara sipas gjinisë nuk janë përfshirë në këto përlogaritje. Numri i klientëve i referohet vetëm shërbimeve sociale dhe nuk e përfshinë numrin e përfituesve të skemave të ndihmës sociale. Andaj, numri i përgjithshëm i klientëve dhe buxhetet e QPS-ve përkatëse përkon me përgjigjet e ofruara nga 18 komunat në muajin maj 2014. Për listën e komunave të cilat ju përgjigjën pyetësorit, shih Shtojcën 2.

⁴⁴ Punëtori, 4 qershor 2014.

⁴⁵ Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1989, në <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>.

⁴⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 50, para. I-5.

⁴⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për përkrahjen materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, ligji nr. 03/L-022*, Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008, në:

<https://mpms.rks.gov.net/Portals/0/Ligji/PrimarAnglisht/LAW%20ON%20MATERIAL%20SUPPORT%20FOR%20FAMILIES%20OF%20CHILDREN%20WITH%20PERMANENT%20DISABILITY.pdf>, Art. 6.

moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitete të përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.”⁴⁸ Përfitimi mujor për secilën familje është €100. Tabela nr. 8 e ilustron numrin e përfituesve sipas vitit dhe buxheti përkatës. Numri i përgjithshëm i përfituesve është rritur për 2% në vit prej vitit 2011 deri 2013. Prej përfituesve, 47-48% janë familje të vajzave me aftësi të kufizuara, dhe 52-53% të familjeve të djemve. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, 3,376 persona të moshës 0 deri në 19 vjeç kanë një lloj të aftësisë së kufizuar; 40% janë vajza dhe 60% janë djem. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë plotësisht të besueshme.⁴⁹

Duke e pasur parasysh ndihmesën mujore prej 100 eurove, buxheti u është ndarë më shumë familjeve me djem sesa familjeve me vajza.

Tabela 8. Numri i familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe buxheti i përgjithshëm

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përgjithshëm i vajzave	Nr. i përgjithshëm i djemve	Buxheti i përgjithshëm	Buxheti i përgjithshëm për vajza	Buxheti i përgjithshëm për djem
2011	2,893	1,382 (48%)	1,511 (52%)	€ 289,300	€ 138,200	€ 151,100
2012	2,946	1,396 (47%)	1,550 (53%)	€ 294,600	€ 139,600	€ 155,000
2013	2,995	1,394 (47%)	1,601 (53%)	€ 299,500	€ 139,400	€ 160,100
2014 (prill)	2,972	1,392 (47%)	1,580 (53%)	€ 297,200	€ 139,200	€ 158,000

Kujdesi për fëmijët e braktisur

Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Familjare dhe udhëzimi administrativ nr. 05/2006 e rregullojnë kujdesin ndaj fëmijëve të braktisur.⁵⁰ Familjet strehuese trajnohen që të bëhen ofrues të këtij lloji të kujdesit. Ekzistojnë dy lloje të pagesave për familjet strehuese të fëmijëve, për familjet biologjike dhe për familjet jobiologjike.

Në muajin e parë, familja kujdestare merr një pagesë prej 225 eurove, dhe në muajt e tjerë 150 euro. Në rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuar, familja kujdestare i merr 250 euro në muaj.⁵¹ Përveç kujdesit për këta fëmijë në familjet jo biologjike, ministria ofron ndihma edhe për birësimin e fëmijëve brenda një familje, pa kujdes prindëror. Ndihma është 75 euro në muaj për një fëmijë të vendosur nën kujdesin brenda familjes.

Sipas të dhënave të ofruara nga DSHS, buxheti i përgjithshëm i shpenzuar për përkujdesjen ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror ishte €144,400 në vitin 2013. Ky buxhet është rritur për 22% në vitin 2013.⁵² Numri i fëmijëve të vendosur nën kujdesin e familjeve të zgjeruara ka rënë në vitin 2012 dhe është rritur në vitin 2013. Duhet të bëhen më shumë hulumtime për ta kuptuar këtë ndryshim të numrit të përfituesve. Siç ilustron në tabelën 9, buxheti i përgjithshëm i shpenzuar për kujdesin ndaj fëmijëve të braktisur është rritur për 19.6% në vitin 2013, dhe shkon në një shumë të përgjithshme prej €722,200.

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ Organizatat që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara e kanë kritikuar metodologjinë e përdorur gjatë regjistrimit të popullsisë dhe mënyrën në të cilën janë shtruar pyetjet. Megjithatë, për momentin, këto janë të dhënat e vetme që ekzistojnë.

⁵⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare*, neni. 3.3i dhe 11; MPMS, *Udhëzimi administrativ, nr. 05/2006 për themelimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim*, Prishtinë: MPMS, 2006, at: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.05-2006%20On%20Establishment%20of%20the%20Panel%20for%20Placing%20Childre.pdf>, Art. 4.

⁵¹ Në janar të vitit 2012, shuma për familjet strehuese u rrit prej 150 euro në 250 euro.

⁵² MPMS, informacioni i pranuar në maj 2014.

Tabela 9. Fëmijët nën përkujdesjen jashtë familjeve të tyre biologjike ose në familjet e tyre të zgjeruara

Viti	Nr. i përgjithshëm i rasteve të vjetra të kujdesit ndaj fëmijëve të braktisur	Numri i përgjithshëm i rasteve të reja	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara nën përkujdesje	Buxheti i përgjithshëm për kujdesin e fëmijëve jashtë familjeve të tyre biologjike	Nr. i fëmijëve nën kujdesin e familjeve e zgjeruara	Buxheti i përgjithshëm për kujdesin ndaj fëmijëve të braktisur
2011	48	51	7	€ 120,635	660	€660,635
2012	54	33	7	€ 116,830	541	€603,730
2013	59	47	7	€ 144,400	642	€722,200

Ky divizion po ashtu i financon dhe i monitoron rastet e birësimit dhe rastet e fëmijëve të braktisur të cilët vendosen në fshatin e fëmijëve (SOS Kinderdorft) (0-3 vjeç). Numri i fëmijëve të birësuar është rritur me kalimin e viteve prej 25 sosh në vitin 2011 në 30 të tillë në vitin 2012 dhe 38 në 2013. Tabela 10 e ilustron numrin total të fëmijëve të strehuar dhe buxhetin e përgjithshëm të shpenzuar. Tabela sugjeron se financimi mesatar i ofruar për secilin fëmijë për çdo muaj ka rënë në vitin 2013. Për fat të keq, nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Tabela 10. Fëmijët në fshatin SOS

Viti	SOS (mosha 0-3)	SOS (mosha 4-18)	Buxheti për SOS	Per kokë për muaj
2011	32	47	€ 44,893	€ 47.3
2012	38	50	€ 50,681	€ 47.9
2013	40	52	€ 40,764	€ 36.9

Rekomandime

- Të mblidhen të dhëna për gjininë e fëmijëve pa prindër, nën përkujdesjen e të tjerëve dhe në OJQ të tjera, të cilat ofrojnë shërbime sociale.

Strehimoret për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare, trafikimit dhe fëmijëve të abuzuar.

Strehimi i personave të cilët kanë përjetuar dhunë në familje, trafikim për qëllim të shfrytëzimit seksual, dhe fëmijëve të abuzuar është i rregulluar me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.⁵⁴ Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, *Programi i Kosovës kundër dhunës në familje dhe plani i veprimit 2011-2014*, dhe *Strategjia Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014* parashohin gjithashtu strehim për personat të cilët i përjetojnë këto forma të dhunës në baza gjinore.⁵⁵ Strehimoret ofrojnë siguri, ushqim, artikuj të higjienës personale, ndihmë mjekësore, këshillime psikologjike, sigurim të transportit, aftësim profesional, dhe ndihmë për rehabilitim dhe ri-integrim. Ato mund të jenë nën menaxhimin ose jo të qeverisë,

⁵³ Vlerësimet e RrGGK në bazë të numrit të përgjithshëm të përfutësve për çdo vit dhe shumës mujore.

⁵⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare*, neni. 1.3d, 12.2.

⁵⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit*, Ligji nr. 04/L-218, Prishtinë, 2013, në: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji_kunder_trafikimit-Anglisht.pdf, neni. 23, 38; Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore, *Programi i Kosovës kundër dhunës në familje dhe plani i veprimit 2011-2014*, Prishtinë: ABGJ, 2011, në: <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>; dhe Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, *Strategjia nacionale dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2011-2014*, Prishtinë: Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, 2011, në: <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/TQNJAnglisht.pdf>, Objektivat strategjike 3.1.1, 2.2.3, 2.2.4, 2.2.5.

por duhet të licencohen prej autoriteteve qeveritare, veçmas ato që ofrojnë ndihmë për personat e trafikuar.⁵⁶

Edhe pse licencimi zyrtar për strehimore, si ofruet të shërbimeve, nuk ka filluar ende, MPMS-ja ka financuar strehimore joqeveritare si dhe një strehimore të sigurisë së lartë që menaxhohet prej qeverisë për personat e trafikuar, d.m.th., Ndërtesën e Përkohshme për Siguri (NPS) që prej vitit 2011. Strehimoret pranojnë fonde shtesë prej donatorëve ndërkombëtarë. Disa po ashtu marrin mbështetje prej ministrive dhe/ose komunave të tjera, të cilat nuk janë pasqyruar këtu.⁵⁷ MPMS-ja e ka ndarë një buxhet për organizatën bamirëse Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijën në vitin 2013 dhe 2014, si bashkëfinancim për një projekt të financuar përmes IPA-s. Projekti i piloton shërbimet sociale të bazuara në komunitet për fëmijët e braktisur, fëmijët që janë viktimë e dhunës në familje dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Siç ilustron në tabelën 11, të gjitha strehimoret kanë pranuar shumë të barabartë të fondeve të shtetit për çdo vit prej vitit 2011, me përjashtim të NPS, Mbrojtimin Parandalor Trafikimit (MVPT), dhe Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët. Megjithatë, siç ilustron në tabelën 12, strehimoret nuk kanë nën strehim numër të njëjtë të personave.

Tabela 11. Buxheti i përgjithshëm i transferuar për secilën strehimore nga MPMS-ja sipas vitit 2011-2015

Strehimorja	Lokacioni	2011 2012 2013 2014 2015				
		2011	2012	2013	2014	(plani)
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve	Prishtinë	€ 17,000	€ 17,000	€ 24,000	€ 24,000	€ 24,000
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Raba Voca	Mitrovicë	€ 17,000	€ 17,000	€ 24,000	€ 24,000	€ 24,000
Qendra për Mirëqenien e Gruas	Pejë	€ 17,000	€ 17,000	€ 24,000	€ 24,000	€ 24,000
Shtëpia e Sigurt	Gjakovë	€ 17,000	€ 17,000	€ 24,000	€ 24,000	€ 24,000
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve	Prizren	€ 17,000	€ 17,000	€ 24,000	€ 24,000	€ 24,000
Qendra Liria	Gjilan	€ 17,000	€ 17,000	€ 24,000	€ 24,000	€ 24,000
Ndërtesa e Përkohshme e Sigurisë ⁵⁸		€ 51,469	€62,242 ⁵⁹	80,000	80,000	NA
Mbroj Viktimën Parandalor Trafikimit	Prishtinë	€ 21,000	€ 26,500	€ 30,000	€ 30,000	€ 30,000
Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët	Prishtinë	NA	NA	€ 50,000	€ 50,000	NA
Gjithsej		€174,469	€190,742	€304,000	€304,000	NA

Kjo sugjeron që MPMS-ja mbase do të duhet ta shfrytëzojë më me efektivitet dhe efikasitet buxhetin e saj për strehimore, duke e bazuar financimin e tyre sipas numrit të klientëve që u shërben secila strehimore dhe të kostos së vlerësuar të strehimit për klientë për ofrimin e shërbimeve standarde.⁶⁰ Shërbimet standarde duhet të përfshijnë koston që ka të bëjë me personelin e strehimores dhe shpenzimet operative që janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve në pajtim me kornizën ekzistuese ligjore. Përlllogaritjet e vitit 2012 sugjerojnë se strehimi i një personi (pa ndonjë shërbim tjetër) kushton mesatarisht 3,750 euro në vit ose 312.50 euro në muaj.⁶¹

Siç mund të vihet re, në kolonën e fundit të ilustruar në tabelën 12, strehimorja e financuar plotësisht nga shteti pranon 10 herë më shumë buxhet për klient se sa shumica e strehimoreve të drejtuara nga OJQ-të. Shuma mesatare e shpenzuar për çdo klient në NPS

⁵⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, ligji nr. 04/L-218*, Prishtinë, neni. 23, 38

⁵⁷ Për më shumë informacione lidhur me fondet që janë përfutur prej burimeve të tjera në të kaluarën, shih RrGGK, *Me çfarë çmimi?*.

⁵⁸ Kjo i paraqet shpenzimet aktuale e jo shpenzimet e planifikuara fillimisht. Numri është rrumbullakuara në euro. Financimi i NPS-së ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë. Burimi: ISF, letërkëmbimi, maj 2014.

⁵⁹ Shuma e buxhetuar ishte 75,000, kështu që kanë shpenzuar pak më pak sesa është buxhetuar në fillim.

⁶⁰ Shih, RrGGK, *Me çfarë çmimi?*, f. 23.

⁶¹ RrGGK, *Me çfarë çmimi?*, f. 77.

është e përafërt me shumën e përmendur më lart mbi koston e ofrimit të strehimit. Për të bërë vlerësime të sakta, MPMS-ja mund të mbledh informata për strehimoret në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit të klientëve. Meqë strehimoret marrin fonde edhe gjetkë, dhe nëse ky financim është për shërbimet e njëjta (e jo për kujdes shtesë përveç atij që financohet prej MPMS-së), atëherë kjo gjë duhet gjithashtu që të kihet parasysh.

Tabela 12 ilustron se strehimoret në Kosovë aktualisht u shërbejnë vetëm grave dhe fëmijëve. Strehimoret pranojnë djem të moshës deri 12 vjeçare. Duke e pasur parasysh faktin se, sipas vlerësimeve, vetëm 8% e pronave në Kosovë u përkasin grave,⁶² atëherë është e qartë se gratë dhe fëmijët janë më të rrezikuar sesa burrat sa i përket qasjes në strehim kur bëhet fjalë për dhunën në familje. Meqë shtëpitë janë zakonisht pronë/ose të marra me qira nga burrat, ata ka më pak të ngjarë të zhvendosen diku tjetër. Po kështu, raportet e policisë sugjerojnë se ekziston edhe dhuna kundër djemve dhe burrave.⁶³ Megjithatë, duhet që së paku një strehimore të vihet në dispozicion të burrave, veçanërisht të të rinjve, të cilët nuk kanë ndonjë alternativë se ku të shkojnë.

Tabela 12. Numri i klientëve të ndihmuar prej secilës strehimore sipas vitit, të ndara sipas gjinisë

Strehimorja	Nr. Qëndrimi maksimal i mesatarish shtretërve t në muaj	2011			2012 ⁶⁴			2013 ⁶⁵			Shpenzimet mesatare shtetërore për klient për muaj në 2013	
		F	M	T	F	M	T	F	M	T		
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve			54	11	65	56	24	80	79	17	96	€ 20.83
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Raba Voca						54	17	71	64	21	85	€ 23.53
Qendra për Mirëqenien e Gruas	16	2-4	54	13	67	45+	67	78	7	85	€ 23.53	
Shtëpia e Sigurt Gjakovë	15	6-12	49	18	67	38+	71	59	14	73	€ 27.40	
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve	21	3-12	21	5	26	29	9	38	30	9	39	€ 51.28
Qendra Liria	15	6	70	18	88	62+	89	49	10	59	€ 33.90	
Ndërtesa e Përkohshme e Sigurisë ⁶⁶	~37		17	0	17	34	0	34	19	1	20	€ 333.33
Mbroj Viktimën Parandallo Trafikimin	7	3-4	45	0	45	48	0	48	43	1	44	€ 56.82
Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët ⁶⁷	12	6	20	16	36	13	8	21	14	13	27	€ 154.32

Sipas terndeve në lidhje me numrin mesatar të personave të strehuar për çdo vit në secilën strehimore, me moshën e tyre, dhe të kohës mesatare të qëndrimit, mund të planifikohet buxheti i shpenzimeve reale që nevojiten për një strehimore. Nevojiten informata të tjera nga strehimoret me qëllim që të bëhet ky vlerësim i shpenzimeve, duke përfshirë edhe informata më të sakta të kohës mesatare të qëndrimit.

⁶² Farnsveden, Ulf, Ariana Qosaj-Mustafa, and Nicole Farnsworth për Orgut, Profili Gjinator i Vendit, Prishtina: Sida: 2014.

⁶³ Ibid.

⁶⁴ Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës (KSK), "Raport i KSK mbi punën e strehimoreve dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje, si edhe për angazhimet e KSK në realizimin Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje për vitin 2012," Prishtinë: 2013.

⁶⁵ MPMS. Shënim: shifra e dhënë nga MPMS-ja dallon prej asaj të dhënë nga Koalicioni i Strehimoreve, por këtu i kemi përdor shifrat zyrtare.

⁶⁶ Ndërtesa e Përkohshme e Sigurisë i ka 25 shtretër, dy apartamente me dy shtretër për nënat me fëmijë, dhe një seksion për burra me pese shtretër.

⁶⁷ Këto të dhëna vijnë prej organizatës Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët. Sipas Ministrisë ata i kanë pasur 12 në përgjithësi për vitin 2011, 12 në 2012, dhe 9 në vitin 2013.

Rekomandime

- Të financohen strehimoret sipas numrit të klientëve të strehuar për muaj, duke përfshirë fonde për personelin dhe shpenzimet operative, të cilat e mundësojnë kujdesin për ata klientë.
- T'u kërkohet strehimoreve që të ofrojnë informata sa i përket burimeve të tjera të financimit.
- T'u kërkohet strehimoreve që të mbledhin të dhëna sa i përket gjinisë së personave të strehuar (duke i përfshirë edhe fëmijët) dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në këto strehimore.
- Të ndahen fonde të subvencioneve dhe transfereve për të kontraktuar ofrues të shërbimeve cilësore për strehim të djemve të moshës 13-19 vjeç, si dhe të burrave të moshës rinore.

Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar

Ky seksion e paraqet numrin e përgjithshëm të përfituesve të secilit institucion, që financohet përmes buxhetit të MPMS-së. MPMS-ja nuk mund të ofronte informata për secilin institucion dhe shtëpi të komunitetit, kryesisht për shkak se buxheti i institucioneve nuk është i decentralizuar, por menaxhohet nga MPMS-ja. Ky buxhet është ndarë në vija buxhetore të institucioneve, dhe kategoritë e shpenzimeve e tregojnë buxhetin e përgjithshëm të ndarë për të gjitha institucionet, e jo të veçantë për secilin prej tyre. Andaj, shumica e shpenzuar për gra dhe burra nuk mund të vlerësohet për secilin institucion, por vetëm në përgjithësi për të gjitha institucionet.

Në vitin 2014, janë 253 persona në institucione të ndryshme në Kosovë; 47% janë gra dhe 53% janë burra (tabela 13). Numri i përfituesve ka rënë paksa me kalimin

e kohës. Buxheti i këtyre shërbimeve është treguar përmes tabelës nr. 14. Buxheti i planifikuar për shpenzimet operative të institucioneve (mallra dhe shërbime) është rritur gradualisht me kalimin e viteve. Vendimi i qeverisë për t'i zvogëluar të gjitha shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve për 20% nuk është aplikuar në këtë Divizion për buxhetin e vitit 2014.

Përveç kësaj, divizioni e ka planifikuar një buxhet prej 30,000 eurosh për një transfer prej 10 eurosh për përfitues në institucione. Për t'u realizuar ky transfer, Ministria e Financave kërkon nënshkrimet në emër të pranuesit. Meqë shumica e pranuesve të mundshëm nuk dinë shkrim-lexim, MPMS-ja ka kërkuar që transferet të bëhen me anë të shenjave të gishtërinjve. Megjithatë, MPMS-ja raporton se Ministria e Financave nuk do t'i pranonte gjurmët e gishtërinjve, andaj edhe transferet nuk janë realizuar. Së këndejmi, kjo vijë buxhetore është ndarë dhe shpenzuar për shpenzime të tjera në kuadër të ministrisë. Kjo mund të ketë ndikuar më shumë tek gratë sesa tek burrat; në 2011, 6.1% e grave të moshës mbi 10 vjeçare në Kosovë nuk kanë ditur shkrim-lexim në krahasim me 1.6% të burrave.⁶⁸

Tabela 13. Numri i përgjithshëm i përfituesve, sipas gjinisë, 2011-2014

Viti	Numri i përgjithshëm i përfituesve	Numri i përgjithshëm i përfituesve gra	Numri i përgjithshëm i përfituesve burra
2011	263	120 (46%)	143 (54%)
2012	260	118 (45%)	142 (55%)
2013	256	120 (47%)	135 (53%)
2014	253	120 (47%)	133 (53%)

Tabela 14. Buxheti i planifikuar për institucione 2011-2014 sipas kategorisë së shpenzimeve

Viti	Nr. i përgjithshëm i punonjësve	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale dhe transfere	Subvencione	Investime kapitale
2011	236	€ 844,979	€ 602,236	€ 106,664	€ 30,000	€ 430,701
2012	236	€ 1,014,979	€ 568,473	€ 106,664	€ 30,000	€ 500,000
2013	242	€ 1,009,779	€ 768,473	€ 106,664	€ 30,000	€ 400,000
2014	242	€ 966,216	€ 849,510	€ 177,000	€ 30,000	€ 400,000

⁶⁸ ASK, *REKOS 2011*, në: [http://census.rks-gov.net/istarMDEE/MD/dawinciMD.jsp?aI=yC&a2=mF0&n=1UR906\\$\\$\\$\\$26&o=&v=1UR060HN00V7000000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0](http://census.rks-gov.net/istarMDEE/MD/dawinciMD.jsp?aI=yC&a2=mF0&n=1UR906$$$$26&o=&v=1UR060HN00V7000000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0).

Shtëpitë e Personave të Moshuar

Ofrimi i këtij shërbimi është rregulluar përmes udhëzimit administrativ nr. 07/2011 për “punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpi me bazë në komunitet”.⁶⁹ Ky udhëzim administrativ i përshkruan kriteret e pranueshme për personat që banojnë në shtëpi të komunitetit: ata duhet “të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës, të jenë në moshën mbi 65 vjeç, të mos kenë pasardhës – fëmijë biologjik apo të birësuar, të jenë në gjendje të mirë psikike, dhe mos të kenë sëmundje infektive.”⁷⁰

Ekzistojnë tri shtëpi të tilla në Kosovë (Prishtinë, Gurakoc, Skenderaj). Në Graçanicë është hapur një shtëpi e re për kujdesin e personave të moshuar në vitin 2014. Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar është përgjegjës për monitorimin e punës së tyre, miratimin e klientëve të ri, të cilët kanë aplikuar që të banojnë në shtëpi, dhe të marrin shënime për klientët në secilin institucion.

Siç shihet në tabelën 15, ka më shumë burra sesa gra në këtë institucion. Numri i grave mbetet po thuaj vazhdimisht i njëjtë, ndërsa numri i burrave ka rënë për çdo vit. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, 54 gra (45%) dhe 66 burra (55%) kanë jetuar në institucionet e kujdesit për të moshuarit në Kosovë.

Tabela 15. Klientët në Institucionet e Kujdesit për të Moshuar sipas vitit

Kujdesi për të moshuarit	Viti	Nr. i përgjithshëm i klientëve	Nr. i përgjithshëm i grave	Nr. i përgjithshëm i burrave
Prishtinë (135 shtretër)	2011	97	37 (38%)	60 (62%)
	2012	97	39 (40%)	58 (60%)
	2013	93	40 (43%)	53 (57%)
	2014	90	40 (44%)	50 (56%)
Gurakoc (20 shtretër)	2011	18	9 (50%)	9 (50%)
	2012	17	9 (53%)	8 (47%)
	2013	16	9 (56%)	7 (44%)
	2014	14	7 (50%)	7 (50%)
Skenderaj (20 shtretër)	2011	17	9 (53%)	8 (47%)
	2012	15	7 (47%)	8 (53%)
	2013	14	6 (43%)	8 (57%)
	2014	16	7 (44%)	9 (56%)
Graçanicë	2014	5	2 (40%)	3 (60%)
Gjithsej në Kosovë	2011	132	55 (42%)	77 (58%)
	2012	129	55 (43%)	74 (57%)
	2013	123	55 (45%)	68 (55%)
	2014	120	54 (45%)	66 (55%)

Shtëpitë e Komunitetit dhe Institucionet e Shëndetit Mendorë

Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare parashihet që drejtoritë mund të ofrojnë, përmes QPS-ve ose OJQ-ve, kujdes rezidencial për personat e moshuar dhe me nevoja të veçanta (neni. 6.7f). Institucionet e Shëndetit Mendorë janë shërbim social i ofruar në pajtim me udhëzimin administrativ nr. 06/2011 “për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillimin mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet.”⁷¹ Sipas këtij udhëzimi, personat që kualifikohen janë ata që i paraqesin një varg dokumentesh.⁷²

⁶⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Udhëzimi për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, Udhëzimi administrativ nr. 07/2011, 2011*, Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7980>.

⁷⁰ Ibid.

⁷¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Udhëzimi Administrativ nr. 06/2011 për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillimin mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet*, Prishtinë, Art. 6.

⁷² Ibid. Këtu përfshihen: letërnjoftimi ose ndonjë dokument tjetër identifikues; certifikata e lindjes; certifikata e mjekut specialist – infektologut; mendimi profesional i së paku tre specialistëve të repartit të psikiatrisë të QKUK-së, apo të ndonjë reparti të psikiatrisë të spitaleve regionale ku përcaktohet qartë diagnoza e klientit (shkalla e ngecjes mendore); aktvendimi mbi marrjen e aftësisë së veprimit nga Gjykata Komunale; Aktvendimi nga organi i kujdestarisë mbi caktimin e kujdestarit; certifikata e gjendjes ekonomike; certifikata e gjendjes familjare; dy fotografi.

Institucionet funksionojnë në kuadër të MPMS-së dhe ofrojnë shërbime të ndryshme për banorët e tyre. Sipas udhëzimit të sapo përmendur administrativ, këtu përfshihet ushqimi, veshja, kujdesi shëndetësor, trajtimi fizik, terapia e punës, arsimimi, dhe trajtimi social. Në Kosovë ekzistojnë shtatë shtëpi me bazë komunitetin (shih tabelën 16).

Tabela 16. Përfituesit në përgjithësi në secilën shtëpi me bazë komunitetin sipas vitit dhe gjinisë

Lloji i shtëpisë së komunitetit	2011			2012			2013			2014		
	Nr. i përgjithshëm i klientëve	Gra në përgjithësi	Burra në përgjithësi	Nr. i përgjithshëm i klientëve	Gra në përgjithësi	Burra në përgjithësi	Nr. i përgjithshëm i klientëve	Gra në përgjithësi	Burra në përgjithësi	Nr. i përgjithshëm i klientëve	Gra në përgjithësi	Burra në përgjithësi
Fëmijët me aftësi të kufizuara	10	3	7	10	3	7	10	3	6	10	3	7
Të rritur me aftësi të kufizuara Shtime	12	7	5	12	7	5	12	7	5	12	6	6
Të rritur me aftësi të kufizuara Vushtrri	10	9	1	10	9	1	10	9	1	10	9	1
Të rritur me aftësi të kufizuara Kamenicë	10	9	1	10	7	3	9	6	3	9	6	3
Të rritur me aftësi të kufizuara Deçan	10	4	6	10	4	6	10	4	6	9	4	5
Të rritur me aftësi të kufizuara Ferizaj	10	4	6	10	4	6	10	5	5	10	5	5
Të rritur me aftësi të kufizuara Graçanicë	10	8	2	10	8	2	10	7	3	10	8	2
Gjithsej në Kosovë	72	44 (61%)	28 (39%)	72	42 (58%)	30 (42%)	71	41 (58%)	29 (42%)	70	41 (59%)	29 (41%)

Nuk ekziston ndonjë udhëzim i ndjeshëm gjinor për institucionet e shëndetit mendor. Për më tepër, ekzistojnë raporte të sulmeve seksuale dhe abuzimeve të tjera ndaj grave.⁷³ Në vitin 2014, kishte pretendime të abuzimit seksual dhe të heqjes së mitrës tek pacientet gra. Zyra e prokurorit në Ferizaj ka filluar hetimet për këto pretendime.⁷⁴

Numri i përgjithshëm i klientëve në institutin e shëndetit mendor në Shtime ka shënuar rritje graduale me kalimin e viteve (shih tabelën 17). Shumica e klientëve në vitin 2011 kanë qenë burra (60-64%).

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për ta bërë një vlerësim të saktë të buxhetit për vitin 2015 për Divizionin e Aftësisë së Kufizuar dhe Personave të Moshuar. MPMS-ja së pari duhet të vlerësojë buxhetin e shpenzuar sipas secilit institucion. Përveç kësaj, MPMS-ja duhet ta analizojë buxhetin në bazë të nevojave të individëve që i marrën këto shërbime prej këtyre institucioneve.

Tabela 17. Klientët në përgjithësi në Institutin në Shtime sipas vitit

Viti	Nr. i klientëve në përgjithësi	Gra në përgjithësi	Burra në përgjithësi
2011	59	21 (36%)	38 (64%)
2012	59	21 (36%)	38 (64%)
2013	62	24 (39%)	38 (61%)
2014	63	25 (40%)	38 (60%)

Rekomandime

- Të hartohen udhëzime të ndjeshme gjinore për institucionet e shëndetit mendor.

⁷³ Në vitin 2002, për shembull, prej gjashtë grave të intervistuar nga “Këshilli për Avancimin e të Drejtave të Njeriut të Personave me Aftësi të Kufizuar”, katër kanë raportuar se nuk kanë përjetuar ndonjë abuzim seksual gjersa kanë jetuar në Institutin e Shëndetit Mendor në Shtime (shih Rosenthal, E., & Szeli, E. “Human Rights of People with Disability in Kosovo,” *Mental Disability Rights International*, 2005, në: <http://www.disabilityrightsintl.org/wordpress/wp-content/uploads/KosovoReport.pdf>.

⁷⁴ *Koha Ditore*, 28 mars 2014, në:

<http://koha.net/index.php/repository/pytjet/pdf/agapdf.pdf?id=27&l=4410>.

- Të realizohen vizita monitoruese të rregullta dhe pa paralajmërim, si dhe të bëhen hetime sa i përket rasteve të mundshme të dhunës seksuale dhe/ose diskriminimit ndaj rezidentëve.
- Të vlerësohet kostoja e ofrimit të shërbimeve në secilin institucion që mbështetet prej këtij divizioni, në bazë të nevojave reale të klientëve.
- Të ndahet buxhet për realizimin e një vlerësimi cilësor të shërbimeve të ofruara, duke marrë parasysh nevojat unike të burrave dhe grave.

Divizioni i Ndhmës Sociale

Banorët që kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë, përfshirë edhe të huajt me vendbanim të përhershëm, kualifikohen që të regjistrohen në skemën e ndihmës sociale ose në QPS-të ose në zyrat komunale të Divizionit për Pensione dhe Përfitime, varësisht prej llojit të ndihmës për të cilën kualifikohen. Skema e Ndhmës Sociale (SNS) u themelua në vitin 2003 në Kosovë, si një përfitim për mbrojtje sociale me qëllim të zbutjes së varfërisë.

SNS-ja është e ndarë në dy kategori: (I) Familjet në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë persona të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar; dhe (II) familja me një anëtar të aftë për punë, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç, me një jetim nën përkujdesje të përhershme nën moshën 15 vjeç, dhe të gjithë anëtarët e tjerë janë të varur. Anëtarët e varur i përfshijnë personat e moshës 18 vjeçare ose më të vjetër të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuar; personat e moshës 65 ose më të moshuar; kujdestarët e përhershëm të dy personave të parë që kanë nevojë për përkujdesje të përhershme ose të një fëmije nën moshën pesë vjeç; personat më të rinj se 14 vjeç, personat e moshës 15-18 vjeç, të cilët rregullisht vijojnë shkollimin e mesëm; dhe prindërit vet-ushqyes me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.⁷⁵ Përveç kësaj, kërkuesit e ndihmës sociale nuk duhet të posedojnë prona ose tokë më shumë se 0.5 hektarë, automjete, kafshë dhe pajisje që përdoren për qëllime shtëpiake apo komerciale. Së fundmi, familja që i plotëson kriteret nuk duhet të ketë burim tjetër të të ardhurave, duke i përfshirë këtu përfitimet nga pensioni bazë, pensioni për aftësi të kufizuar, si dhe prodhimin shtëpiak për konsumim familjar.

Shuma e ndihmës sociale varet prej numrit të anëtarëve të familjes, që nuk përfshinë anëtarët që janë pranues të pensionit për aftësi të kufizuar apo pensionit bazë, apo të atyre që përfitojnë nga ligji për Dëshmorët, Invalidët, Veteranët, Pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimat Civile të Luftës dhe Familjet e tyre. Në pajtim me udhëzimin administrativ për zbatimin e *ligjit për skemën e ndihmës sociale*, shkalla e standardeve mujore për ndihmën sociale për vitin 2003 është paraqitur në tabelën 18.⁷⁶

⁷⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligji nr. 2003/15*, Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2003, në:

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_15_en.pdf, Neni 2.1, 2.2.

⁷⁶ MPMS, *Zbatimi i Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë*, Prishtinë: MPMS, 2003, në:

<https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/Implementing%20Rule%20No.2003-XX%20On%20Implementing%20the%20Law%20on%20Social%20Assistance%20Scheme%20in%20Kosovo.pdf>, neni. 8.

Tabela 18. Shkalla standarde mujore

Numri i anëtarëve të familjes ⁷⁷	Shkalla standarde mujore 2003	Shkalla standarde mujore sipas muajit janar 2009	Shkalla standarde mujore e qershorit 2012	Indeksi i çmimit konsumues të shportës minimale ushqimore 2012 ⁷⁸
Familje me një anëtar	€35	€40	€40	€63.00
Familje me dy anëtarë	€50	€55	€55	€100.00
Familje me tre anëtarë	€55	€60	€60	€133.66
Familje me katër anëtarë	€60	€65	€65	€164.25
Familje me pesë anëtarë	€65	€70	€70	€193.00
Familje me gjashtë anëtarë	€70	€75	€75	€224.60
Familje me shtatë anëtarë	€75 ⁷⁹	€80*	€80	
Familje me tetë anëtarë	€75	€80	€85 ⁸⁰	

Studimet, duke përfshirë ato të UNDP-së, e kanë vënë në pah një çështje të rëndësishme që SNS-ja “nuk u është përshtatur ndryshimeve dhe kushteve mikro- dhe makro-ekonomike në Kosovë⁸¹. Andaj, nuk i përmbush nevojat themelore humane të individëve dhe të familjeve. Siç shihet në tabelën 18, përfitimet e ndihmës sociale nuk e përmbushin shkallën minimale të varfërisë së skajshme në Kosovë: 47 euro për person në muaj. Edhe pse vendimi i qeverisë për ngritjen e pagave dhe të transfereve sociale për 25% ka ndikuar po thuaj në të gjitha llojet e përfitimeve, porse nuk ka pasur ndikim në SNS.⁸²

Buxheti i ndihmës sociale nuk ka pasur ndonjë ndryshim thelbësorë gjatë viteve (shih tabelën 19). Ka pasur një rënie prej 2.5% në buxhetin e vitit 2012 dhe 2013.

Numri i përfituesve ka rënë për 7% në vitin 2013 dhe për 13.9% në tremujorin e parë të vitit 2014 (shih tabelën 20). Buxheti i ndarë për përfitueset gra është më i vogël sesa ai i ndarë për burra. Burrat kanë tendencë të marrjes të transferit të ndihmës sociale në emër të ekonomisë familjare (71%).

Tabela 20. Numri i përgjithshëm i përfituesve të SNS I dhe 2, sipas gjinisë

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përgjithshëm i përfituesve gra	Nr. i përgjithshëm i përfituesve burra	Nr. i përgjithshëm i ekonomive familjare	Nr. i përgjithshëm i anëtarëve gra	Nr. i përgjithshëm i anëtarëve burra
2012	40,582	11,790 (29%)	28,792 (71%)	140,821	81,514 (58%)	59,307 (42%)
2013	37,739	11,102 (29%)	26,637 (71%)	129,717	74,926 (58%)	54,791 (42%)
2014 (prill)	32,488	9,780 (30%)	22,708 (70%)	105,814	61,580 (58%)	44,234 (42%)

⁷⁷ Tabela prej: UNDP, Vlera Reale e Asistencës Sociale: një Vlerësim i Mjaftueshmërisë së Asistencës Sociale, Prishtinë: UNDP, 2014, at:

<http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Communications/Dokumenti%20The%20Real%20Value%20of%20Social%20Assistance%20ONLINE.pdf>.

⁷⁸ Kjo është bazuar në metodologjinë e analizës së *Bankës Botërore për varfërinë dhe pabarazinë 2002-2003*, e cila e bëri llogaritjen e kostos së re të shportës minimale ushqimore dhe të shumëz mujore të ndihmës sociale, duke i shfrytëzuar të dhënat e anketës së ekonomive familjare të vitit 2012. Metodologjia i merr parasysh ndryshimet si në përbërjen e shportës minimale ushqimore ashtu edhe çmimet e vitit 2012.

⁷⁹ Legjislacioni e përcakton kufirin prej 75 eurove në muaj për familjet që kanë më shumë se shtatë (7) anëtarë. Në janar të vitit 2009, kufiri u ngrit në 80 euro në muaj për familjet e tillë.

⁸⁰ Plotësimi i vitit 2012 e heq kufirin prej 80 euro për familjet me më shumë se shtatë (7) anëtarë; për secilin anëtarë shtesë shtohen edhe nga 5 euro në muaj përfitime.

⁸¹ UNDP, 2014.

⁸² Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, *Vendimi i qeverisë së Kosovës, nr. 01/176*, Prishtinë, 2014.

⁸³ Të dhënat e marra prej Divizionit të Ndihmës Sociale, prill 2014.

Prej vitit 2012 deri në 2014, 74% e buxhetit të SNS u është ndarë burrave (tabela 21). Megjithatë, siç shihet në tabelën 20, gratë e përbëjnë shumicën e pjesëtarëve të ekonomive familjare që mbështeten në SNS (58%). Fakti që burrat kanë tendencë të marrjes së përfitimt të asistencës si “kryefamiljarë” mund të çojë në diskriminim të ndarjes së fondeve për të gjithë anëtarët e familjes. Meqë gratë e përbëjnë shumicën e personave të varur prej këtyre përfitimeve, kjo mund të këtë ndikim tek to në mënyrë jo proporcionale. Duhet të realizohen hulumtime të tjera për ta analizuar këtë dukuri në Kosovë.

Tabela 21. Përfituesit dhe ndarja e transfereve të SNS, sipas gjinisë

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përgjithshëm i përfituesve ve gra	Nr. i përgjithshëm i përfituesve burra	Buxheti i përgjithshëm	€ për kokë të femrës	Buxheti i përgjithshëm për gra	€ për kokë mashkulli	Buxheti i përgjithshëm për burra
2012	40,582	11,790	28,792	€27,159,652	€51.3	€7,251,966 (27%)	€57.6	€19,907,686 (73%)
2013	37,739	11,102	26,637	€27,427,689	€55.2	€7,351,618 (27%)	€62.8	€20,076,071 (73%)
2014 (prill)	32,488	9,780	22,708	€9,087,782	€62.4	€2,439,404 (27%)	€73.2	€6,648,378 (73%)

Kategoria e parë e ndihmës sociale

Numri i përgjithshëm i përfituesve të kategorisë së parë të SNS në vitin 2013 ishte 20,963, ku 54% ishin burra dhe 46% ishin gra (shih tabelën 22). Numri i përfituesve ka rënë për çdo vit, me 6.4% në 2013 dhe me 9.5% në tremujorin e parë të vitit 2014. Në vitin 2013, shumica e anëtarëve të familjes që merrnin ndihmën e kategorisë së parë ishin gra (53%). Pjesëtarët burra të familjes marrin transfere pak më shumë (54%).

Tabela 22. Përfituesit e kategorisë së parë të SNS-së

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përgjithshëm i burrave	Nr. i përgjithshëm i grave	Nr. i anëtarëve të familjes	Nr. i përgjithshëm i anëtarëve burra të familjes	Nr. i përgjithshëm i anëtarëve gra të familjes
2012	22,406	12,172 (54%)	10,234 (46%)	65,351	30,575 (47%)	34,776 (53%)
2013	20,963	11,320 (54%)	9,643 (46%)	60,508	28,245 (47%)	32,263 (53%)
2014 (prill)	18,964	10,304 (54%)	8,660 (46%)	53,338	24,561 (46%)	28,777 (54%)

Megjithatë, 57% e buxhetit është ndarë për pranuesit burra, dhe 43% për pranuesit gra (shih tabelën 23). Për shkak të kohës së kufizuar, Divizioni i Ndihmës Sociale nuk mund ta llogariste buxhetin e ndarë në bazë të numrit të anëtarëve të familjes. Mund ta ofronte vetëm buxhetin e përgjithshëm të ndarë për pranuesit e transferit. Sidoqoftë, tabela sugjeron se anëtarët burra të familjes kanë tendencë të pranojnë më shumë transfere se gratë, edhe pse më shumë gra sesa burra varen nga ky transfer.

Tabela 23. Përfituesit e kategorisë së parë të SNS-së dhe buxheti sipas gjinisë dhe vitit

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përgjithshëm i burrave	Nr. i përgjithshëm i grave	Buxheti i përgjithshëm	Buxheti i përgjithshëm për përfituesit burra	€ për kokë mashkulli	Buxheti i përgjithshëm për përfitueset gra	€ për kokë të femrës
2012	22,406	12,172 (54%)	10,234 (46%)	€14,309,599	€8,125,598 (57%)	€55.6	€6,184,001 (43%)	€50.4
2013	20,963	11,320 (54%)	9,643 (46%)	€14,568,820	€8,272,422 (57%)	€60.9	€6,296,398 (43%)	€54.4
2014	18,964	10,304 (54%)	8,660 (46%)	€4,968,328	€2,857,639 (58%)	€69.3	€2,110,689 (42%)	€60.9

Kategoria e dytë e ndihmës sociale

Pabarazia gjinore është më e madhe në kategorinë e dytë të SNS. Tabela 24 tregon se një shumicë e konsiderueshme e pranuesve të transfereve janë burra (91%). Në tremujorin e parë

të vitit 2014, kjo përqindje ka shënuar një rritje të vogël në 92%. Edhe pse burrat janë pranues të transfereve, shumica e pjesëtarëve të familjes që varen në kategorinë e dytë të SNS-ve janë gra (62%). Përsëri, burrat pranojnë transfere që numerikisht janë më shumë sesa gratë.

Tabela 24. Kategoria e dytë e shpërndarjes së SNS sipas gjinisë së përfituesve të transfereve dhe anëtarëve të familjes

Viti	Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përgjithshëm i burrave	Nr. i përgjithshëm i grave	Nr. i përgjithshëm i pjesëtarëve të familjes	Nr. i përgjithshëm i pjesëtarëve burra të familjes	Nr. i përgjithshëm i pjesëtarëve gra të familjes
2012	18,176	16,620 (91%)	1,556 (9%)	75,470	28,732 (38%)	46,738 (62%)
2013	16,776	15,317 (91%)	1,459 (9%)	69,209	26,546 (38%)	42,663 (62%)
2014	13,524	12,404 (92%)	1,120 (8%)	52,476	19,673 (37%)	32,803 (63%)

Tabela 25 e paraqet atë që burrat vazhdimisht e kanë përfituar shumicën e buxhetit të përgjithshëm për kategorinë e dytë të ndihmës sociale (92%). Ky ndryshim mund të jetë për shkak të roleve të ndryshme gjinore në Kosovë, sipas të cilave gratë kujdesen për përgjegjësitë brenda familjes, dhe burrat mbajnë përgjegjësi për punët jashtë familjes, duke përfshirë edhe marrjen e asistencës sociale.⁸⁴ Megjithatë, nevojitet të bëhen hulumtime të mëtejshme në të ardhmen. Gratë mund të mos kenë qasje në këto fonde po që se nuk janë pranuese të drejtpërdrejta të transferit, që mund të shpie në diskriminim të shfrytëzimit të ndihmës së shtetit.

Tabela 25. Pranuesit e kategorisë së dytë të ndihmës sociale sipas vitit, gjinisë dhe buxhetit

Viti	Përfituesit në përgjithësi	Nr. i burrave (%)	Nr. i grave (%)	Buxheti i përgjithshëm	Buxheti i përgjithshëm për burra	€ për kokë mashkulli	Buxheti për gra	€ për kokë të femrës
2012	18,176	16,620 (91%)	1,556 (9%)	€12,850,053	€11,782,088 (92%)	€59.1	€1,067,965 (8%)	€57.2
2013	16,776	15,317 (91%)	1,459 (9%)	€12,858,869	€11,803,649 (92%)	€64.2	€1,055,220 (8%)	€60.3
2014	13,524	12,404 (92%)	1,120 (8%)	€4,119,454	€3,790,739 (92%)	€76.4	€328,715 (8%)	€73.4

Rekomandime

- Të kihet parasysh indeksi i shportës minimale të ushqimit gjatë planifikimit buxhetor.
- Të bëhen hulumtime të mëtejme se pse burrat janë pranues të kategorisë 2 të SNS-së shumë më tepër sesa gratë, dhe se si shpenzohet shuma e asistencës sociale brenda familjes.
- Të caktohen tregues specifik, dhe të zhvillohen aktivitete lidhur me rritjen e proporcionit të grave që pranojnë transfereve të SNS-së.
- Të sigurohet që gratë të marrin transfere në rastet kur ato janë kujdestaret parësore (p.sh. për fëmijë, për të moshuar), në mënyrë që kujdestari parësor të merr fondet e jo kryefamiljari.

DEPARTAMENTI I FAMILJEVE TË DËSHMORËVE DHE INVALIDËVE TË LUFTËS

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës është përgjegjës për hartimin dhe promovimin e politikave të MPMS-së në lidhje me pensionet dhe përfitimet e personave të prekur nga lufta. Po ashtu planifikon dhe koordinon programin e përgjithshëm të pensioneve dhe beneficioneve për kategoritë e luftës. Bën realizimin e pagesave si pjesë e skemës së pensioneve dhe beneficioneve, si dhe i mirëmban shënimet dhe statistikat lidhur me shpenzimet. Ky departament i administron skemat specifike pensionale të dëshmorëve,

⁸⁴ Punëtori, 4 qershor 2014.

invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe të familjeve të tyre. Ky pension është i rregulluar përmes ligjit nr. 04/L-054 “për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre”. Ligji i parasheh kriteret dhe i përcakton kushtet që duhet të përmbushen për ta përfituar këtë pension. Pagesa e përfshin një transfer mujor të parave, shkalla e së cilës varet prej statusit të pjesëtarit të UÇK-së (veteran, i zhdukur, shkalla e lëndimeve trupore), e që administrohet prej Departamentit të Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Familjes së Viktimave Civile. Buxheti i subvencioneve dhe transfereve për zbatimin e tërë ligjit është €12,564,000 për vitin 2014.

Në prill të vitit 2014 u miratua ligji nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054.⁸⁵ Ndryshimi bëri që listës së përfituesve t’u shtohen edhe të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, kategori e përkufizuar si “cilindo person i cili i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27.02.1998 deri më 20.06.1999.”⁸⁶ Kjo ishte një arritje nga perspektiva gjinore.

Në qershor të vitit 2012, MPMS-ja e nxori udhëzimin administrativ nr. 08/2012 *për vlerësimin dhe ekzaminimin e shkallës së invaliditetit të invalidit civil dhe invalidit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*. Ky udhëzim bëri që të krijohet komisioni për ekzaminimin mjekësor, i cili e vlerësonte shkallën e paaftësisë si rezultat i luftës si për civilët ashtu edhe për pjesëtarët e UÇK-së.

Departamenti ka bërë planifikim efektiv të buxhetit nga viti 2011 deri në vitin 2013, dhe e ka shpenzuar po thuaj tërë buxhetin (tabela 26). Përveç kësaj, buxheti i përgjithshëm u nda pothuaj në mënyrë të barabartë si për përfitueset gra ashtu edhe për ata burra (tabela 27).

Tabela 26. Dallimet e DFDIL sa i përket buxhetit të planifikuar dhe të shpenzuar

Viti	Buxheti i përgjithshëm i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar
2011	€ 29,921,019	€ 29,249,970.31	97.8%
2012	€ 30,121,019	€ 30,205,298.52	99.7%
2013	€ 29,448,900	€ 30,364,117.29	103.1%

Tabela 27. Buxheti i përgjithshëm i shpenzuar për përfitueset gra dhe burra, 2011-2013⁸⁷

Viti	Buxheti i përgjithshëm	Buxheti për gratë	% e buxhetit për gra	Nr. i grave përfituese	€ për kokë të gruas	Buxheti për burra	% e buxhetit për burra	Nr. i përfituesve burra	€ për kokë burri
2011	€29,249,970	€14,967,635	51%	6,857	€182	€14,282,336	49%	6,262	€190
2012	€30,205,299	€15,156,068	50%	6,852	€184	€15,049,230	50%	6,380	€197
2013	€30,364,117	€15,333,359	50%	6,847	€187	€15,030,758	50%	6,349	€197

Megjithatë, më shumë gra në krahasim me burrat kanë përfituar nga kjo shumë e barabartë e fondeve. Në vitin 2011 kishte 9.5% më shumë gra që e merrnin këtë beneficion sesa që kishte burra, 7.4% më shumë në vitin 2012, dhe 7.8% më shumë në vitin 2013. Siç shihet në tabelën 27, burrat mesatarisht marrin beneficione në shumën afro 10 euro më shumë në muaj për kokë (€190-197) sesa që marrin gratë (€182-187). Kjo vjen mbase për shkak se përfitimet që i marrin burrat kanë tendencë të jenë më të mëdha sesa përfitimet që i marrin gratë. Megjithatë, meqë shuma e pranuar dallon sipas kategorisë pensionale, atëherë nuk mund të bëhet një përlogaritje e përgjithshme për kokë banori.

⁸⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile dhe familjet e tyre*, Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2011; Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave të dhunës seksuale të luftës, dhe viktimave civile dhe familjeve të tyre*, Prishtinë 2014, në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436>.

⁸⁶ Ibid. neni. 3.

⁸⁷ Të gjitha shifrat janë rrumbullakuar në vlerën më të afërt të euros.

Tabela 28 e tregon shumën e përgjithshme të buxhetit të shpenzuar për secilën kategori pensionale, dhe përqindjen e ndarë për përfituesit gra dhe burra në vitin 2011-2013. Nuk ka asnjë dallim në buxhetin e ndarë për kokë gruaje dhe burri për transferet në këtë departament.

Tabela 28. Buxheti sipas llojit të transferit dhe gjinisë 2011-2013

Lloji i transferit	2011			2012			2013		
	Buxheti i përgjithshëm	% e buxhetit të përgjithshëm për gratë	% e buxhetit të përgjithshëm për burrat	Buxheti i përgjithshëm	% e buxhetit të përgjithshëm për gratë	% e buxhetit të përgjithshëm për burrat	Buxheti i përgjithshëm	% e buxhetit të përgjithshëm për gratë	% e buxhetit të përgjithshëm për burrat
Familjet e dëshmorëve	€8,352,099	77%	23%	€8,750,867	77%	23%	€8,796,789	77%	23%
Viktimat civile	€8,309,598	83%	17%	€8,077,806	84%	16%	€8,069,589	84%	16%
Invalide të luftës së UÇK-së	€9,080,451	2%	98%	€9,824,109	2%	98%	€9,824,159	2%	98%
Invalide civil të luftës	€2,587,033	28%	72%	€2,575,444	28%	72%	€2,587,475	28%	72%
Pjesëtarët e zhdukur të UÇK-së	€ 75,842	89%	11%	€ 79,502	89%	11%	€ 84,014	90%	10%
Personave të zhdukur civilë	€ 473,172	79%	21%	€ 457,182	79%	21%	€ 506,225	80%	20%
Familjet e invalide të luftës pas vdekjes	€ 144,855	95%	5%	€ 197,702	92%	8%	€ 244,198	92%	8%
Familjet e invalide civilë pas vdekjes	€ 46,900	86%	14%	€ 56,927	84%	16%	€ 69,605	84%	16%
Kujdestarët e invalide të luftës	€ 163,620	80%	20%	€ 169,200	83%	17%	€ 165,420	82%	18%
Kujdestarët e invalide civilë	€ 16,401	62%	38%	€ 16,561	62%	38%	€ 16,642	61%	39%

Në vitin 2013, është shpenzuar më shumë buxhet për gratë në kategorinë e familjeve të dëshmorëve (77%), viktimave civile (84%), të pjesëtarëve të zhdukur të UÇK-së (90%), të personave të zhdukur civilë (80%), të familjeve të invalide të luftës pas vdekjes (92%), familjeve të invalide civilë pas vdekjes (84%), kujdestarëve të invalide të luftës (82%), dhe kujdestarëve të invalide civilë pas vdekjes (61%). Kjo mund të shpjegohet me faktin se shumica e personave të vrarë ose të zhdukur në luftë ishin burra. Andaj, burrat dukshëm e përbëjnë shumicën e përfituesve të kategorisë së invalide të luftës së UÇK-së (98%) dhe të invalide civilë të luftës (72%). Përderisa invalide të luftës së UÇK-së janë kryesisht burra për shkak se burrat e përbënin shumicën e atyre që luftuan në UÇK, invalide civilë duket se kanë një bilanc më të madh gjinor. Kjo mund të sugjerojë që invalide civilë gra mund mos t'i kenë informatat apo nuk kanë qasje në përkrahjen për të cilën mund të kualifikohen.

Rekomandime

- Të bashkëpunohet me mediat dhe grupet e grave të cilat punojnë me gra të prekura nga lufta, duke u siguruar që gratë i dinë të drejtat e tyre dhe beneficinet e posaçme.
- Të përfshihen këto detyra në përshkrimin e detyrave të punës së punonjësve.
- Të përcaktohet kostoja dhe buxheti për ndryshimet e fundit të ligjit.
- Të vazhdohet të bëhet analiza e shpenzimeve për grupe të ndryshme, të ndarë sipas grave dhe burrave, dhe ku përfshihen shpenzimet për kokë banori.
- Të bëhen analiza të mëtejme lidhur me nevojat e veçanta të grave dhe burrave, duke aplikuar anketa me përfitues aktualë dhe të mundshëm.

DEPARTAMENTI I PENSIONEVE

Ligji i ndryshuar për pensionet thekson se përcaktimi i politikave ekonomike sa i përket pensioneve, si pjesë e politikave buxhetore, është përgjegjësi e qeverisë.⁸⁸ Në mënyrë të veçantë, është përgjegjësi e MPMS-së në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Sistemi i pensioneve në Kosovë organizohet, planifikohet dhe menaxhohet prej Departamentit të Administratës së Pensioneve në kuadër të MPMS-së. Skema aktuale e pensioneve përfshinë: pensionin bazë, pensionin e aftësisë së kufizuar, pensionin e parakohshëm nga “Trepça”, pensionin për personat e verbër, pensionin e kontribut-paguesve, pensionin e TMK-së, dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (KSF) (secila prej tyre i diskutuar më poshtë). Vendimi i qeverisë nr. 01/176 rezultoi në një rritje prej 25% për të gjitha skemat pensionale të administruara nga Administrata e Pensioneve e Kosovës (APK) që prej prillit të vitit 2014, përveç për pensionet e Trepçës që kanë pasur një rritje prej 50%.⁸⁹

Buxheti i planifikuar i APK-së për financimin e skemave nuk ishte shpenzuar tërësisht në vitin 2011 dhe 2012: u shpenzua 89% dhe 95%, përkatësisht (shih tabelën 29). Në vitin 2013, buxheti u mbi shpenzua në 106% në total. Kjo u financua prej departamenteve të tjera të MPMS-së apo të ministrive të tjera. Përveç kësaj, sipas informatave të muajit mars, APK ka shpenzuar më shumë se 25% të buxhetit të planifikuar për vitin 2014. Kjo sugjeron se deri në fund të vitit 2014, do t'i nevojitet mbështetje prej departamenteve të tjera të MPMS-së apo ministrive të tjera përmes vendimeve qeveritare. APK ka pritur që të del kjo çështje për shkak se Ministria e Financave nuk e miratoi buxhetin e kërkuar të MPMS-së në vitin 2013.⁹⁰

Sipas të dhënave të APK-së, në vitin 2013 së paku 93,043 burra i kanë pranuar €86,643,097 në formën e pensioneve (56% të buxhetit të APK). Në vitin e njëjtë, 99,299 gra kanë marrë €69,430,482 në formën e pensioneve.⁹³ Gjatë viteve të ndryshme gratë kanë pranuar më shumë pensione sesa burrat (shih tabelën 30). Megjithatë, gratë kanë pranuar vazhdimisht më pak fonde sesa burrat. Kjo mund t'i atribuohet faktit se burrat duket se marrin lloje të pensionit që janë në shuma më të mëdha (p.sh. Trepça, TMK, dhe pensionin kontribut-pagues bazë) në krahasim me llojin e pensioneve që e marrin gratë (p.sh. pensioni bazë).

Tabela 29. Përqindja e subvencioneve dhe transfereve të buxhetit të shpenzuar në krahasim me shpenzimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi

Viti	% e shpenzuar
2011	89%
2012	95%
2013	106%
2014	35%

Tabela 30. Pensionet e APK sipas vitit dhe gjinisë

Viti	Gjinia	Përfituesit në përgjithësi	Buxheti i përgjithshëm
2011 ⁹¹	Burra	86,459	€32,717,877
	Gra	93,715	€45,804,997
2012 ⁹²	Burra	89,078	€63,169,888
	Gra	94,802	€53,925,954
2013	Burra	93,043	€86,643,097
	Gra	99,299	€69,430,482
2014	Burra	90,008	€30,133,584
	Gra	96,938	€25,012,327

⁸⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/20 Trusti pensional i Kosovës, për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/35, ligji nr. 03/L-084*, Prishtinë, 2008, në: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji_2008_03_L084_al.pdf, neni. 6.

⁸⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *vendimi i qeverisë së Kosovës nr. 01/176*, Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2014, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_176-te_te_Qeverise_2014.pdf, neni. 2.3.

⁹⁰ Intervistë e RrGGK me APK dhe Departamentit për Buxheti dhe Financa në MPMS, prill, 2014.

⁹¹ Mungojnë të dhënat e vitit 2011 për pensionin e FSK dhe pensioni i parakohshëm prej Trepçës. Kjo është pasqyruar në shumën e buxhetit dhe në numrin e përfituesve.

⁹² Nuk dihet numri i përfituesve për pensionimin e parakohshëm prej Trepçës. Megjithatë, MPMS-ja ka vërejtur se përfituesit janë vetëm burra.

⁹³ Duhet vënë re se sipas të dhënave të AKS, vetëm 57,279 burra dhe 65,596 gra janë në moshën e pensionit në 2011 (AKS, Projeksionet e Popullatës së Kosovës 2011-2016, fq. 38 Prishtinë: ASK, dhjetor 2013, në: http://ask.rks-gov.net/ENG/publikimet/doc_view/1126-kosovo-population-projection-2011-2016!?tmpl=component&format=raw.) Kjo sugjeron se ose të dhënat e censurit nuk janë sakta ose se më shumë pensionist se duhet janë duke marrë pension.

Tabela 31 e paraqet përqindjen e përgjithshme të buxhetit të ndarë për përfitues gra dhe burra të secilës skemë pensionale. Dallimet ekzistojnë në përqindjen e buxhetit të shpenzuar për gra dhe burra në secilën skemë. Në përgjithësi, burrat marrin përqindje më të madhe të buxhetit (shih “buxhetin e përgjithshëm”).

Tabela 31. Buxheti i APK sipas vitit dhe gjinisë, duke përfshirë edhe ndryshimet e fundit në pensionet mujore

Lloji i pensionit	Pensioni mujor në 2013	Pensioni mujor prej prillit 2014	2011		2012		2013		2014 (mars)	
			Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
Pensioni bazë	€ 60	€ 75	35%	65%	34%	66%	34%	66%	35%	65%
Personat me aftësi të kufizuar	€ 60	€ 75	51%	49%	52%	48%	52%	48%	53%	47%
Pensioni i parakohshëm (Trepça)	€ 50	€105 ⁹⁴	100%	0%	100%	0%	100%	0%	NA	NA
Pensioni i parakohshëm i TMK	NA ⁹⁵	NA	NA	NA	97%	3%	96%	4%	96%	4%
Pensioni bazë i kontribuues pagesve	€112	€140	87%	13%	90%	10%	89%	11%	89%	11%
Pensioni i pjesëtarëve të FSK	NA ⁹⁶	NA	NA	NA	91%	9%	92%	8%	94%	6%
Ligji për të verbrit	NA	€250 ⁹⁷							51%	49%
Buxheti i përgjithshëm			42%	58%	54%	46%	56%	44%	55%	45%

Pensioni bazë

Ofrimi i pensioneve bazë në Republikën e Kosovës është i rregulluar përmes ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.⁹⁸

Personat që gëzojnë të drejtën e pensionit bazë janë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës dhe e kanë arritur moshën e pensionimit (aktualisht 65 vjet për gra dhe burra). Pensionistët duhet ta marrin pensionin mujor nga APK. Transferi pensional është rritur secilin vit (shih tabelën 32). Me vendimin e fundit të qeverisë, pensioni bazë është rritur në 75 euro në muaj.

Në vitin 2011 dhe 2012, MPMS-ja ka planifikuar më shumë buxhet për pensionin bazë sesa që ka shpenzuar APK: 7% dhe 6% përkatësisht (shih tabelën 33). Megjithatë, në vitin 2013 APK nuk kishte fonde të mjaftueshme për

kryerjen e të gjitha pagesave, me 7% fonde më pak. Në raste të tilla, departamenti i buxhetit i MPMS-së ose i shfrytëzon fondet prej programeve të tjera apo kategorive të tjera të shpenzimeve ose merr fonde prej ministrive të tjera, në bazë të vendimeve qeveritare.

⁹⁴ Vendimi i qeverisë ishte për një rritje prej 50%, që do të shkonte në €100. Megjithatë, është e paqartë pse në KASH shuma e re është €105.

⁹⁵ Shuma e pensionit llogaritet në bazë të pagës mesatare që merret nga individ gjatë tri viteve të mëparshme të shërbimit të tij/saj (70%) dhe nëse ka dalë më herët në pension (50%).

⁹⁶ Shuma e pensionit është llogaritur në bazë të përqindjes së pagës dhe kohës që ka shërbyer personi. Ata marrin 0.5% rritje për çdo vit që kanë shërbyer në FSK. Mund ta marrin pensionin e invalidit përveç këtij pensioni (Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK, Ligji nr. 04/L-084, neni 10, Prishtinë, 2012, ne: http://www.mkshf-ks.org/repository/docs/Ligji_Per_Pensionet_e_Pjesetareve_te_Forces_se_Sigurise_se_Kosoves.pdf).

⁹⁷ Ishte €100 për personat e verbër dhe €100 për ndihmësin para vendimit të qeverisë në vitin 2014. Tani është €125 për secilin.

⁹⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për fondet pensionale të Kosovës, Law nr. 04/L-101*, Prishtinë, 2012, ne: <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Ligji%20per%20Fondet%20Pensionale.pdf>, neni. 3.

Tabela 32. Pensioni bazë

Viti	Pensioni mujor
2011	€ 45
2012	€ 50
2013	€ 60
2014	€ 75

Tabela 33. Pensioni i planifikuar dhe buxheti i shpenzuar sipas vitit

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar
2011	€ 65,650,000	€ 61,184,985	93%
2012	€ 73,038,000	€ 69,205,435	94%
2013	€ 81,337,677	€ 87,340,090	107%
2014	€ 88,693,355	€ 31,109,565	25%

Ka dukshëm më shumë gra (65-69%) sesa burra (34-35%) që përfitojnë prej pensionit bazë (tabela 34). Ky nivel ka mbetur po thuaj i njëjtë prej vitit 2011 deri 2014. Kjo mund t'i atribuohet faktit se të gjithë qytetarët e Kosovës kualifikohen për këtë pension, pa marrë parasysh numrit të viteve që kanë qenë të punësuar. Po ashtu, jetëgjatësia e grave sipas vitit 2011 (72.7 vjet) ishte më e gjatë sesa e burrave (68.1), andaj gratë mbështeten në pensione më gjatë sesa burrat.⁹⁹ Trendet sugjerojnë se jetëgjatësia tek gratë dhe burrat është duke u rritur, që nënkupton se më shumë njerëz do të varen në pensione në të ardhmen. Numri i përfituesve është rritur 4% secilin vit.¹⁰⁰

Tabela 34. Buxheti i pensionit bazë sipas vitit dhe gjinisë së përfituesve

Viti	Buxheti i përgjithshëm vjetor	Buxheti i përgjithshëm vjetor për grate	Nr. i përgjithshëm i grave përfituese	Buxheti i përgjithshëm vjetor për përfituesit burra	Nr. i përgjithshëm i burrave përfitues	% e buxhetit të përgjithshëm për gra	% e buxhetit të përgjithshëm për burra
2011	€61,184,985	€ 39,977,880	79,623	€ 21,207,105	43,601	65%	35%
2012	€69,205,435	€ 45,340,800	80,952	€ 23,864,635	44,061	66%	34%
2013	€87,340,090	€ 57,212,473	84,420	€ 30,127,617	45,924	66%	34%
2014 (mars)	€31,109,565	€ 20,369,355	82,187	€ 10,740,210	43,642	65%	35%

Pensioni i aftësisë së kufizuar

Kosova duhet ta zbatojë Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut,¹⁰¹ Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar,¹⁰² dhe Strategjinë Evropiane për Aftësi të Kufizuar 2010-2012 drejt hyrjes në BE.¹⁰³ Ligji nr. 2003/33 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë i rregullon pensionet për këtë kategori të ndryshme njerëzve.¹⁰⁴ Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuar i Republikës së Kosovës 2009 – 2011” përpiqet t'i mbrojë të drejtat dhe beneficinet e personave me aftësi të kufizuar.¹⁰⁵ Personat që kanë të drejtë të përfitimit të këtij pensioni janë personat e rritur me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët kanë aftësi të përhershme të kufizuar deri në atë masë sa që nuk mund të punojnë.¹⁰⁶ Pensioni përfshinë një transfer mujor të nivelit të njëjtë me pensionin bazë. Buxheti i vitit 2014 për këtë pension është €12,564,000.

Procesi i marrjes së statusit të personit me “aftësi të kufizuar” në Kosovë bazohet kryesisht në modelin mjekësor. Një komision i mjekëve e përcakton diagnozën që mund të jetë fizike, ndijore, ose mendore. Gjendja shëndetësore është përcaktuese e aftësisë së kufizuar.

⁹⁹ Banka Botërore, databank, në:

http://www.quandl.com/WORLDBANK/KSV_SP_DYN_LE00_FE_IN-Kosovo-Life-expectancy-at-birth-female-years. Duhet përmendur, se ASK përllogarit se jetëgjatësia e burrave është 75.5 dhe për gra 80.5 vjeç. (ASK, Projektimet e Popullatës së Kosovës 2011-206, 2013, fq.18). Megjithatë, Banka Botërore ka konsideruar në përllogaritjet e veta edhe regjistrimet e ulëta të vdekjeve në Kosovë.

¹⁰⁰ Të dhënat e ofruara nga APK, prill 2014.

¹⁰¹ Kombet e Bashkuara, *Deklarata Universale për të Drejtave të Njeriut*, 2007 në:

<http://www.un.org/en/documents/udhr>.

¹⁰² Kombet e Bashkuara, *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*, në:

<http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>.

¹⁰³ Komisioni Evropian, *Strategjia Evropiane për Aftësi të Kufizuar 2010-2020*, në:

http://ec.europa.eu/justice/discrimination/disabilities/disability-strategy/index_en.htm.

¹⁰⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, ligji nr.

2003/33. 2003. në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_23_en.pdf

¹⁰⁵ Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuar i Republikës së Kosovës 2009-2011, në:

http://www.cooperazioneallosviluppo.esteri.it/pdgc/italiano/iniziativa/pdf/Kosovo_Plan.pdf.

¹⁰⁶ Aftësia e përhershme e kufizuar përkufizohet kur një person i moshës mes 18 dhe 65 vjeçe e ka “diagnozën mjekësore të gjendjes fizike, ndijore, ose mendore, ka sëmundje ose aftësi të kufizuar që e bëjnë atë të paafte për çfarëdo pune shpërblyese dhe kur Ministria e vlerëson personin dhe vendos se ata/ato i përmbushin kriteret e parapara në këtë ligj.”

Megjithatë, vetëm personat që janë 100% të paaftë për të punuar kanë të drejtë të përfitojnë nga pensioni i personave me aftësi të kufizuar. Një çështje që është ngritur ka të bëjë me atë se kjo politikë nuk i inkurajon personat me aftësi të kufizuar të bëhen të pavarur, dhe se ka ndikim më të madh tek gratë me aftësi të kufizuara të cilat mbështeten po thuaj krejtësisht në përkrahjen e familjes.

Tabela 35 e paraqet dallimin mes buxhetit të planifikuar dhe buxhetit të shpenzuar në vitin 2011-2014. Në vitin 2011 dhe 2012, MPMS-ja ka planifikuar buxhet 15.7% dhe 12.5% përkatësisht, më shumë për pensionet e personave me aftësi të kufizuar. MPMS-ja i ka shfrytëzuar fondet shtesë për skemat e tjera pensionale, të cilat nuk janë planifikuar si duhet. Në vitin 2013, MPMS-ja kishte shpenzime prej 13.6% mbi buxhetin e saj. Sipas të dhënave të marsit 2014, 38.5% buxhetit është shpenzuar.

Si pensioni bazë, edhe pensioni për aftësi të kufizuar është rritur vazhdimisht për çdo vit, nga €45 në muaj në vitin 2011 në €75 në muaj në vitin 2014. Burrat përfitojnë vazhdimisht më shumë pensione të aftësisë së kufizuar sesa gratë (shih tabelën 36). Si pasojë, burrat kanë marrë afërsisht 52% të këtij buxheti në vitin 2012 dhe 2013. Për më tepër, pjesa e grave që marrin pension për aftësi të kufizuar duket se po bie. Në vitin 2012, numri i grave përfituese ka rënë për 6.7% në krahasim me vitin 2011, ndërsa numri i burrave ka rënë vetëm për 2.3%. Tabela sugjeron se ky trend po vazhdon edhe në vitin 2014, ku gratë deri më tani e përbëjnë 47% të pranuesve të pensionit për aftësi të kufizuar. Kjo mund të sugjerojë që gratë me aftësi të kufizuar mund të mos kenë qasje për t'u regjistruar që ta marrin këtë pension.

Tabela 35. Pensioni i planifikuar për aftësi të kufizuar kundrejt buxhetit të shpenzuar

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar
2011	€ 13,213,000	€ 11,136,615	84.3%
2012	€ 13,213,000	€ 11,558,210	87.5%
2013	€ 12,564,000	€ 14,271,180	113.6%
2014 (mars)	€ 12,564,000	€ 4,826,715	38.4%

Tabela 36. Buxheti për pensionin për aftësi të kufizuar sipas vitit dhe gjinisë së përfituesit

Viti	Buxheti i përgjithshëm vjetor	Buxheti i përgjithshëm i grave përfituese	Nr. i përgjithshëm i grave përfituese	Buxheti i përgjithshëm vjetor i burrave përfitues	Nr. i përgjithshëm i burrave përfitues	% e buxhetit të përgjithshëm për gra	% e buxhetit të përgjithshëm për burra
2011	€ 11,136,615	€ 5,430,985	10,741	€ 5,705,630	11,064	49%	51%
2012	€ 11,558,210	€ 5,524,285	10,018	€ 6,033,925	10,810	48%	52%
2013	€ 14,271,180	€ 6,840,490	10,594	€ 7,430,690	11,334	48%	52%
2014 (mars)	€ 4,826,715	€ 2,281,465	9,575	€ 2,545,250	10,454	47%	53%

Pensioni i parakohshëm për punëtorët e Trepçës

Udhëzimi administrativ nr. 10/2007 për pensionimin e parakohshëm të punëtorëve të kompleksit Trepça dhe minierave të tjera me mihje nëntokësore në Kosovë e rregullon pensionimin për personat që kanë punuar në kompleksin Trepça dhe minierat e tjera. Përfituesit duhet të jenë të moshës 50-65 vjeçe, të cilëve i paraqitet paaftësia për punë dhe nuk mund të kurohen me mjekim të mëtejshëm, si dhe ata të cilëve aftësia për punë u është zvogëluar më shumë se përgjysmë.¹⁰⁷ Përfituesit duhet t'i kenë 10 ose më shumë vjet përvojë pune; të jenë banorë të përhershëm të Kosovës; mos të jenë përfitues të skemave të tjera financiare; mos të kenë burime të tjera të të ardhurave; dhe ta kenë shkëputur kontratën e punës me Trepçën ose me minierat e tjera.

¹⁰⁷ Udhëzim për pensionim të parakohshëm për punëtorët e kompleksit "Trepça", dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë, Udhëzimi administrativ nr. 10/2007. 2007, ne: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.10-2007%20Për%20Pensionim%20të%20Parakohshëm%20për%20Punëtorët%20e%20Kompleksit%20TREPÇA.pdf>.

Pensioni i Trepçës përfshinë një shumë mujore prej 50 eurove nga APK. Buxheti i vitit 2014 për këtë vijë buxhetore është €3,414,600. APK nuk mundi ta jepte numrin e përfituesve për secilin vit për shkak se ky informacion mirëmbahet drejtpërdrejt prej Trepçës. Megjithatë, APK deklaroi se të gjithë pranuesit e pensionit të Trepçës janë burra. Të dhënat sugjerojnë se edhe gratë kanë punuar në Trepçë, edhe pse me gjasë në numër më të vogël sesa burrat.¹⁰⁸ Mund të mblidhen informata shtesë për të parë se pse gratë nuk marrin beneficione ashtu si kolegët e tyre burra.

Për çdo vit MPMS-ja ka planifikuar një buxhet mes 11% dhe 14% më shumë për këtë vijë buxhetore (shih tabelën 37). Buxheti i shpenzuar nuk ishte në dispozicion ende, sipas informatave të muajit mars 2014. Megjithatë, trendi i shpenzimeve nga vitet e mëparshme sugjeron se MPMS-ja mund ta zvogëlojë paksa këtë vijë buxhetore dhe ta shfrytëzojë dallimin e fondeve të mbetura për financimin e pensioneve të tjera në të cilat ka mungesë fondesh.

Tabela 37. Buxheti i planifikuar i pensioneve të Trepçës kundrejt buxhetit të shpenzuar

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar	Vlerësim i RrGGK, nr. i përfituesve
2011	€ 3,612,829	€ 3,099,430	86%	5,165
2012	€ 3,612,829	€ 3,168,170	88%	5,280
2013	€ 3,414,600	€ 3,033,190	89%	5,055
2014	€ 3,414,600	NA	NA	

Pensioni i Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Ligji nr. 03/L-100 për pensionet e pjesëtarëve të TMK-së e rregullon të drejtën e pensionit për pjesëtarët aktivë të TMK, dhe të trashëgimtarëve të tyre pas shpërbërjes së TMK-së. Personat me të drejtë të këtij pensionin përfshijnë të afërmit e varur të pensionistëve të TMK-së, të cilët kanë vdekur (bashkëshorti/bashkëshortja në kohën e vdekjes së tij, fëmijët nën moshën 18 vjeç në kohën e vdekjes së tij, dhe të afërmit e tjerë të varur).¹⁰⁹ Pensioni i TMK-së e obligon APK-në t'u lëshojë pagesa mujore ish pjesëtarëve të TMK-së gjatë tërë jetës. Pagesa bazohet në pozitën që pjesëtari i TMK-së e ka mbajtur gjatë viteve të shërbimit.

Buxheti i shpenzuar për pensionet e TMK-së ka rënë me kalimin e kohës (shih tabelën 38). Në shumicën e viteve, MPMS-ja ka ndarë buxhet më të madh për këtë lloj të pensionit. Për shembull, në vitin 2011, u shpenzua vetëm 40% e buxhetit.¹¹⁰ MPMS-ja ka ndarë më tepër buxhet për këtë pension edhe në vitin 2012 për 43%. Megjithatë, në vitin 2013, MPMS-ja kishte një deficit prej 46% për këtë vijë buxhetore, e cila u mbulua përmes vijave të tjera të buxhetit në kuadër të ministrisë, dhe prej fondeve të marra prej ministrive të tjera në fund të vitit. Sipas të dhënave të muajit mars 2014, 38% e buxhetit është shpenzuar, që sugjeron se pensioni i TMK-së mund ta tejkalojë sërish buxhetin në këtë vit.

Tabela 38. Buxheti i planifikuar për pensionet e TMK dhe ai i shpenzuar

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar
2011	€ 2,572,900	€ 1,018,421	40%
2012	€ 2,572,900	€ 1,471,055	57%
2013	€ 1,224,000	€ 1,781,911	146%
2014	€ 1,224,000	€ 460,316	38%

Janë dukshëm më shumë burra (96-97%) sesa gra (3-4%) që e marrin këtë pension (shih tabelën 39). Kjo mund t'i atribuohet faktit se gratë e kanë përbërë TMK-në vetëm për 3.59%.¹¹¹ Anëtarët e familjes e kanë të drejtën e beneficionit, dhe 29 persona (përfshirë 29 gra

¹⁰⁸ Palairt, Michael for European Stability Initiative, Lessons Learned and Analysis, *Trepça 1965-2000*, ESI/LLA, 2003, në: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf, f. 17.

¹⁰⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, ligji nr. 03/L-100*, Prishtinë, 2012, në: <http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2010/09/Law-No.-04-L-101.pdf>.

¹¹⁰ Të dhënat janë marrë prej APK, maj 2014.

¹¹¹ ASK, *Gratë dhe burrat*, Prishtinë: ESK, mars 2009, cituar në RrGGK, *1325 fakte dhe fabula*, RrGGK: Prishtinë, 2011, f. 74, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130120165559661.pdf>.

dhe një burrë) përfitojnë nga kjo e drejtë.¹¹² Në vitin 2014, APK-ja planifikon të investojë në krijimin e një baze të re të të dhënave për regjistrimin e numrit të përfituesve të pensionit të TMK-së dhe të buxheteve përkatëse.

Tabela 39 sugjeron se mesatarisht burrat kanë marrë më shumë beneficione për kokë (€170-€187 në muaj) sesa femrat (€127-€154). Ky dallim mund t'i atribuohet dallimit të pozitës që kanë pasur gratë dhe burrat në TMK, ku tendenca ka qenë që burrat të kenë pozita më të larta dhe të paguheshin më mirë sesa gratë. Ky dallim vazhdon të shihet edhe në tremujorin e parë të vitit 2014.

Tabela 39. Buxheti për përfituesit e pensioneve të TMK-së sipas vitit dhe gjinisë

Viti	Buxheti i përgjithshëm vjetor	Buxheti i përgjithshëm vjetor për gra	Nr. i përgjithshëm i grave përfituesve	% e buxhetit për gratë	€ për kokë gruaje në muaj	Buxheti i përgjithshëm vjetor për burra	Nr. i përgjithshëm i burrave përfitues	% e buxhetit për burra	€ për kokë burri në muaj
2012	€ 1,471,055	€ 48,793	32	3%	€127	€ 1,422,262	699	97%	€170
2013	€ 1,781,911	€ 64,462	35	4%	€154	€ 1,717,449	767	96%	€187
2014 (mars)	€ 460,316	€ 17,004	36	4%	€ 157	€ 443,312	775	96%	€190

Pensioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ligji nr. 04/L-084 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" e rregullon dhënien e pensioneve për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe për familjet e tyre.¹¹³ Ndryshe prej pensioneve të tjera, përfituesit e kanë të drejtën e pensionit të FSK-së, pavarësisht nëse janë të punësuar, përveç nëse shërbejnë në FSK. Megjithatë, ata duhet të zgjedhin mes këtij pensioni dhe pensioneve që janë në dispozicion të tyre përmes ligjeve të tjera të aplikueshme. Nëse pjesëtari i FSK-së apo pensionisti vdes, familja e tij ose e saj e marrin "Pensionin familjar" mujor. Personat që kanë të drejtë për këtë pension përfshijnë bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët trashëgimtarë (duke përfshirë fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar), dhe prindërit. Pensioni i FSK-së është një pagesë e rregullt mujore e llogaritur në pajtim me vitet e shërbimit.

Siç shihet në tabelën 40, MPMS-ja ka ndarë vazhdimisht më shumë buxhet për këtë pension: 96% më shumë në vitin 2012 dhe 63% më shumë në 2013. Shpenzimet gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 sugjerojnë se mund të ketë mbetje të serishme të buxhetit edhe gjatë këtij viti.

Nga skema pensionale e FSK-së përfitojnë dukshëm më shumë burrat (91-94%) sesa gratë (6-9%) (shih tabelën 41).¹¹⁴ Kjo mund t'i atribuohet pjesërisht faktit që gratë e përbënin vetëm 7% të kësaj force në vitin 2011, 8% në vitin 2012, dhe 8.1% në vitin 2014.¹¹⁵ Numri i përfituesve burra është rritur çdo vit; me 89.6% nga 2012 në 2014.¹¹⁶ Bashkëshortët/bashkëshortet e pjesëtarëve të vdekur të FSK-së kanë të drejtë të aplikojnë; deri më tani vetëm tre pjesëtarë të FSK-së kanë vdekur në detyrë.¹¹⁷ Tabela 41 tregon se gratë

Tabela 40. Buxheti i planifikuar për pensionin e FSK-së dhe ai i shpenzuar sipas vitit

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar
2012	€ 648,049	€ 25,402	4%
2013	€ 631,200	€ 234,559	37%
2014 (mars)	€ 631,200	€ 77,286	12%

¹¹² Letërkëmbim i RrGGK me TMK, maj 2014.

¹¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 04/L-084 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës"*, Prishtinë: 2012, në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20pensions%20of%20members%20of%20the%20KSF.pdf>, neni. 4.

¹¹⁴ Të dhënat e marra prej APK, mars 2014.

¹¹⁵ Për 2011-2012, Republika e Kosovës, Ministria e Forcave të Sigurisë (MFS), Të drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore në MFS/FSK, Qershor, 2013, fq 10. Për 2010, Farnsveden et al. for Orgut, Profili Gjiner i Vendit, fq.8.

¹¹⁶ Beneficionet kanë filluar në vitin 2012.

¹¹⁷ Korrespondenca e RrGGK me Departamentin e Personelit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 23 maj 2014. Dy prej tri familjeve janë duke e marrë ndihmën sociale, ndërsa një familje është

mesatarisht marrin pension më të lartë mujor për kokë sesa burrat. Kjo ka rezultuar në faktin se sipas të dhënave të vitit 2014 vetëm pesë gra dhe 110 burra janë duke marrë pensione; kur e kemi parasysh mesataren, këto gra mbase kanë shërbyer më gjatë ose kanë pasur pozita më të larta sesa niveli mesatar i pozitive që kanë mbajtur burrat që janë duke e marrë këtë pension.

Meqë FSK-ja u themelua në vitin 2008, numri i përfituesve mund të vazhdojë të rritet. Këto trende duhet të përcillen me qëllim që të planifikohet më me efikasitet buxheti.

Tabela 41. Buxheti i përfituesve të pensionit të FSK-së sipas vitit dhe gjinisë

Viti	Buxheti i përgjithshëm vjetor	Buxheti i përgjithshëm vjetor për gra	Nr. i përgjithshëm i grave përfituese	% e buxhetit për gra	€ për kokë gruaje në muaj	Buxheti i përgjithshëm vjetor për burra	# i burrave përfitues	% e buxhetit për burra	€ për kokë burri në muaj
2012	€25,402	€ 2,331	2	9%	€97	€23,071	58	91%	€33
2013	€234,559	€ 18,732	5	8%	€312	€215,827	100	92%	€180
2014 (mars)	€77,286	€ 4,917	5	6%	€328	€72,369	110	94%	€219

Pensioni për personat e verbër

Në bazë të ligjit nr. 04/L-092, personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre e kanë të drejtën e marrjes së pensionit.¹¹⁸ Ata marrin pensione në bazë të përqindjes së pagës minimale në Kosovë, në shumën jo më pak se €100 në muaj që përcaktohet me akt nënligjor të qeverisë. Zbatimi i këtij ligji ka filluar në vitin 2014. Qeveria e ka përcaktuar beneficinin në shumën prej 100 euro në muaj për personin e verbër dhe €100 në muaj për shoqëruesin apo shoqëruesen. Megjithatë, në pajtim me vendimin e fundit të qeverisë kjo shumë është rritur për 25%, kështu që secili person merr €125 në muaj duke filluar nga muaji prill 2014. MPMS-ja e ka futur këtë si vijë të veçantë buxhetore duke filluar me buxhetin e vitit 2014.¹¹⁹ Ligji thekson se personat e verbër mund ta zgjedhin shoqëruesin e tyre. Megjithatë, APK ka deklaruar se ka mungesë të informatave sa i përket transfereve që duhet të bëhen tek shoqëruesit.¹²⁰ Kjo mund të sqarohet përmes një udhëzimi administrativ.

Gjatë katër muajve të parë të vitit 2014, MPMS-ja e ka shpenzuar afërsisht 40% të buxhetit të përgjithshëm të planifikuar (shih tabelën 42); sipas informatave të muajit mars 2014, MPMS-ja duhej ta kishte shpenzuar vetëm 25% të këtij buxheti. Kjo sugjeron se MPMS-ja do të përballet me vështirësi për t'i kryer të gjitha pagesat ndaj personave të verbër dhe shoqëruesve të tyre deri në fund të vitit 2014. Kjo pritej pasi MPMS-ja nuk kishte shifra të sakta sa i përket numrit të personave me të drejtë kompensimi kur e kishte planifikuar buxhetin e vet në vitin e kaluar.

Tabela 43 tregon se më shumë burra të verbër e marrin këtë pension (60%) në krahasim me gratë (40%).¹²¹ Kjo mbase për shkak të normave tradicionale gjinore në Kosovë, ku tendenca ka qenë që feramat të jenë ato që kujdesen për të tjerët – gratë (60%) shërbejnë si shoqëruese të personave të verbër në krahasim me burrat (40%). Jo të gjithë personat e verbër që marrin pension kanë shoqërues. Kjo nënkupton se ose nuk kanë të drejtë për një gjë

Tabela 42. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për personat e verbër sipas muajit mars 2014

	2014
Buxheti i planifikuar	€ 1,800,000
Buxheti i shpenzuar	€ 722,305
% e shpenzuar	40%

në proces të aplikimit për këtë ndihmë pasi pjesëtari i FSK-së ka vdekur së voni. Të tre këta pjesëtarë të FSK-së janë burra.

¹¹⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për personat e verbër, ligji nr. 04/L-92*, Prishtinë, në: www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20for%20blind%20persons.pdf, neni. 3.

¹¹⁹ Buxheti i Kosovës 2014.

¹²⁰ Intervistë me APK, 16 prill 2014

¹²¹ Të dhënat e marra prej Administratës Pensionale të Kosovës, maj 2014.

të tillë për shkak të kategorisë së përcaktuar të verbërisë ose nuk janë të informuar plotësisht për të drejtat e tyre.

Tabela 43. Pensionet e marra nga personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre janar-mars 2014, të ndarë sipas gjinisë

2014 (prill)	Buxheti i përgjithshëm m vjetor	Buxheti i përgjithshëm vjetor për gratë	Nr. i përgjithshëm m i grave përfituese	% e buxhetit të përgjithshëm m për gra	Buxheti i përgjithshëm vjetor për burra	Nr. i përgjithshëm i përfituesve burra	% e buxhetit të përgjithshëm për burra
Kompensimi për të verbërinë	€395,315	€ 156,355	396	40%	€ 238,960	597	60%
Shoqëruesi/-ja	€326,990	€ 196,275	462	60%	€ 130,715	309	40%

Pensioni bazë kontribut-pagues

Një vendim i qeverisë i vitit 2009, i përcjellë me një udhëzim administrativ, ua mundësonte individëve, të cilët mund të dëshmonin se kanë punuar për së paku 15 vjet para vitit 1999, të kenë të drejtën e përfitimit të €35 më shumë mbi pensionin bazë, që arrin një shumë prej €140.¹²² Përfituesit duhet të dëshmojnë se janë së paku 65 vjeç, se kanë punuar së paku shtatë vjet e shtatë muaj në Kosovë për periudhën e përmendur më herët prej 15 vjetëve, dhe nuk janë përfitues të skemave të tjera pensionale në Kosovë ose në ish republikat e Jugosllavisë (duke përjashtuar pensionet e UÇK-së dhe TMK-së).

Në vitin 2011, MPMS-ja kishte planifikuar buxhet prej 14% më shumë sesa kishte shpenzuar (shih tabelën 44). Në vitet e tjera, MPMS-ja e kishte qenë efiçase në ndarjen e buxhetit për këtë skemë pensionesh. Megjithatë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, MPMS-ja e ka shpenzuar afërsisht 37% të kësaj vije buxhetore. Kjo sugjeron se APK-ja mund të përballet me mungesë të fondeve për këtë skemë pensionale deri në fund të vitit.

Tabela 44. Pensioni bazë kontribut-pagues i planifikuar në buxhet dhe i shpenzuar

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzur
2011	€ 37,000,000	€ 31,667,570	86
2012	€ 41,700,000	€ 42,034,448	101%
2013	€ 47,897,475	€ 49,412,649	103%
2014 (mars)	€ 47,897,475	€ 17,949,724	37%

Numri i përgjithshëm i përfituesve është rritur me kalimin e kohës, prej 11.7% për gratë dhe 4.3% për burrat mes vitit 2012 dhe 2013. Burrat përbëjnë një shumicë të dukshme të përfituesve të pensioneve bazë kontribut-pagues (shih tabelën 45).¹²³ Në vitin 2013, burrat i kanë përfituar 89% të kësaj skeme pensionale, ndërsa gratë i kanë përfituar vetëm 11%. Dallimi mes numrit të grave dhe burrave përfitues mund t'i atribuohet faktit se më pak gra kanë punuar në Kosovë gjatë 15 vjetëve para vitit 1999. Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore nuk ka kaluar asnjëherë 18% gjatë viteve 1960-ta, ajo ishte 21% gjatë të 70-tave, dhe arriti në 23% në vitin 1998.¹²⁴ Zyrtarët e MPMS sugjerojnë se shumica e grave që punonin kanë qenë serbe, të cilat janë larguar nga Kosova, gjë që mund të shpjegoj hendekun gjinore.¹²⁵ Edhe po të jetë kështu, përsëri më shumë gra mund ta kenë të drejtën për këtë pension, dhe se MPMS-ja duhet të merr hapa për t'i informuar gratë.

Po ashtu është interesante të shihet se edhe pse ky pension e ka një shumë standarde prej 140 eurove për person në muaj, në realitet gratë dhe burrat nuk e marrin shumën e njëjtë. Mbase ky dallim mund t'i atribuohet pezullimit të pensionit, i cili ndodh kur përfituesi nuk i

¹²² Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Udhëzimi administrativ nr. 15/2009, për rritjen e pensioneve për zbatimin e vendimit të qeverisë nr. 02/51*, korrik 2009, në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.15-2009%20Për%20Rritjen%20e%20pensioneve%20për%20zbatimin%20e%20Vendimit%20të%20Qeverisë%20Nr.02-51.pdf>, Nen. 4.

¹²³ Të dhënat e marra prej APK, maj 2014.

¹²⁴ Surtees, Rebecca for UNIFEM, *Women at Work: The economic situation and opportunities for Women in Kosovo*, Prishtina: UNIFEM, 2000, ff. 23-24.

¹²⁵ Punëtori, 4 qershor 2014.

raporton APK-së ose komunës çdo gjashtë muaj. Mbase për shkak të përgjegjësive të tjera, mungesës së fondeve, pamundësisë që ta lënë vet shtëpinë për shkak të ndonjë situatë, gratë mund ta kenë të vështirë që të paraqiten me kohë për t'i kërkuar beneficionet e tyre. APK-ja mund ta realizojë ndonjë hulumtim për të parë se pse më pak gra e marrin këtë pension krahasuar me burrat.

Tabela 45. Buxheti për përfituesit e pensioneve kontribut-paguese sipas vitit dhe gjinisë


Viti	Buxheti i përgjithshëm vjetor	Buxheti i përgjithshëm vjetor për gratë përfituese	Nr. i përgjithshëm i grave përfituese	% e përgjithshëm të përgjithshëm m për gra	Buxheti i përgjithshëm vjetor për burrat përfituese	Nr. i përgjithshëm i burrave përfituese	% e buxhetit të përgjithshëm për burra
2011	€ 31,667,570	€ 3,009,745	3,351	10%	€ 28,657,825	31,794	90%
2012	€ 42,034,448	€ 4,243,531	3,798	10%	€ 37,790,917	33,450	90%
2013	€ 49,412,649	€ 5,294,325	4,245	11%	€ 44,118,324	34,918	89%
2014 (mars)	€ 17,949,724	€ 1,986,956	4,277	11%	€ 15,962,768	34,121	89%

Rekomandime

- Të përfshihen aktivitete të caktuara në strategjitë e komunikimit për t'u siguruar se gratë, në veçanti, janë të informuara për të drejtat e tyre. Fokusi duhet të vendoset tek informimi i grave me aftësi të kufizuara, gratë e verbra, gratë që kanë punuar në Trepçë, dhe gratë e tjera që mund të jenë përfituese të mundshme të pensionit kontribut-pagues.
- Të bëhet një studim i thellë nga perspektiva gjinore në sistemin e pensioneve për ta kuptuar më mirë sesi gratë dhe burrat përfitojnë prej sistemit të pensioneve në kuadër të kategorive të ndryshme.
- Të përfshihen regues dhe aktivitete të caktuara për rritjen e proporcionit të grave përfituese të këtyre kategorive të pensioneve.
- Të sqarohet përmes një udhëzimi administrativ se si duhet të bëhet transferi i mjeteve shoqëruarve të personave të verbër.

DEPARTAMENTI PËR PUNË DHE PUNËSIM

Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP) i MPMS-së është përgjegjës për hartimin, bashkërendimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe të aftësisimit profesional.¹²⁶ Në kuadër të departamentit janë Divizioni për Politika dhe Punësim, Divizioni për Aftësi Profesionale, dhe Divizioni për Koordinimin dhe Monitorimin e Zyrave të Punës. Shërbimet Publike të Punësimit (SHPP) ofrojnë shërbime përmes një rrjeti që përbëhet prej shtatë zyrave rajonale të punësimit (ZRP),¹²⁷ prej 23 zyrave komunale të punësimit, tetë Qendrave të Aftësisimit Profesionalë (QAP), dhe gjashtë njësi mobile të trajnimit.



¹²⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji i punës, ligji nr. 03/L-212*, Prishtinë: 2010, në:

<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>.

¹²⁷ QRP-të (dhe zyrat komunale të punësimit) gjenden në: Prishtinë (Obiliq, Fushë Kosovë, Podujevë, Lipjan, Drenas, Graçanicë, Novo Bërde); Pejë (Istog, Klinë); Prizren (Suharekë, Dragash, Rahovec); Mitrovicë (Vushtrri, Skënderaj); Gjakovë (Deçan, Malishevë); Ferizaj (Kaçanik/Hani i Elezit, Shtime, Shtërpce); dhe Gjilan (Kamenicë, Viti).

Divizioni për Koordinimin dhe Monitorimin e Zyrave të Punësimit

Buxheti për financimin e SHPP u rrit mes vitit 2011 dhe 2014. Tabela 46 e paraqet buxhetin e përgjithshëm të planifikuar për çdo vit, për të financuar DPP dhe ZP-të në Kosovë. Duke i pasur parasysh kategoritë e shpenzimeve dhe nën programet buxhetore, Departamenti për Buxhet dhe Financa në MPMS nuk mund ta bëjë vlerësimin e buxhetit të përgjithshëm të shpenzuar prej secilës ZP. Andaj, informacionet janë dhënë për tërë Kosovën.

Tabela 46. Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për Divizionin për Koordinimin dhe Monitorim të SHPP

Buxheti i planifikuar	Nr. i punonjësve ¹²⁸	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Investimet kapitale
2011	201	€ 816,724	€ 550,000	€ 116,000	€ 7,850,001	€ 579,340
2012	201	€ 816,726	€ 550,000	€ 126,000	€ 4,151,951	€ 445,000
2013	201	€ 836,367	€ 550,000	€ 151,000	€ 4,251,951	€ 365,000
2014	201	€ 827,130	€ 471,480	€ 93,000	€ 2,286,901	€ 705,000

Personeli i punësuar në nivelin qendror dhe në ZP, që kap shifrën e 201 punonjësve, financohet përmes kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Numri i punonjësve nuk ka ndryshuar që prej vitit 2011. Buxheti për mallra dhe shërbime dhe komunalitë i mbulon shpenzimet operative të ZP-ve. Investimet kapitale janë shfrytëzuar për themelimin e ZP-ve të reja dhe për zgjerimin e shërbimeve të ZP-ve. Ky buxhet është plotësuar edhe përmes përkrahjes së agjencive të tjera (p.sh. Lux Development dhe UNDP-së), të cilat e kanë përkrahur themelimin e zyrave të reja, të politikave dhe programeve të reja. Megjithatë, Departamenti për Buxhet dhe Financa i MPMS-së nuk mund të jepte informata sa i përket shumës së mjeteve që janë alokuar në secilën ZP.

Subvencionet dhe transferet janë shfrytëzuar për financimin e nismave të reja për programet aktive të tregut të punës, dhe për beneficionet e pushimit të lehonisë (shih më poshtë). MPMS-ja nuk ka informata sa i përket programeve aktive të tregut të punës të realizuara gjatë viteve.¹²⁹

Zyrat e Punësimit

Zyrat e Punësimit (ZP) janë përgjegjëse për regjistrimin e të papunësuarve, realizimin e hulumtimeve të tregut të punës, ofrimin e informatave të tregut të punës për punëkërkuarit, udhëzimin në karrierë dhe këshillimet për aftësim profesional, si dhe shërbimet e ndërmjetësimit.¹³¹ Qendrat për Aftësim Profesional (QAP) gjenden në Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Dolan.

Tabela 47. Punëkërkuarit e regjistruar sipas vitit dhe gjinisë¹³⁰

Viti	Nr. i përgjithshëm i punëkërkuarve	% e grave	Nr. i përgjithshëm i grave të regjistruara	% e burrave	Nr. i përgjithshëm i burrave të regjistruar
2011	325,261	49%	157,922	51%	167,339
2012	259,341	46%	119,374	54%	139,967
2013	268,104	46%	124,369	54%	143,735
2014 (mars)	148,104	46%	67,741	54%	80,393

¹²⁸Të dhënat e ndara sipas gjinisë për punonjës ishin vetëm në nivel të ministrisë e jo të ndara për secilin departament.

¹²⁹ Shkalla deri në të cilën janë shpenzuar këto vija buxhetore nuk u vunë në dispozicion nga MPMS-ja.

¹³⁰ Të dhënat e ofruara pres secilës QRP në Kosovë deri në mars 2014.

¹³¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuarve*, ligji nr. 04/L-083, Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2012, në:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20for%20registration%20and%20records%20of%20unemployed%20and%20job%20seekers.pdf>, Art. 8.

Tabela 47 paraqet numrin e punëkërkuessve të regjistruar në Kosovë në vitin 2011-2014.¹³² Numri i punëkërkuessve të regjistruar ka rënë nga viti 2011 në 2012 për 24.4% dhe është rritur në vitin 2013 për 3.37%. Një përqindje më e lartë e punëkërkuessve gra, në krahasim me burrat, del se e kanë ndërprerë procesin e kërkimit të një vendi të punës. Numri i grave punëkërkuessve ka rënë për 34% nga viti 2011 në 2012, ndërsa numri i burrave punëkërkuessve ka rënë për 16.4%. Sipas shënimeve të muajit mars 2014, ZP-të kishin regjistruar 148,104 punëkërkuess (46% gra dhe 54% burra).¹³³ Është mjaftë interesante se përkundër rënies së punëkërkuessve gra mes vitit 2011 dhe 2012, numri i grave që e kërkojnë një punë mbetet i njëjtë.

Afërsisht 46% e personave të papunësuar dhe të regjistruar në QRP janë gra.¹³⁴ Në vitin 2013, ZP-të u ndihmuan 4,729 personave që ta sigurojnë një vend pune (tabela 48), prej të cilëve vetëm 34% ishin gra.¹³⁵ Në përgjithësi, prej 268,104 punëkërkuessve të regjistruar atë vit, vetëm 1.28% e grave dhe 2.18% e burrave të regjistruar e siguruan nga një vend pune. Kjo nënkupton se gati dy herë më shumë burra se gra u punësuan përmes ndihmës së ZP-ve në vitin 2013.¹³⁶ Kjo diferencë mund të shpjegohet për faktin se QRP-të kanë punësuar më shumë burra përmes projekteve të punëve publike, punë të cilat konsiderohen si më të përshtatshme për burrat se sa për gratë.¹³⁷

Tabela 48. Punëkërkuessit e punësuar përmes ZP-ve sipas gjinisë dhe vitit

Viti	Nr. i përgjithshëm i personave të punësuar përmes ZP	Nr. i përgjithshëm i grave të punësuar përmes ZP	Nr. i përgjithshëm i burrave të punësuar përmes ZP	% e përgjithshme e të punësuarve që janë gra	% e përgjithshme e të punësuarve që janë burra	% e përgjithshme e punëkërkuessve (tabela 47) të punësuar	% e grave punëkërkuessve të punësuar përmes ZP-ve	% e burrave punëkërkuessve të punësuar
2011	7,484	2,366	5,118	32%	68%	2.30%	1.50%	3.06%
2012	7,692	1,819	5,873	24%	76%	2.97%	1.52%	4.20%
2013	4,729	1,590	3,139	34%	66%	1.76%	1.28%	2.18%
2014 (mars)	631	210	421	33%	67%	0.43%	0.31%	0.52%

Numri i personave të punësuar përmes SHPP-ve është rritur për 2.55% në vitin 2012, dhe ka rënë për 38.5% në 2013. Ky ndryshim ka pasur ndikim të ndryshëm në shkallën e punësimit të grave dhe burrave. Krahasuar me 2011, 23.12% më pak gra dhe 46.5% më pak burra u punësuan në krahasim me vitin 2012.

Duke e pasur parasysh se si menaxhohet buxheti në kuadër të MPMS-së, ky raport nuk mund të bënte vlerësimin e shumës së shpenzuar në ndihmë të grave dhe burrave për të gjetur një vend pune. Megjithatë, të dhënat sugjerojnë se burrat kanë përfituar më shumë sesa gratë nga shërbimet e ofruara nga ZP-të. Në fund, burrat kanë tendencë që të regjistrohen më tepër sesa gratë në ZP-të si punëkërkuess. Gjersa ZP-të kanë pasur sukses në ndihmën e tyre karshi një numri të vogël të punëkërkuessve të regjistruar për të gjetur punë, prapë duket se ZP-të u mundësojnë më shumë burrave sesa grave gjetjen e një vendi të punës.

Rekomandimet

- Të përmirësohet sistemi për monitorimin e shpenzimeve të secilës QRP dhe ZP.

¹³² Të dhënat janë nxjerrë prej raporteve vjetore të publikuara nga DPP, MPMS për secilin vit.

¹³³ Ibid.

¹³⁴ DPP, Raporti i performancës, raporti vjetor 2011, 2012 dhe 2013.

¹³⁵ Të dhënat janë nxjerrë prej raporteve vjetore të publikuara nga DPP, MPMS për secilin vit.

¹³⁶ Këto të dhëna u referohen vetëm shërbimeve të ofruara përmes shërbimeve publike të punësimit, dhe në to nuk përfaqësohen personat e punësuar përmes projekteve të financuara përmes organizatave ndërkombëtare apo burimeve të tjera të financimit.

¹³⁷ Punëtori me MPMS, 4 qershor 2014.

- Të rritet numri dhe kështu edhe proporcioni i grave të regjistruara në ZP përmes informimit aktiv të zyrtarëve të ZP në bashkërendim të plotë me grupet lokale të grave.
- Të rritet përqindja e punëkërkuesve të punësuar, veçanërisht të punëkërkuesve gra, përmes më shumë iniciativave aktive të zyrtarëve të ZP për identifikimin e mundësive të punësimit.
- Të identifikohen programe të cilat i kanë cak gratë; t'u kërkohet kontraktuesve të përdorin kuota për gratë dhe burrat gjatë implementimit të projekteve të punëve publike.

Pushimi i lehonisë

Pushimi i lehonisë monitorohet, administrohet dhe buxheti për të planifikohet në kuadër të DPP-së. Sipas *ligjit të punës*, secili përfitues ka të drejtë për 12 muaj pushim nga puna.¹³⁸ Së këndejmi, Kosova e ka pushimin më të gjatë të lehonisë në rajon. Përfitues të këtij ligji është nëna ose babai në rast kur nëna vdes ose e braktisë fëmijën. DPP pranon aplikacione nga ZP brenda dhjetë ditësh pas aplikimit.¹³⁹ Ligji i punës përbën diskriminim ndaj burrave në cilësinë e babait.

Punëdhënësi është i obliguar t'i ofrojë punonjësit kompensim të pagës për 70% të rrogës bazë, sipas kontratës së personit në fjalë, për gjashtë muaj. Qeveria pastaj paguan 50% të pagës mesatare në Kosovë për tre muaj. Gjatë tre muajve të fundit, përfituesi mund të merr pushim të lehonisë pa kompensim.

Qeveria e ka llogaritur pagën mesatare prej 292 eurove në muaj për çdo vit nga viti 2011 deri 2014.¹⁴¹ Paga mesatare nuk është rritur në pajtim me të dhënat e anketës së fuqisë punëtore, e cila tregon se paga mesatare në Kosovë është dukshëm më e lartë (shih tabelën 49). Megjithatë, kjo çështje është marrë parasysh në planifikimin buxhetor për vitin 2015, ku MPMS-ja do të fillojë ta përdor shumën prej 374 euro si pagë mesatare.

Studimet sugjerojnë se punëdhënësit i kanë diskriminuar gratë që kanë qenë shtatzëna ose të moshës së shtatzënisë, duke përdor kontrata afatshkurtra, kontrata të dyfishta, dhe punësim jo ligjor.¹⁴² Punëdhënësit ndjehen se ligji i diskriminon ata, duke ua vënë një barrë të madhe. Përveç pagesës prej 70% të pagës së individit, ata duhet të paguajnë edhe për zëvendësimin e përkohshëm. Studimi i njëjtë

Tabela 49. Paga mesatare

Viti	E përdorur nga MPMS	Publiku ar prej ASK ¹⁴⁰
2011	€ 292	€ 368
2012	€ 292	€ 372
2013	€ 292	€ 374
2014	€ 292	€ 364
2015	€ 374	

Tabela 50. Përfituesit e pushimit të lehonisë

Viti	Nr. i përgjithshëm dhe % e shërbyesve civil përfitues		Nr. i përgjithshëm dhe % e përfituesve të sektorit publik		Nr. i përgjithshëm dhe % e përfituesve në sektorin privat		Nr. i përgjithshëm i përfituesve
2011	86	18%	256	54%	128	27%	470
2012	203	18%	560	50%	363	32%	1,126
2013	238	19%	570	45%	462	36%	1,270
2014 (mars)	73	15%	200	41%	211	44%	484

¹³⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji i punës, nr. 03/L-212*, Prishtinë: 2010, në: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/PrimarAnglisht/Law%20No.03%20L-212%20LAW%20ON%20LABOUR.pdf>, neni. 49.

¹³⁹ Udhëzimi administrativ për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave administrative të pagesës financiare për pushimin e lehonisë, U.A. Nr.05/2011, 2011, në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.05-2011%20Për%20Rregullimin%20dhe%20Përcaktimin.pdf>.

¹⁴⁰ ASK, Kumtesë për shtyp, 2012, në: <http://ask.rks-gov.net/zyra-e-shtypit/602-komunikate-per-media-kosova-ne-shifra-2012>.

¹⁴¹ Informatat e dhëna nga DPP, prill 2014.

¹⁴² Për analizimin e këtyre, shih Farnsveden et al. for Orgut, *Country Gender Profile*, 2014, f. 12. Shih po ashtu Ramosaj, A. Challenges in implementation of the maternity leave in Kosovo, University of Munich, 2012, Munich Personal RePREc Archive, at: <http://mpra.ub.uni-muenchen.de/38913/>.

tregon se inspektorati i punës ka mungesë të mjeteve për monitorimin e zbatimit të këtij ligji për shkak të numri të kufizuar të inspektorëve të punës, buxhetit të pamjaftueshëm, dhe burimeve të kufizuara teknike. Ligji i punës aktualisht është duke u rishikuar.

Numri i përfituesve të pushimit të lehonisë është rritur për 170% që prej se ka filluar zbatimi i ligjit (shih tabelën 50). Këtë beneficion e kanë shfrytëzuar më shumë gra që punojnë në sektorin publik sesa ato që punojnë në sektorët e tjerë.¹⁴³ Megjithatë, për ta kuptuar nëse gratë e sektorëve të caktuar kanë prirje ta marrin pushimin e lehonisë më shumë sesa gratë e disa sektorëve të tjerë, atëherë nevojiten informata shtesë sa i përket sektorëve ku gratë punojnë më shumë. Nevojiten gjithashtu informata shtesë edhe sa i përket tregut jo formal, pasi shumë prej

grave mund të jenë të punësuar në sektorin privat, por nuk janë të regjistruara; dëshmitë sugjerojnë se gratë janë të mbi-përfaqësuara në sektorin joformal.¹⁴⁴ Numri i grave që e marrin pushimin e lehonisë duket i ulët kur e kemi parasysh se 33,966 gra kanë lindur në vitin 2010.¹⁴⁵ Në pajtim me ligjin, po thuaj të gjithë përfituesit e pushimit të lehonisë janë gra.

Tabela 51. Pushimi i lehonisë (Divizioni për punësim, subvencione dhe transfere)

Viti	Buxheti i përgjithshëm për shërbyesit civilë	Buxheti i përgjithshëm për sektorin publik	Buxheti i përgjithshëm për sektorin privat	Buxheti i përgjithshëm
2011	€ 37,668	€ 112,128	€ 56,064	€ 205,860
2012	€ 88,914	€ 245,280	€ 158,994	€ 493,188
2013	€ 104,244	€ 249,660	€ 202,356	€ 556,260
2014 (mars)	€ 31,974	€ 87,600	€ 92,418	€ 211,992

Rekomandime

- Të bëhen më shumë inspektime nga Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës e Kosovës lidhur me zbatimin e ligjit të punës dhe të pushimit të lehonisë.
- Të merret parasysh paga mesatare sipas anketës së fuqisë punëtore të publikuar për çdo vit nga ASK.
- T'u kërkohet Institutit Kombëtar të Shëndetit dhe ASK-së që të mbledhin dhe të raportojnë të dhëna për statusin e punësimit të nënave që lindin.
- Të përfshihet edhe pushimi i atësisë në ligjin e ri të punës me qëllim që të zvogëlohet diskriminimi gjinor.
- Të inkurajohen investimet institucionale në objektet e kujdesit për fëmijë, drejt përmbushjes së standardeve të BE-së për kujdesin ndaj fëmijëve. Kjo do t'u mundësonte më shumë grave (dhe burrave) të kthehen më shpejt në vendin e punës pasi të jenë përmirësuar kushtet e kujdesit ndaj fëmijëve sidomos për fëmijët nën moshën një vjeçare.¹⁴⁶

Divizioni për Aftësi Profesionale

Buxheti për financimin e tetë QAP në tërë Kosovën është rritur brenda vitit 2011 dhe 2014. Tabela 52 e paraqet buxhetin e përgjithshëm për financimin e QAP-ve, dhe të trajnimeve të ofruara sipas moduleve të hartuara nga Divizioni për Aftësi Profesionale (DAP).¹⁴⁷

¹⁴³ Punëtorët e shërbimit publik janë të zgjedhur ose të emëruar, ndërsa shërbyesit civil janë punëtor të punësuar në departamente të ndryshme të qeverisë.

¹⁴⁴ Farnsveden et.al. for Orgut, *Country Gender Profile*, 2014.

¹⁴⁵ ASK, *Statistikat e lindjeve në Kosovë në vitin 2010*, Prishtinë: ASK, 2011, në: http://ask.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat_view/8-population/80-births.

¹⁴⁶ Farnsveden et al. për Orgut, *Country Gender Profile*, 2014.

¹⁴⁷ Ky buxhet përfshin vetëm buxhetin e ndarë nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës, dhe nuk i përfshin projektet e financuara nga organizatat ndërkombëtare.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në DAP dhe QAP është rritur për pesë punëtorë në vitin 2012 dhe ka mbetur po ai që atëherë.

Tabela 52. Buxheti i planifikuar për QAP-të

Viti	Nr. i përgjithshëm i punonjësve	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale
2011	92	€ 378,231	€ 350,000	€ 72,000	€ 450,000	€ 916,860
2012	97	€ 378,231	€ 316,237	€ 62,000	€ 450,000	€ 820,000
2013	97	€ 394,231	€ 316,237	€ 62,000	€ 450,000	€ 1,010,000
2014	97	€ 416,189	€ 316,237	€ 62,000	€ 300,000	€ 675,000

Këtu përfshihet edhe numri i trajnerëve të QAP-ve të punësuar nga MPMS-ja për të ofruar trajnime të individualizuara për punëkërkuarit e regjistruar në ZP. Kategoritë e mallrave dhe të shërbimeve dhe shpenzimeve kapitale i financojnë shpenzimet operative të QAP-ve në tërë Kosovën. Ngjashëm me ZP-të, Departamenti për Buxhet dhe Financa në MPMS, nuk ka mundur ta ndaj buxhetin veçmas për QAP.

Duke e pasur parasysh se QAP-të janë të centralizuara, buxheti është kategorizuar brenda një shpenzimi, dhe se të gjitha shpenzimet për trajnime mbulohen përmes kontraktimit të dy kompanive. Ato i financojnë QAP-të në bazë të kërkesave. Kërkesat dërgohen përmes DAP dhe sekretarit të përhershëm të MPMS-së. Investimet kapitale shfrytëzohen për financimin e hapjes së QAP-ve të reja.

QAP-të ofrojnë trajnime të individualizuara për secilin person të interesuar, të referuara nga QRP-të. Llojet e trajnimeve ndryshojnë në secilën QAP. Në Prishtinë e Ferizaj, llojet e ofruara të trajnimit janë më të larmishme (shih shtojcën 3). Në përgjithësi gjatë vitit 2011, 3,241 persona kanë marrë pjesë në trajnimet e ofruara nga QAP-të anë e këndë Kosovës; 46% ishin gra, dhe 54% ishin burra (tabela 53). Numri i pjesëmarrësve gra ka pësuar rënie të lehtë në krahasim me burrat në vitin 2012, për 3.36% krahasuar me 0.1% përkatësisht. Në vitin 2013, QAP-të ofruan trajnime të ndryshme profesionale për 3,279 persona; 44% ishin gra.¹⁴⁸

Tabela 53. Pjesëmarrësit në trajnimet e QAP dhe punëkërkuarit e regjistruar në ZP, sipas gjinisë

Viti ¹⁴⁹	Pjesëmarrësit në QAP	% e grave pjesëmarrës	Nr. i grave pjesëmarrës	Nr. i grave punëkërkuar	% e grave punëkërkuar cilat iu nënshtruan trajnimeve	% e pjesëmarrës	Nr. i burrave	Nr. i burrave punëkërkuar	% e punëkërkuar cilët iu nënshtruan trajnimeve
2011	3,241	46%	1,485	157,922	0.94%	54%	1,756	167,339	1.05%
2012	3,190	45%	1,435	119,374	1.20%	55%	1,755	139,967	1.25%
2013	3,279	44%	1,443	124,369	1.16%	56%	1,836	143,735	1.28%

Duket qartë se shumë pak punëkërkuar të regjistruar kanë marrë pjesë deri më tani në trajnimet e QAP-ve. Si për gratë edhe për burrat, vetëm rreth një për qind e të gjithë punëkërkuarve kanë marrë pjesë nëpër trajnime për çdo vit. Për përmirësimin e shkathtësive të punëkërkuarve sipas kërkesave të tregut, QAP-të duhet të jenë aktive që t'i përfshijnë në trajnime si gratë ashtu edhe burrat punëkërkuar.

Është mjaft interesante të vërejmë se përqindja e grave që marrin pjesë në trajnime dhe pajisen me certifikatë është pak më e lartë se ajo e burrave. Në vitin 2013, 88% e grave dhe 81% e burrave që kanë marrë pjesë në trajnime u certifikuan (shih tabelën 54). Përqindja si e grave ashtu edhe e burrave që kanë marrë pjesë në

Tabela 54. Pjesëmarrësit e certifikuar sipas vitit dhe gjinisë

Viti	Pjesëmarrësit e certifikuar në përgjithësi	% e grave të certifikuar	Nr. i grave të certifikuar	% e burrave të certifikuar	Nr. i burrave të certifikuar
2011	2,450	76%	1,132	75%	1,319
2012	2,531	80%	1,150	78%	1,372
2013	2,754	88%	1,264	81%	1,493

¹⁴⁸ Informatat e marra prej DAP, prill 2014.

¹⁴⁹ Numri i pjesëmarrësve përkon vetëm me trajnimet e financuara përmes buxhetit të Kosovës. Të dhënat e ofruara nga DAP, prill 2014.

trajnime dhe janë certifikuar është rritur me kalimin e viteve, dhe është rritur më shumë për gratë. Të jesh i trajnuar dhe i certifikuar përmes QAP-ve i rrit mundësitë e punëkërkesve në gjetjen e punësimit përmes ZP-ve.¹⁵⁰

Më shumë gra (15-16%) se burra (7-8%) i kanë braktisur trajnimet gjatë viteve 2011-2013 (Tabela 55). Nëse njerëzit e fillojnë një trajnim, por nuk e kryejnë atë, atëherë kjo paraqet mos efikasitet të shpenzimeve. Ekziston mundësia që njerëzit e braktisin trajnimin për shkak se

kanë gjetur një vend pune, e që do të përbënte në realitet një trajnim shumë efektiv. Për t'i siguruar investimet e veta në trajnime, QAP-të mund ta monitorojnë çështjen e braktisjes së trajnimeve nga pjesëmarrësit. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e rritjes së mundësisë që personat e përfshirë në trajnim ta kryejnë atë deri në fund. Pasi që më shumë gra e braktisin trajnimin krahasuar me burrat, atëherë do të ishte e dobishme që të bëhet një analizë e kësaj dukurie nga perspektiva gjinore me qëllim që të reagohet në mënyrë efektive ndaj saj.

Duke marrë parasysh mënyrën sesi menaxhohet buxheti në kuadër të MPMS-së, ky raport nuk mund të bëjë një vlerësim të shumës së shpenzuar për përfituesit gra dhe burra. Megjithatë, sipas të dhënave për përfituesit, burrat përfitojnë më shumë sesa gratë për shërbimet e ofruara nga QAP-të.

Rekomandimet

- Të sigurohet që proporcioni i grave dhe i burrave në trajnime të përkojë me proporcionin e grave dhe burrave që janë të papunë.
- Të përfshihen tregues dhe aktivitete të caktuara për rritjen e numri të grave pjesëmarrëse në trajnime. Këtu përfshihen edhe strategjitë e komunikimit për t'i informuar gratë në veçanti për mundësitë e trajnimit dhe të sigurohet që trajnimet të jenë të llojeve të ndryshme dhe që zgjojnë interesin e grave dhe burrave për sigurimin e një vendi të punës.
- Të analizohen arsyet për nivelin e lartë të braktisjes, përfshirë edhe atë nga aspekti gjinor. Kjo mund të bëhet përmes anketave, ose përmes realizimit të thirrjeve telefonike me personat që e kanë braktisur trajnimin me qëllim që të identifikohen arsyet e braktisjes së tyre.
- Të vlerësohet kostoja e trajnimeve për lloje të ndryshme të trajnimeve në bazë të vendndodhjes.
- Të analizohen nevojat e grave dhe burrave të papunë, dhe të vlerësohet shkalla e përmbushjes së nevojave të tyre nga këto trajnime, në kontekstin e kërkesave në tregun e punës.

Tabela 55. Braktisja e trajnimeve të QAP-së sipas gjinisë dhe vitit

Viti	Nr. i përgjiths hëm i të braktisur ve	Nr. i të braktisur ve	% e braktisjeve nga gratë	Nr. i grave që e kanë braktisur trajnimin	% e braktisjev e nga burrat	Nr. i burrave që e kanë braktisur trajnimin
2011	11%	358	15%	224	8%	132
2012	11%	340	15%	221	7%	119
2013	11%	355	16%	235	7%	120

¹⁵⁰ MPMS, DPP, Raporti vjetor 2013.

NJË ANALIZË E SHPEJTË GJINORE E KATEGORIVE KRYESORE TË SHPENZIMEVE

Kapitulli shkurtimisht merret me analizimin e trendeve buxhetore, duke i krahasuar shpenzimet aktuale, të cilat lidhen me kategoritë e përgjithshme të shpenzimeve të ministrisë për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale; dhe shpenzimet e tjera. Edhe pse kufizimi kohor e përjashton një analizë të stërholluar të secilës prej këtyre kategorive të shpenzimeve nga perspektiva gjinore, gjithsesi se kjo mund të jetë një fushë për hulumtimet e ardhshme. Në ndërkohë, ekzaminimi i trendeve të efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve sipas vijave buxhetore mund të ndihmojë në planifikimin e buxhetit. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e fushave të mundshme prej të cilave mund të ri-alokohen mjetet për t'i mbështetur vijat e tjera buxhetore që kanë pasur historikisht mungesë të fondeve.

PAGAT DHE MËDITJET

Kategoria e pagave dhe e mëditjeve ka për qëllim financimin e shpenzimeve për punonjës në MPMS. Përveç pagave, përmes kësaj kategorie financohen edhe shpenzimet që lidhen me punën shtesë të kryer nga punonjësit e MPMS-së, si pjesëmarrja në komisionet ministriore. Megjithatë kjo e fundit financohet përmes kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Me qëllim që të identifikohet ndonjë diskriminim i mundshëm gjinor në punësim dhe në ofrimin e shërbimeve, mund të analizohen informatat e të punësuarve të MPMS-së, të ndara sipas gjinisë. Në MPMS, burrat përbënin 56-58% të punonjësve në vitin 2011-2013, dhe gratë 42-44% (shih tabelën 56).

Tabela 56. Pagat dhe mëditjet në MPMS sipas vitit dhe gjinisë

	2011		2012		2013	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
Nr. i punonjësve	494	407	503	411	477	389
% e punonjësve	55%	45%	55%	45%	55%	45%
Buxheti vjetor ¹⁵¹	€2,099,127	€1,563,642	€2,147,481	€1,578,311	€2,143,054	€1,654,029
% e buxhetit sipas gjinisë	57%	43%	58%	42%	56%	44%

Së këndejmi, shihet se një përqindje më e madhe e pagave dhe mëditjeve ka shkuar për burrat në krahasim me gratë (56-58%), që është relative kundrejt proporcionit të punonjësve në ministri (55%). Kjo ndodh për shkak se është tendencë që burrat të kenë paga më të larta se gratë (shih tabelën 57). Ekziston një hendek i dukshëm gjinor në mesin e përfituesve të pagave të larta (ata që fitojnë më shumë se €601). Gjersa gratë përbënin 15% të përfituesve të pagave të larta në vitin 2011, asnjë grua nuk ka shërbyer në kategorinë e pagave më të larta në vitin 2012 ose 2013 (shih tabelën 57a). Fakti që asnjë grua nuk ka shërbyer në pozitë me kompensim të lartë paraqet një problem gjinor, i cili duhet të përmirësohet përmes politikave të punësimin. Mungesa e grave në rolet vendimmarrëse mund të ndikojë në masë të dukshme tek politikave dhe programet, të cilat duhet t'i kenë parasysh prioritetet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

¹⁵¹ Shifrat janë të rrumbullakuara.

Tabela 57a. Numri i punonjësve të MPMS sipas nivelit të pagave dhe gjinisë, 2011-2013

Niveli mujor i pagave	2011				2012				2013			
	Burra	%	Gra	%	Burra	%	Gra	%	Burra	%	Gra	%
€ 200-400	352	51%	345	49%	362	51%	348	49%	348	49%	357	51%
€ 401-600	125	68%	59	32%	126	67%	63	33%	135	67%	67	33%
€ 601 dhe më shumë	17	85%	3	15%	15	100%	0	0%	14	100%	0	0%

Tabela 57b. Pagat dhe mëditjet e MPMS-së sipas nivelit të pagave dhe gjinisë, 2011-2013

Niveli mujor i pagave	2011				2012				2013			
	Buxheti total për burra	% e buxh etit për burra	Buxheti total për gra	% e buxh etit për gra	Buxheti total për burra	% e buxh etit për burra	Buxheti total për gra	% e buxh etit për gra	Buxheti total për burra	% e buxh etit për burra	Buxheti total për gra	% e buxh etit për gra
€200-400	€1,296,671	51%	€1,246,961	49%	€1,338,555	52%	€1,260,551	48%	€1,297,394	50%	€1,311,716	50%
€401-600	€638,724	68%	€294,101	32%	€645,391	67%	€317,759	33%	€692,353	67%	€342,312	33%
€ 601 dhe më shumë	€ 63,731	88%	€22,578	12%	€163,533	100%	€ -	0%	€153,306	100%	€ -	0%

Siç ilustron në tabelën 57c, brenda nivelit të njëjtë të pagave, gratë duket të marrin pak më pak pagë mesatare për kokë sesa burrat, në të gjithë nivelet e pagave.

Tabela 57c. Paga mesatare e punonjësve të MPMS sipas nivelit të pagave dhe gjinisë, 2011-2013

Niveli mujor i pagave	2011 - paga mesatare			2012 - paga mesatare			2013 - paga mesatare		
	Total	Burra	Gra	Total	Burra	Gra	Total	Burra	Gra
€ 200-400	€304	€307	€301	€305	€308	€302	€308	€311	€306
€ 401-600	€422	€426	€415	€424	€427	€420	€426	€427	€426
€ 601 dhe më shumë	€776	€803	€627	€908	€909	€0	€912	€913	€0

MPMS-ja i përmbush obligimet e veta të parapara me *ligjin për barazi gjinore* që së paku të ketë 40% të të punësuarve burra dhe 40% gra. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja më e barabartë e grave dhe burrave në të gjitha nivelet mund të kontribuonte në shpenzime më të barabarta nga perspektiva gjinore, si dhe do ta përmirësonte cilësinë e shërbimeve të ofruara për klientët gra dhe burra.

Rekomandime

- Të monitorohet hendeku i pagave nga aspekti gjinor.
- Të përcaktohen treguesit drejt rritjes së proporcionit të grave të punësuar në nivelet e larta në kuadër të MPMS.
- Të ndërmerren aktivitete për promovimin e grave në pozita më të larta në ministri.
- Të inkurajohen gratë aplikuese për këto pozita në shpalljet e vendeve të lira të punës.
- Të merret parasysh themelimi i politikave afirmative të veprimit dhe të programeve monitoruese për inkurajimin e më shumë grave që të kenë qasje në pozita të larta brenda ministrisë.

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Kjo kategori e shpenzimeve është shtjelluar në masë të madhe në kuadër të diskutimit të departamenteve më lartë, megjithatë në këtë seksion është paraqitur vetëm një pasqyrë të përgjithshme. Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për mallra dhe shërbime të MPMS-së është rritur ndër vite, por ai i shpenzuar është zvogëluar në vitin 2013. MPMS-ja ka shpenzuar më tepër sesa buxheti i planifikuar për 8% në vitin 2011, për 15% në vitin 2012; ndërsa në vitin 2013 ka shpenzuar 9% më pak sesa ka planifikuar (shih tabelën 58).

MPMS-ja nuk ka ofruar të dhëna se si e ka shpenzuar këtë buxhet. Andaj është e vështirë të bëhen analiza të mëtejme nga perspektiva gjinore. Një ekzaminim nga afër i shpenzimeve aktuale mund të hidhte dritë ndaj ndonjë diskriminimi të mundshëm gjinor në lidhje me këtë kategori të shpenzimeve. Për shembull, meqë kjo vijë buxhetore është shfrytëzuar për financimin e pjesëmarrjes së punonjësve të MPMS-së në komisionet ministriore, atëherë do të ishte e dobishme të bëhet një analizë gjinore sa i përket shkallës së kompensimit për gratë dhe burrat për punën e kryer shtesë.

MPMS-ja nuk ka mundur të ofrojë buxhet të ndarë sipas gjinisë sa i përket shumës së vijës buxhetore të mallrave dhe shërbimeve që janë shfrytëzuar për mëditje.¹⁵² Tabela 59 e paraqet shumën e buxhetit të shpenzuar në vitin 2011-2013 për shpenzime të udhëtimeve, dhe shpenzime të shërbimeve, duke i përfshirë edhe mëditjet.

Tabela 59. Buxheti i shpenzuar për personelin e MPMS-së

Vija buxhetore	2011	2012	2013
Shpenzime të udhëtimit	€ 186,221.00	€ 157,672.00	€ 145,045.43
Komunikim	€ 44,446.00	€ 45,162.00	€ 44,001.86
Shpenzime të shërbimeve	€ 468,429.00	€ 549,501.00	€ 458,036.54

KOMUNALITË

Në përgjithësi, MPMS-ja nuk e ka shpenzuar plotësisht buxhetin e planifikuar për komunalitet, 82-83% prej vitit 2011 deri 2013 (shih tabelën 60). Ekzaminimi i çfarëdo dallimi të mundshëm gjinor lidhur me këtë kategori të shpenzimeve ishte përtej fushëveprimit të këtij hulumtimi.

Tabela 60. Komunalitet: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar

Viti	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i planifikuar	% e shpenzuar
2011	€ 392,213	€ 475,424	82%
2012	€ 389,636	€ 475,424	82%
2013	€ 399,829	€ 478,924	83%

SHPENZIMET KAPITALE

MPMS-ja nuk e ka shpenzuar plotësisht buxhetin e planifikuar për kategorinë e investimeve kapitale (shih tabelën 61). Hulumtime të tjera do të mund t'i analizonin këto shpenzime nga perspektiva gjinore, duke përfshirë prioritetet, planifikimin, zbatimin, dhe fazën e shfrytëzimit.¹⁵³ Hulumtime të mëtejshme mund të bëhen në lidhje me: shpenzimet kapitale që janë bërë gjatë katër vjetëve të kaluara; kush i ka përzgjedhur këto shpenzime (burrat/gratë/të dy); kush ka ndihmuar në planifikimin e tyre (gratë/burrat/të dy); kush i ka zbatuar/ndërtuar ato (gratë/burrat), kush përfiton/i shfrytëzon tani më shumë (burrat/gratë/të dy).

Tabela 61. Shpenzimet kapitale sipas buxhetit të planifikuar dhe atij të shpenzuar, 2011-2013

Viti	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i planifikuar	% e shpenzuar
2011	€ 2,219,055	€ 2,608,160	85%
2012	€ 2,260,716	€ 3,115,000	73%
2013	€ 2,172,079	€ 2,950,000	74%

¹⁵² Mëditjet u jepen zyrtarëve publikë kur marrin pjesë në komisione, grupe punuese, konferenca, tryeza pune, etj.

¹⁵³ Analizat e tjera mund të përfshijnë një makro vlerësim të shpejtë të ndikimit të mundshëm të investimeve të mëdha kohëve të fundit nga perspektiva gjinore.

DREJT SË ARDHMES: VLERËSIMET BUXHETORE 2015- 2017

Ky kapitull i ka dy qëllime. Së pari, ai përpiqet që të bëjë vlerësime reale të shpenzimeve, të cilat duhet t'i planifikojë MPMS-ja në buxhetin e saj në periudhën afatshkurtë dhe afatmesme me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të veta me efikasitet dhe efektivitet për të mirën e grave dhe burrave. Vlerësimet bazohen në të dhënat e analizës gjinore të bërë në kapitujt e mëparshëm, përfshirë edhe trendet e përfituesve, të dhënat demografike, dhe statistikat e tjera relevante në dispozicion.

Së dyti, në kontekstin e KASH-it, ky kapitull vë në shfrytëzim të gjeturat e paraqitura në kapitullin e fundit për t'i furnizuar me informata objektivat specifike, treguesit e mundshëm, dhe aktivitetet për barazi gjinore. Përbushja e objektivave afatmesme dhe afatgjata në lidhje me barazinë gjinore, siç janë përvijuar në kornizën relevante ligjore të Kosovës (shih kapitujt paraprak), si dhe në mënyrë më specifike në kapitullin e KASH-it të MPMS-së, mund të realizohen përmes shfrytëzimit të analizës gjinore. Meqë ndryshimet shoqërore marrin kohë, dhe ndodhin në periudha afatmesme dhe afatgjata, me tepër sesa brenda një viti, atëherë KASH-i dhe treguesit e tij për vitin 2015-2017 ofrojnë një orientim të rëndësishëm për proceset e hap pas hapit drejt përbushjes së objektivave afatmesme. Analiza nga kapitulli paraprak mund të ndihmojë në krijimin e treguesve specifik, të qartë dhe të matshëm të progresit për përbushjen e objektivave të identifikuar në KASH. MPMS-ja mund t'i shfrytëzojë këta tregues të caktuar gjinor për t'i planifikuar aktivitetet, të cilat kontribuojnë në përbushjen e objektivave. Në këtë seksion është përfshirë vetëm diskutimi i divizioneve dhe i departamenteve për të cilat ka dhënë rekomandime ekipi hulumtues. Të tjerat nuk janë përfshirë.

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Këshilli mund t'i marrë parasysh pyetjet e mëposhtme gjatë përpilimit të buxhetit:

- A ka këshilli buxhet të mjaftueshëm për themelimin e standardeve për licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe zbatimin e tyre?
- A ka këshilli fonde të mjaftueshme për zbatimin e strategjisë së komunikimit, e cila i informon gratë dhe burrat, i inkurajon ata për të aplikuar që të licencohen në të gjitha nivelet, dhe atë në proporcion të barabartë?
- A ka këshilli strategji të qartë për llojet e shërbimeve sociale që do të licencohen për t'u siguruar që janë marrë parasysh barabartë si nevojat e grave ashtu edhe të burrave?¹⁵⁴
- A është pajtuar këshilli me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal dhe me komunat për ndarjet e buxheteve për ofrimin e trajnimeve për OJQ-të e licencuara dhe të punëtorëve socialë të QPS-ve?

TRUPA EKZEKUTIVE E INSPEKTORATIT TË PUNËS

Gjatë përpilimit të buxhetit, Inspektorati mund të marrë parasysh nëse ka burime të

¹⁵⁴ Dy pikat e fundit bazohen në rezultatet dhe treguesit e Strategjisë sektoriale të MPMS-së.

mjaftueshme për:

- Mbledhjen e të dhënave të ndara sa i përket lëndimeve dhe vdekjeve që rezultojnë prej marrëdhënies së punës, si dhe sa i përket sektorëve të inspektuar.
- T'u siguruar që sektorët dhe bizneset, të cilat tradicionalisht kanë pasur më shumë punonjës burra ose gra, të inspektohen në masë të njëjtë.
- Shtimin e numrit të inspektimeve të përgjithshëm dhe të inspektimeve të përbashkëta për çdo vit, duke përfshirë shtimin e inspektimeve për zbatimin e pushimit të lehonisë si dhe të diskriminimit të mundshëm ndaj grave për shkak të pushimit të lehonisë.¹⁵⁵
- Sigurimin e një bilanci të inspektorëve gra dhe burra, të cilët bëjnë inspektime.
- Monitorimin nga afër të ndikimit të mundshëm të shkurtimeve buxhetore që vijnë si rezultat i vendimit qeveritar për shkurtimin e buxhetit për mallra dhe shërbime për 20%, në veçanti se si ndikon kjo tek gratë dhe burrat.

DIVIZIONI PËR ÇËSHTJET E TRASHËGIMISË SË TMK-SË

Divizioni mund të marrë parasysh nëse ka mjete të mjaftueshme për krijimin dhe zbatimin e një strategjie komunikimi, e cila i informon ish-luftëtarët gra dhe burra në lidhje me programet dhe beneficionet në dispozicion të tyre.

DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE I FAMILJES

Divizioni i Shërbimeve Sociale

Objektivat specifike të DSHS, në bashkëpunim të ngushtë me komunat dhe QPS-të, mund të jenë:

- Rritja e proporcionit të përfituesve gra të shërbimeve sociale prej 35% nga 5% për çdo vit, duke arritur në 40% në vitin 2015, 45% në 2016, dhe 50% në 2017 e më tutje.
- Strategjia e komunikimit ekziston, duke përfshirë mënyra të informimit të grave dhe burrave, në mënyrë që të jenë në dijeni për shërbimet që janë në dispozicion të tyre dhe si të kenë qasje në to.
- Raporti vjetor përfshinë rezultate të anketave për vlerësimin e nevojave të ndryshme dhe nivelit të kënaqshmërisë së përfituesve të shërbimeve sociale, i ndarë sipas gjinisë dhe llojit të ofruar të shërbimit.
- Rritja e proporcionit të familjeve me vajza me aftësi të kufizuara që marrin ndihmë prej 47% në 50% deri në vitin 2017.
- Rritja e numrit të standardeve të shërbimeve sociale, duke i marrë parasysh nevojat specifike të grave dhe burrave.
- Mbledhja vjetore e të dhënave dhe analiza e tyre sa i përket gjinisë së fëmijëve nën përkujdesje të familjeve jo biologjike dhe të OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale.
- Ndryshimi i procedurave për financimin e strehimoreve 1) për të ofruar përkrahje në bazë të numrit të klientëve të strehuar në muaj, duke përfshirë të gjitha fondet e nevojshme për personelin dhe shpenzimet operative, të cilat mundësojnë kujdesin ndaj atyre klientëve; 2) t'u kërkohet strehimoreve që të ofrojnë informata sa i përket burimeve të financimit për shërbimet e njëjta; 3) t'u kërkohet strehimoreve që të mbledhin të dhëna sa i përket gjinisë së personave të strehuar (duke i përfshirë edhe ato për fëmijë) dhe periudhën e qëndrimit të tyre në ato strehimore.

¹⁵⁵ Ky buron prej treguesit në strategjinë sektoriale të MPMS-së.

- Kontraktimi i strehimoreve, të cilat ofrojnë strehim për djem dhe burra, dhe sigurimi i hapësirave të veçanta për djemtë dhe burrat (buxheti për shërbime strehuese në të ardhmen).
- Rritja e numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen prej OJQ-ve dhe që financohen përmes këtij divizioni, duke i pasur parasysh nevojat specifike të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.¹⁵⁶

Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar

Objektivat specifike për këtë divizion mund të përfshijnë:

- Të krijohen udhëzime të ndjeshme gjinore për institucionet e Shëndetit Mendor deri në vitin 2016
- Të kryhet deri në mesin e vitit 2015 dhe të përditësohet për çdo vit vlerësimi i kostos së ofrimit të shërbimeve në secilin institucion që mbështetet prej këtij divizioni, në bazë të nevojave reale të klientëve.
- Të vendoset për decentralizimin e institucioneve të këtij divizioni së bashku me komunat përkatëse, përmes dispozitave të qarta të KASH në qarkoren e buxhetit qendror dhe komunal.

Përveç këtyre, mund të bëhet edhe një aktivitet: ai i realizimit të vizitave të rregullta tremujore dhe të paparalajmëruara monitoruese, si dhe të bëhen hetime sa i përket rasteve të mundshme të dhunës seksuale dhe/ose diskriminimit ndaj rezidentëve.

Divizioni i Ndhmës Sociale

Shumat aktuale të beneficioneve të SNS-së janë llogaritur në 2002-2003 në bazë të çmimit të konsumimit të shportës minimale ushqimore. Indeksimi i UNDP-së për Kosovën 2014 për shportën minimale të ushqimit tregon se kjo kosto ka ndryshuar. Për ekonominë familjare me katër anëtarë, kostoja mesatare minimale duhet të jetë €164.25 në muaj. Vija buxhetore e ndihmës sociale për vitin 2015 mund të vlerësohet në bazë të mesatares së numrit të anëtarëve të familjes që kanë marrë ndihmë sociale në vitet e mëparshme (katër anëtarë), dhe të indeksimit të shportës minimale të ushqimit. Andaj, buxheti për ndihmë sociale, pas indeksit të shportës minimale të ushqimit, duhet të jetë **€55,069,109** për vitin 2015. Siç shihet në tabelën 62, kjo paraqet një dallim financiar prej afër €24,000,000.

Tabela 62 Vlerësimi i RrGGK për vitin 2015 për SNS (subvencionet dhe transferet) në bazë të shportës minimale të ushqimit

Lloji i beneficionit	Vlerësimi i RrGGK për numrin e përfituesve ¹⁵⁷	Vlerësimi i RrGGK (subvencione dhe transfere)	Vlerësimi i MPMS (subvencione dhe transfere)
SNS – kategoria 1 dhe 2	27,940	€ 55,069,109	€ 30,000,000

Tabela 63 i referohet KASH-it për 2015-2017. Për 2012 dhe 2013, tabela i paraqet shpenzimet aktuale, ndërsa numri në kllapa më poshtë e paraqet përqindjen e kategorisë së shpenzimeve buxhetore që janë shpenzuar fillimisht. Për 2015-2017, tabela i paraqet ndarjet e reja buxhetore të propozuara nga RrGGK në bazë të përlogaritjes së SNS, sipas *Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë*, duke përdorur indeksimin e shportës minimale të ushqimit dhe zvogëlimin e numrit të përfituesve.¹⁵⁸ Ky dallim mes shpenzimeve të buxhetuara aktualisht nga

¹⁵⁶ Ky bazohet në treguesin ekzistues të Strategjisë sektoriale të MPMS.

¹⁵⁷ RrGGK e ka llogaritur numrin e përfituesve në bazë të rënies së përqindjes që ka ndodhur për çdo vit. Shifra e vlerësuar është 14% më e ulët se shifra e përfituesve të regjistruar në vitin 2014.

¹⁵⁸ Numri total i përfituesve është zvogëluar 7-14% çdo vit.

MPMS-ja dhe vlerësimet e RrGGK ilustron përmes numrit në kllapa nën vlerësimin e ri të RrGGK në tabelë. Ashtu siç sugjerojnë vlerësimet për vitin 2015-2017, nevojitet një rritje e dukshme e buxhetit, në veçanti në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. MPMS-ja duhet ta bëjë indeksin e shportës minimale të ushqimit për çdo vit me qëllim që të rillogaritet shumat e ndihmës sociale.

Tabela 63. Vlerësimet e RrGGK për Buxhetin e Divizionit të Ndihmës Sociale për 2015-2017

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	€ 27,891,126 (97%)	€28,210,034 (99%)	€ 27,851,335	€ 55,755,102 (+€25,069,109)	€ 55,755,102 (+€25,069,109)	€ 55,755,102 (+€25,069,109)
Paga dhe mëditje	€ 54,927 (99%)	€58,831 (106%)	€ 58,631	€ 73,289	€ 73,289	€ 73,289
Mallra dhe shërbime	€ 105,933 (96%)	€ 99,436 (90%)	€ 110,204	€ 110,204	€ 110,204	€ 110,204
Komunali	€ 998 (40%)		€ 2,500	€ 2,500	€ 2,500	€ 2,500
Subvencione dhe transfere	€ 27,294,352 (97%)	€27,179,593 (100%)	€ 27,280,000	€ 55,069,109 (+€25,069,109)	€ 55,069,109 (+€25,069,109)	€ 55,069,109 (+€25,069,109)
Shpenzime kapitale	€ 434,916 (88%)	€ 872,175 (87%)	€ 400,000	€ 500,000	€ 500,000	€ 500,000

Përveç treguesve që janë identifikuar në KASH, divizioni i Ndihmës Sociale mund të përfshijë objektiva dhe tregues shtesë, si në vijim:

- Rritja e proporcionit të grave pranuese të transfereve të SNS 1 prej 46% në 50% deri në vitin 2017
- Rritja e proporcionit të grave pranuese të transfereve të SNS 2 (aktualisht 8%) për 2% për çdo vit, duke arritur në 14% në vitin 2017
- Hulmtimi të përfundojë në vitin 2015, i cili i identifikon arsyet se pse më shumë burra pranojnë transfere të kategorisë 2 të SNS në krahasim me gratë, dhe të jepen rekomandime të qarta për mënyrën e trajtimit të këtyre nga MPMS-ja.

Në vitin 2015, divizioni mund të planifikojë dhe ndajë buxhet që ta realizojë këtë aktivitet: realizimin e një hulmtimi se pse burrat marrin më shumë transfere sesa gratë. Kjo mund të realizohet ose me mjetet ekzistuese, duke e përfshirë personelin aktualë për zhvillimin e anketave me pranuesit e skemave, ose Divizioni mund të kërkojë buxhet shtesë në kuadër të subvencioneve dhe transfereve me qëllim të realizimit të këtij hulmtimi.

DEPARTAMENTI I FAMILJEVE TË DËSHMORËVE DHE INVALIDËVE TË LUFTËS

Buxheti i përgjithshëm i nevojshëm për vitin 2015 është llogaritur duke e pasur parasysh numrin e përfituesve në vitin 2013 dhe rritjen prej 25% të beneficioneve, të paraparë në vendimin e kryeministrit.¹⁵⁹ Andaj buxheti i nevojshëm për vitin 2015 është **€37,955,147**, që është mjaftë e përafërt me vlerësimin ekzistues të MPMS-së (shih tabelën 64). Megjithatë, për buxhetin e vitit 2015, MPMS-ja duhet ta ketë po ashtu parasysh ndryshimin e kohës së fundit, duke përfshirë kompensimin për personat që janë dhunuar seksualisht gjatë luftës.

Tabela 64. Vlerësimi i RrGGK për buxhetin e pensionit të invalidëve të luftës (subvencione dhe transfere)

Lloji i beneficionit	Vlerësimi i RrGGK për nr. e përfituesve	Vlerësimi i RrGGK (subvencione dhe transfere)	Vlerësimi i MPMS-së (subvencione dhe transfere)
Pensioni i invalidëve të luftës	13,196	€ 37,955,147	€ 38,000,000

¹⁵⁹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 01/176, 2014.

Siç ilustron në tabelën 65, RrGGK nuk propozon ndonjë ndryshim të buxhetit këtu. Megjithatë, nevojiten më shumë informata me qëllim që të vlerësohet kostoja e ofrimit të beneficioneve për gratë që janë dhunuar seksualisht gjatë luftës. Kjo duhet të kihet parasysh në buxhetin e vitit 2015, si dhe për vitet e ardhshme.

Tabela 65. Vlerësimi i RrGGK për buxhetin e pensioneve të invalidëve të luftës

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej ¹⁶⁰	€31,708,444 (103%)	€30,764,858 (104%)	€30,593,227	€38,165,088	€38,165,084	€38,165,084
Paga dhe mëditje	€79,364 (94%)	€76,690 (93%)	€83,027	€103,784	€103,784	€103,784
Mallra dhe shërbime	€61,245 (94%)	€48,076 (74%)	€53,300	€53,300	€53,300	€53,300
Komunali	€7,019 (88%)	€6,018 (75%)	€8,000	€8,000	€8,000	€8,000
Subvencione dhe transfere	€31,060,817 (103%)	€30,634,075 (104%)	€30,448,900	€38,000,000	€38,000,000	€38,000,000
Shpenzime kapitale	€500,000 (100%)					

Objektivat shtesë për këtë departament mund të jenë:

- Përshkrimi i detyrave të punës së punonjësve të përfshijë takime, së paku dy herë në vjet, me grupe të grave dhe dalja së paku dy herë në vit në media për t'i shpjeguar beneficionet dhe si mund të kenë qasje në to si gratë ashtu edhe burrat.
- Analizimi i shpenzimeve aktuale për grupe të caktuara, të ndarë sipas gjinisë, dhe të përgatitura për çdo vit.
- Përgatitja e raportit vjetor për nevojat dhe nivelin e kënaqësisë së përfituesve gra dhe burra.

Aktivitetet mund të përfshijnë: rishikimin e detyrave të punës; bashkëpunimin me masmedian dhe me grupe të grave, të cilat punojnë me gra të prekura nga lufta, duke siguruar që gratë të jenë të njoftuara për të drejtat e tyre për beneficione të veçanta; të bëhet kostoja dhe buxheti për ndryshimet e ligjit; analizimi i shpenzimeve për grupe të ndryshme të ndarë sipas gjinisë, dhe duke i përfshirë shpenzimet për kokë banori; dhe realizimin e analizës së nevojave të grave dhe burrave përmes anketave me përfitues ekzistues dhe të mundshëm.

DEPARTAMENTI I PENSIONEVE

Në përgjithësi, objektivat për departamentin e pensioneve mund të jenë:

- Të përgatitet strategjia e komunikimit me aktivitete të caktuara për t'u siguruar që gratë, në veçanti, të janë të informuara për të drejtat e tyre. Fokusi duhet të vendoset tek informimi i grave me aftësi të kufizuara, gratë e verbra, gratë që kanë punuar në Trepçë, dhe gratë e tjera që mund të jenë përfituese të mundshme të pensionit kontribut-pagues.
- Të kuptohet më mirë se si gratë dhe burrat përfitojnë prej sistemit të pensioneve në kuadër të kategorive të ndryshme, e që rezulton prej një studimi të thellë shikuar nga aspekti gjinor i sistemit të pensioneve, dhe i cili realizohet në vitin 2015.
- Përfshirja e treguesve dhe aktivitete të caktuara për rritjen e proporcionit të grave përfituese të këtyre kategorive të pensioneve.

¹⁶⁰ Të gjitha shifrat janë rrumbullakuar.

- Të hartohet udhëzimi administrativ, i cili e qartëson mënyrën se si duhet të bëhen transferet e mjeteve për shoqëruesit e personave të verbër

Rekomandime specifike që lidhen me secilin lloj të pensioneve janë dhënë në vijim.

Pensioni bazë

Tabela 66 e paraqet përqindjen e buxhetit të shpenzuar në krahasim me buxhetin e planifikuar në vitin 2012 dhe 2013 në kllapa nën shumën e përgjithshme të buxhetuar. Në përgjithësi, MPMS-ja ka shpenzuar 95-107% të buxhetit. Hendeku mes buxhetit dhe shpenzimeve aktuale lidhen kryesisht me komunalitë. Megjithatë, në buxhetin e vitit 2014, MPMS ka buxhetuar një shumë të ngjashme me atë të shpenzuar në 2013.

Duke e pasur parasysh rritjen e numrit të përfituesve gjatë viteve (4% në vit), dhe vendimin e qeverisë për rritjen e shumës së pensionit bazë për 25%, buxheti vjetor për financimin e pensioneve bazë për vitin 2015 duhet të jetë **€122,001,984**. Tabela 66 e paraqet, brenda kllapave nën këtë vlerësim (dhe vlerësimet e viteve të ardhshme), mungesën e buxhetit aktual për €3,967,484. Duke i marrë parasysh trendet demografike, MPMS-ja duhet t'i analizojë sërish shifrat për çdo vit, dhe mbase të vazhdojë ta rrit këtë vijë buxhetore për çdo vit pasi më shumë persona do të kualifikohen për të marrë këtë pension.

Tabela 66. Vlerësimi i RrGGK për buxhetin e pensionit bazë për vitin 2015-2017, bazuar në shpenzimet dhe trendet e viteve 2012-2013

Vija buxhetore	Të shpenzuara në 2012	Të shpenzuar në 2013	Buxheti në 2014	Buxheti në 2015	Buxheti në 2016	Buxheti në 2017
Gjithsej	€70,071,849 (95%)	€88,286,817 (107%)	€ 89,836,507	€123,191,624 (+€3,967,484)	€128,195,203 (+€3,395,063)	€133,250,486 (+€2,995,346)
Pagat dhe mëditjet	€568,055 (103%)	€557,401 (99%)	€ 573,952	€717,440	€717,440	€717,440
Mallrat dhe shërbimet	€302,810 (95%)	€314,282 (98%)	€ 311,200	€311,200	€311,200	€311,200
Komunalitë	€53,877 (70%)	€50,219 (75%)	€ 58,000	€51,000 (-€7,000)	€51,000 (-€7,000)	€51,000 (-€7,000)
Subvencionet dhe transferet	€69,147,107 (95%)	€87,290,234 (107%)	€ 88,693,355	€122,001,984 (+€3,974,484)	€126,882,063 (+€3,402,063)	€131,957,346 (+€3,002,346)
Shpenzimet kapitale		€ 74,680 (75%)	€ 200,000	€110,000	€233,500	€213,500

Pensioni për aftësi të kufizuar

Duke e pasur parasysh përqindjen e rritur të numrit të përfituesve në vitet paraprake (5% për çdo vit), dhe vendimin e qeverisë për rritjen e pensionit për 25%, atëherë buxheti vjetor për financimin e pensionit për aftësi të kufizuar për vitin 2015 duhet të jetë: **€20,721,960**. Siç shihet në tabelën 67, kjo kërkon një rritje prej €2,766,460 krahasuar me buxhetin aktual për vitin 2015. Duhet të bëhen rritje të tjera për vitin 2016 dhe 2017. Për më shumë, MPMS ka shpenzuar rreth 45% të buxhetit për mallra dhe shërbime në vitin 2013 dhe ka buxhetuar rreth dyfishin e kësaj shume në vitin 2014. Ndoshta buxheti i planifikuar për vitin 2015 mund të zvogëlohet për mallrat dhe shërbimet në €30,000, siç është propozuar në tabelën 67.

Tabela 67. Vlerësimi i RrGGK për pensionet e personave me aftësi të kufizuar për vitin 2015-2017, bazuar në trendet

Shpenzimet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	€ 11,649,159 (87%)	€ 14,345,209 (113%)	€ 12,683,202	€ 20,842,213 (+ €2,766,460)	€ 21,878,311 (+€3,741,058)	€ 22,966,213 (+€4,765,961)
Pagat dhe mëditjet	€ 75,184 (111%)	€ 75,040 (99%)	€ 72,202	€ 90,253	€ 90,253	€ 90,253
Mallrat dhe shërbimet	€ 53,298 (95%)	€ 25,076 (45%)	€ 47,000	€ 30,000 (- €17,000)	€ 30,000 (- €17,000)	€ 30,000 (- €17,000)
Komunalitë ¹⁶¹						
Subvencionet dhe transferet	€ 11,520,677 (87%)	€ 14,245,093 (113%)	€ 12,564,000	€ 20,721,960 (+€ 2,783,460)	€ 21,758,058 (+ 3,758,058)	€ 22,845,961 (+ 4,782,961)

Aktualisht KASH-i përfshinë tregues që lidhen me të drejtën ndaj këtij pensioni (p.sh., ligji nr. 2003/23); cilësinë e ofrimit të shërbimeve (p.sh. rivlerësimi sipas afateve”); dhe si janë buxhetuar shpenzimet (“shpenzimet krahasuar me vitet e mëparshme 2012-14”). Nga perspektiva gjinore, departamenti mund ta specifikojë treguesin në vijim të KASH-it, duke ia shtuar fjalët e propozuara në të zezë nga RrGGK.

- Ankesat e pranuar në lidhje me vlerësimet pozitive dhe negative të komisionit mjekësor, të ndarë sipas gjinisë;

Është me rëndësi të kihet parasysh se gratë do të jenë në mesin e përfituesve shtesë të këtij pensioni pasi ato aktualisht nuk e marrin këtë pension në masën e duhur, edhe pse ato kualifikohen proporcionalisht me burrat. Një objektiv mund të shtohet:

- Rritja e proporcionit të grave me aftësi të kufizuara që marrin pensione nga 48% të përfituesve në 2013 në 50% për çdo vit

Kjo mund të arrihet me informim aktiv përmes grupeve punuese me personat me aftësi të kufizuara, në veçanti me grupet e grave, si dhe përmes informatave të dhëna në media lidhur me të drejtat e tyre dhe si të kenë qasje në to. Departamenti mund t'i duhet të planifikojë buxhet shtesë për ta realizuar këtë aktivitet.

Pensioni i parakohshëm i punëtorëve të Trepçës

Duke e pasur parasysh se shifra e përfituesve nuk është në dispozicion, RrGGK e ka bërë vlerësimin e buxhetit të ardhshëm në bazë të faktit se buxheti për këtë pension nuk është shpenzuar së paku 11% për çdo vit. Përveç kësaj, u mor parasysh edhe vendimi i qeverisë për rritjen e shumës së këtij pensioni për 50%. Bazuar në këtë, RrGGK ka llogaritur se buxheti për vitin 2015 duhet të jetë **€4,049,308**. Duhet të bëhen llogaritje më të sakta për vitin 2016 dhe 2017 në bazë të numrit të pranuesve dhe të shpenzimeve reale.

Tabela 68. Vlerësimi i RrGGK për pensionet e parakohshme të Trepçës për vitin 2015-2017, në bazë të shpenzimeve dhe trendëve

Shpenzimet	Të shpenzuara në 2012	Të shpenzuara në 2013	Buxheti në 2014	Buxheti në 2015	Buxheti në 2016	2017
Gjithsej	€ 3,168,170 (88%)	€ 3,033,190 (89%)	€ 3,414,600	€ 4,049,308 (-€1,050,692)	€ 4,049,308 (-€1,050,692)	€ 4,049,308 (-€1,050,692)
Subvencionet dhe transferet	€ 3,168,170 (88%)	€ 3,033,190 (89%)	€ 3,414,600	€ 4,049,308 (-€1,050,692)	€ 4,049,308 (-€1,050,692)	€ 4,049,308 (-€1,050,692)

¹⁶¹ Departamenti nuk e planifikon buxhetin për komunalitë sepse komisionet mjekësore nuk kanë një hapësirë të veçantë për të punuar. Zakonisht vlerësimet bëhen në ndërtesat komunale, tek APK ose OJQ-të.

KASH-i përfshinë tregues sa i përket se kush duhet ta merr pensionin (p.sh., “Udhëzimi administrativ 02/2006; të moshës 50 deri 65 vjeçare; projektligji për skemat pensionale në procedurë, neni 10”), si dhe bazohet në “numrin e shfrytëzuesve të viteve paraprake 2012-14 për të arritur tek këto vlerësime, si p.sh: të dhënat nga menaxhmenti i kompleksit “Trepça”. Megjithatë, në bazë të informatave që i ka RrGGK (edhe pse ka mundësi të jenë të paplota), buxheti duhet të jetë €1,050,692 më pak sesa është buxhetuar.

Nga perspektiva gjinore, duhet të shtohet një tregues: “Rritja e numrit të përfituesve gra që kanë punuar në Trepçë”. Kjo mund të arrihet përmes aktiviteteve për shqyrtimin e regjistrave të Trepçës për identifikimin e personave që kualifikohen për këtë pension, posaçërisht grave; dhe përmes përpjekjeve për të kontaktuar me personat që mund ta gëzojnë këtë drejt për t’i njoftuar për të drejtat e tyre, në veçanti të grave. Ndoshta për këtë do të nevojiten fonde shtesë.

Pensionimi i TMK-së

Planifikimi buxhetor për pensionin e TMK-së kërkon që të kihet parasysh rritja e buxhetit të shpenzuar për secilin vit (21%) dhe vendim i qeverisë së Kosovës për rritjen e pensionit për 25%. Sipas vlerësimeve të RrGGK, buxheti për vitin 2015 duhet të jetë **€2,494,675**.

Tabela 69. Vlerësimi i RrGGK për pensionin e TMK-së për vitin 2015-2017, në bazë të shpenzimeve dhe trendeve të vitit 2012-2013

Shpenzimet	Të shpenzuara në 2012	Të shpenzuara në 2013	Buxheti në 2014	2015	2016	2017
Gjithsej	€ 1,728,500 (67%)	€ 1,780,278 (145%)	€ 1,224,000	€ 2,494,675 (- €385,325)	€ 3,018,557 (- €207,043)	€ 3,652,454 (+€81,253)
Subvencione dhe transfere	€ 1,728,500 (67%)	€ 1,780,278 (145%)	€ 1,224,000	€ 2,494,675 (- €385,325)	€ 3,018,557 (- €207,043)	€ 3,652,454 (+€81,253)

Pensionimi i FSK-së

Përqindja e rritur në buxhetin për pensionin e FSK-së për secilin vit (32%), buxheti i shpenzuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 (12%), dhe vendimi i qeverisë për rritje të pensionit për 25% kanë shërbyer si informata për vlerësimin e bërë nga RrGGK se buxheti për vitin 2015 duhet të jetë **€510,087**. Kjo shifër është dukshëm më e vogël se buxheti aktual (shih tabelën 70).

Tabela 70. Vlerësimi i RrGGK për pensionin e FSK-së për vitin 2015-2017, sipas shpenzimeve dhe trendeve të vitit 2012-2013

Shpenzimet	Të shpenzuara në 2012	Të shpenzuara në 2013	Buxheti në 2014	Buxheti në 2015	Buxheti në 2016	Buxheti në 2017
Gjithsej	€ 25,402 (4%)	€ 234,559 (37%)	€ 631,200	€ 510,087 (- €363,913)	€ 673,315 (- €436,685)	€ 888,776 (-€487,624)
Subvencione dhe transfere	€ 25,402 (4%)	€ 234,559 (37%)	€ 631,200	€ 510,088 (- €363,913)	€ 673,316 (- €436,685)	€ 888,777 (-€487,624)

Pensionimi për personat të verbër

RrGGK e ka bazuar vlerësimin e vet të buxhetit në numrin e përfituesve sipas informatave të muajit prill 2014, të numrit të përfituesve të mundshëm që do të aplikojnë për pension, dhe të vendimit të qeverisë për rritje të pensionit për 25%. Buxheti i vlerësuar për vitin 2015 për pensionet e personave të verbër është **€5,592,000**. Kjo shifër është përafërsisht €1,217,000 më e madhe sesa e buxhetit aktual. Përderisa trendet e numrit të përfituesve duhet të monitorohen, ky numër, megjithatë, nuk duhet të ketë rritje të dukshme me kalimin e kohës. Andaj, aktualisht, buxheti i njëjtë është vlerësuar edhe për vjetët e ardhshme (shih tabelën 71).

Tabela 71. Vlerësimi i RrGGK për pensionet e personave të verbër për vitet 2015-2017, bazuar në shpenzimet dhe trendet e viteve 2012-2013

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	NA	NA	€ 1,800,000	€ 5,592,000 (+ €1,217,000)	€ 5,592,000 (+ €1,217,000)	€ 5,592,000 (+ €1,217,000)
Subvencionet dhe transferet	NA	NA	€ 1,800,000	€ 5,592,000 (+ €1,217,000)	€ 5,592,000 (+ €1,217,000)	€ 5,592,000 (+ €1,217,000)

Treguesit e KASH-it përfshijnë: "Ligjin nr. 04/L-092, të dhënat nga Shoqata e të Verbërve; kërkesat e shqyrtuara dhe numri real i pagesave = 813; kërkesat që janë në pritje për shqyrtim = 982". Në bazë të analizës gjinore në kapitullin e mëparshëm, mund të përfshihet edhe një tregues shtesë: "Rritja e proporcioneve të grave të verbra që marrin pensione nga 40% në 50% deri në vitin 2016". Për ta bërë këtë, departamenti duhet të komunikojë me Shoqatën e Grave të Verbra për ta ndihmuar shpërndarjen e informatave lidhur me këtë pension tek anëtarët e saj, si dhe tek gratë e tjera përmes medias. Ndoshta për këtë do të nevojiten fonde shtesë.

Pensioni bazë kontribut-pagues

Duke e pasur parasysh rritjen e numrit të përfituesve gjatë viteve (6% për vit) dhe vendimit të qeverisë për rritjen e pensionit bazë për 25%, vlerësimet e RrGGK për buxhetin vjetor për financimin e pensioneve bazë kontribut-pagues për vitin 2015 duhet të jetë **€69,741,470**. Siç ilustron në tabelën 72, kjo shifër është €1,253,470 më e madhe se buxheti aktual për vitin 2015. Buxheti duhet të vazhdojë të rritet në secilin vit pasi më shumë persona i plotësojnë kriteret për ta gëzuar të drejtën e këtij pensioni.

Tabela 72. Vlerësimi i RrGGK për pensionet kontribut-pagues për vitet 2015-2017, në bazë të shpenzimeve dhe trendeve të vitit 2012-2013

Shpenzimet	Të shpenzuara në 2012	Të shpenzuara në 2013	Buxheti në 2014	Buxheti në 2015	Buxheti në 2016	Buxheti në 2017
Gjithsej	€ 42,037,781 (101%)	€ 49,412,649 (103%)	€ 47,897,475	€ 69,741,470 (+€1,253,470)	€ 73,925,958 (+€2,098,958)	€ 78,361,516 (+€3,181,515)
Subvencionet dhe transferet	€ 42,037,781 (101%)	€ 49,412,649 (103%)	€ 47,897,475	€ 69,741,470 (+€1,253,470)	€ 73,925,958 (+€2,098,958)	€ 78,361,516 (+€3,181,515)

Në kuadër të KASH-it, treguesit i referohen kryesisht kornizës përkatëse ligjore dhe metodës së përdorur për llogaritjen e buxhetit. Sipas analizës së mëparshme gjinore, mund të shtohet edhe një tregues tjetër: "rritja e numrit të grave që marrin pensione kontribut-paguese". Kjo mund të arrihet përmes ofrimit të informatave përmes organizatave të grave dhe masmedias në lidhje me të drejtat e personave për të pasur qasje në këtë pension. Ndoshta do të nevojiten fonde shtesë për këtë aktivitet.

DEPARTAMENTI PËR PUNË DHE PUNËSIM

Zyrat e punësimit

Sipas analizës në kapitullin e fundit, mund të merren parasysh dy tregues nga ky departament për ZP-të:

- Rritja e proporcioneve të grave të regjistruara në ZP prej 46% në vitin 2014 në 49% në vitin 2017.
- Rritja e përqindjes së punëkërkuësve të punësuar prej 1.76% në vitin 2013 në 2% për çdo vit dhe rritja e proporcioneve të grave punëkërkuëse të punësuar nga 34% në 2013 në 5% për çdo vit, në 39% në 2014, 44% në 2015, 49% në 2016, dhe 50% më tutje.

Aktivitetet për t'i arritur këto qëllime kanë të bëjnë me bashkëpunimin me organizatat e grave për t'i inkurajuar më shumë gra që të regjistrohen në ZP. Ndoshta do të nevojiten fonde shtesë për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Pushimi i lehonisë

Tabela 73 e paraqet buxhetin e shpenzuar të MPMS-së për pushimin e lehonisë në Kosovë prej vitit 2011 deri në mars të vitit 2014. Buxheti është rritur për çdo vit. Megjithatë, po që se do të merreshin për bazë statistikën e publikuar nga ASK për pagën mesatare, buxheti i ndarë dhe i shpenzuar do të duhej të ishte 28% më i lartë në vitin 2013.

Në vitin 2014, buxheti i planifikuar për pushimin e lehonisë është €900,000, dhe paga mesatare e përdorur nga MPMS-ja, sipas të dhënave të muajit janar 2015, do të jetë €375 (shih tabelën 73). Buxheti i planifikuar për vitin 2014 duhet të ketë qenë 25% më i lartë për periudhën janar-mars 2014. Numri i përfituesve është rritur, dhe si rrjedhojë edhe buxheti duhet të rritet. Në bazë të trendeve nga viti 2012 deri 2013, numri i përfituesve do të rritet për 13%. Andaj, buxheti për 2015 duhet të jetë €805,091. Kategoria e subvencioneve dhe e transfereve në DPP duhet të rritet për ta realizuar këtë.

Tabela 73. Buxheti real i pushimit të lehonisë krahasuar me nevojat buxhetore të vlerësuara nga RrGGK, bazuar në pagën mesatare nga ASK, sipas vitit

Viti	Buxheti total i shpenzuar ¹⁶²	Vlerësimi i RrGGK për buxhetin e përgjithshëm sipas pagës mesatare të publikuar nga ASK ¹⁶³	Dallimi në buxhetin e përgjithshëm	Dallimi në %
2011	€205,860	€ 259,440	-€ 53,580	-26%
2012	€493,188	€ 628,308	-€135,120	-27%
2013	€556,260	€ 712,470	-€156,210	-28%
2014 (mars)	€211,992			

Numri i përfituesve të pushimeve të lehonisë, dhe si rrjedhojë edhe buxheti i nevojshëm, do të rriteshin nëse të gjitha gratë e punësuara, të cilat kanë lindur do ta shfrytëzonin këtë beneficion. Nuk dihet numri i punonjësve gra, të cilat lindin për çdo vit, andaj nuk mund të llogaritet buxheti i saktë. Planifikimi efektiv i buxhetit mund të ndihmohej prej Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës dhe ASK-së përmes mbledhjes së të dhënave dhe raportimit të statusit të punësimit të nënave që lindin. Inspektorati i Punës i Kosovës mund t'i rrit po ashtu inspektimet për t'u siguruar që gratë që duhet të përfitojnë nga pushimi i lehonisë ta bëjnë një gjë të tillë, dhe se ato nuk do të ballafaqohen me diskriminim gjatë procesit të punësimit për shkak të shtatzënisë. Zbatimi i duhur i beneficioneve të pushimit të lehonisë është me rëndësi për t'ju mundësuar grave që të punojnë dhe të kenë familje. Në të njëjtën kohë, siç edhe është diskutuar në kapitullin paraprak, pushimi atësor duhet të kihet parasysh në kuadër të Ligjit të ri të punës për ta arritur një barazi gjinore.

Aftësimi profesional

Sa i përket QAP, në bashkëpunim të ngushtë me QRP, mund të shtohen disa tregues për përmirësimin e barazisë gjinore:

- Rritja e përqindjes së punëkërkuarve të regjistruar gra dhe burra të përfshirë në trajnime prej 1% në së paku 5% në vit, duke arritur në 6% në vitin 2015, 11% në 2016 dhe 16% në 2017.
- Rritja e numrit të grave dhe burrave që marrin ndihmë sociale nga kategoria e dytë dhe që marrin pjesë në trajnimet e QAP-së dhe pranojnë ndihmë për sigurimin e një vendi të punës.

¹⁶² MPMS-ja nuk e vuri në dispozicion shumën reale të shpenzuar

¹⁶³ Llogaritjet e RrGGK bazohen në pagën mesatare në Kosovë të publikuar nga ASK, prill 2014.

- Rritja e numrit të grave pjesëmarrëse në trajnime nga 44% në 2013 me 1% çdo vit, deri sa pjesëmarrja e grave të arrij në 50%.
- Hartimi i strategjisë së komunikimit për t'i informuar gratë, në veçanti, lidhur me mundësitë e trajnimit.
- Përfshirja e temave të reja, të llojllojshme të trajnimit me interes, si për gratë, ashtu edhe për burrat në mënyrë që të kualifikohen për nevojat e tregut aktual të punës.
- Kryerja e analizave sa i përket arsyeve të braktisjes së lartë, duke përfshirë atë në baza gjinore. Kjo do të nënkuptonte që personeli i QAP-së të realizonte thirrje telefonike me personat që e kanë braktisur trajnimin me qëllim që të identifikohen shkaqet pse, dhe të futen ato të gjetura në një bazë të dhënash, dhe të raportohen pastaj të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë për çdo vit.
- Rënia e përqindjes së grave (16%) dhe burrave (7%) për shkak të braktisjes së trajnimeve në më pak se 5% për secilin vit për të dy gjinitë.
- Hartimi i raporteve që merren me vlerësimin e kostos së trajnimeve për lloje të ndryshme të trajnimeve.
- Hartimi i raporteve për analizimin e nevojave të grave dhe burrave të papunësuar, dhe vlerësimi i shkallës së përmbushjes së nevojave të tyre nga këto trajnime.

Ndoshta duhet të ketë ndryshime të buxhetit për ta arritur përmbushjen e këtyre treguesve.

Tabela 74. Vlerësimi i RrGGK per buxhetin e QAP për 2015-2017, bazuar në shpenzimet dhe trendet 2012-2013

Expense	2012 – të shpenzuara	2013 - të shpenzuar	2014 Buxhet	2015 Buxhet	2016 Buxhet	2017 Buxhet
Total	€ 1,448,510 (71%)	€ 1,675,251 (75%)	€1,769,426	€2,013,473 (-€10,000)	€2,048,473 (-€10,000)	€2,188,473 (-€10,000)
Paga dhe mëditje	€ 395,114 (104%)	€ 401,410 (102%)	€ 416,189	€ 520,236	€ 520,236	€ 520,236
Mallra dhe shërbime	€ 352,608 (112%)	€ 288,726 (91%)	€ 316,237	€ 316,237	€ 316,237	€ 316,237
Komunali	€ 46,155 (74%)	€ 50,387 (81%)	€ 62,000	€ 52,000 (-€10,000)	€ 52,000 (-€10,000)	€ 52,000 (-€10,000)
Subvencione dhe Transfere	€ 351,512 (78%)	€ 319,833 (78%)	€ 300,000	€ 450,000	€ 750,000	€ 870,000
Shpenzime kapitale	€ 303,122 (57%)	€ 614,896 (30%)	€ 675,000	€ 675,000	€ 410,000	€ 430,000

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK). *Projeksionet e Popullatës së Kosovës 2011-2016*. Prishtinë: ASK, 2013. Në: http://ask.rks-gov.net/ENG/publikimet/doc_view/1126-kosovo-population-projection-2011-2016?tmpl=component&format=raw.
- _____. *REKOS 2011*. Prishtinë: ASK, 2011. Në: [http://census.rks-gov.net/istarMDEE/MD/dawinciMD.jsp?al=yC&a2=mF0&n=1UR906\\$\\$\\$\\$\\$26&o=&v=1UR060HN00V7000000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0](http://census.rks-gov.net/istarMDEE/MD/dawinciMD.jsp?al=yC&a2=mF0&n=1UR906$$$$$26&o=&v=1UR060HN00V7000000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0).
- _____. *Statistikat e lindjeve në Kosovë në vitin 2010*. Prishtinë: ASK, 2011. Në: http://ask.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat_view/8-population/80-births.
- _____. *Kumtesë për Media. "Kosova në shifra 2012." 12 Qershor 2013*. Në: <http://ask.rks-gov.net/zyra-e-shtypit/602-komunikate-per-media-kosova-ne-shifra-2012>.
- Farnsveden, Ulf, Ariana Qosaj-Mustafa, and Nicole Farnsworth për Orgut. *Profili Gjinator i Vendit*. Prishtinë: Sida, 2014.
- HMO Solutions. *Shërbimi Social në Kosovë: Vlerësim Ligjor dhe Buxhetor. Mbështetur nga Save the Children Alliance në Kosovë*. Në: http://resourcecentre.savethechildren.se/sites/default/files/documents/2007_august_social_services_in_kosovo_legal_and_budget_assesment_report1.pdf.
- International Labour Organization, ILO Bureau for Gender Equality. *Overview of gender-responsive budget initiatives*. 2006. Në: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/publication/wcms_111403.pdf.
- _____. *C 081 – Konventa e Punës për Inspektim (No. 81)*. Gjenevë: ILO, 1947. Në: http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO:12100:P12100_INSTRUMENT_ID:312226:NO.
- Këshilli i Evropës. *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*. Romë: 1950.
- Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës (KSK). *"Raport i KSK mbi punën e strehimoreve dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje, si edhe për angazhimet e KSK në realizimin Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje për vitin 2012"*. Prishtinë: 2013.
- Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave. *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*. 1978. Në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>.
- Komisioni Evropian. *Strategjia Evropiane mbi Aftësinë e Kufizuar 2010-2014*. Në: http://ec.europa.eu/justice/discrimination/disabilities/disability_strategy/index_en.htm.
- Kombet e Bashkuara, *Konventa për të Drejtat e Fëmijës*. 1989. Në: <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>.
- _____. *Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave. Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave*. Në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>.
- Konferenca ndërkombëtare: *"Buxhetimi i përgjegjshëm gjinator: sfidat dhe praktikat"*. 2011. Në: <http://helvetas-ks.org/wp/wp-content/uploads/2011/10/GRB-Conference.pdf>.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. 2008. Në: <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>.
- _____. *Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për Fondin Pensional të Kosovës për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/35, ligji nr. 03/L-084*. 2008. Në: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji_2008_03_L084_en.pdf.

- _____. Ligji për personat e verbër, Ligji nr. 04/L-092. 2012. Në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20for%20blind%20%20persons.pdf>.
- _____. Ligji për fondet pensionale të Kosovës, ligji nr.04/L101. 2012. Në: <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Ligji%20per%20Fondet%20Pensionale.pdf>.
- _____. Ligji nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave të dhunës seksuale të luftës, dhe viktimave civile dhe familjeve të tyre. 2014. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-172%20a.pdf>.
- _____. Ligji kundër diskriminimit, ligji nr. 2004/3. 2004. Në: http://www.unmikonline.org/regulations/2004/re2004_32ale04_03.pdf.
- _____. Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, ligji nr. 2003/33. 2003. Në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_23_en.pdf.
- _____. Ligji për barazi gjinore, ligji nr. 2004/2. 2004. Në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130510160346132.pdf>.
- _____. Ligji për përkrahjen materiale për familjet e fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuar, ligji nr. 03/L-022. 2008. Në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/PrimarAnglisht/LAW%20ON%20MATERIAL%20SUPPORT%20FOR%20FAMILIES%20OF%20CHILDREN%20WITH%20PERMANENT%20DISABILITY.pdf>.
- _____. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ligji nr. 03/L-048. 2009. Në: www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56-LAW_NO.
- _____. Ligji i Punës, Ligji Nr. 03/L-212. 2010. Në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>.
- _____. Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, ligji nr. 2003/15. 2003. Në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_15_en.pdf.
- _____. Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, ligji nr. 02/L-17. 2005. Në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf.
- _____. Ligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, ligji nr. 03/L-100. 2008. Në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/PrimarAnglisht/Law%20No.03%20L-100%20ON%20THE%20PENSIONS%20FOR%20KOSOVO%20PROTECTION%20CORPS%20MEMBERS.pdf>.
- _____. Ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK, Ligji nr. 04/L-084. 2012. Në: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Ligji_Per_Pensionet_e_Pjesetareve_te_Forces_se_Sigurise_se_Kosoves.pdf.
- _____. Ligji për regjistrimin dhe evidentimin e të papunësuarve dhe punëkërkuesve, ligji nr. 04/L-083. 2012. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20for%20registration%20and%20records%20of%20unemployed%20and%20job%20seekers.pdf>.
- _____. Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, ligji nr. 04/L-054. 2012. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20status%20of%20the%20martyrs%20of%20war.pdf>.
- _____. Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, në *Gazetën Zyrtare të Republikë së Kosovës, nr. 34*. 2013. Në: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji_kunder_trafikimit_Anglisht.pdf.

- _____. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, ligji nr. 04/L-233. 2013. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20budget%20of%20Kosovo%202014.pdf>.
- _____. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji nr. 04/L-218. 2013. Në: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji_kunder_trafikimit-Anglisht.pdf.
- _____. Rregullorja Nr. 02/2011 mbi Fushat e Përgjegjësish Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive. 2005. Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miratuuar_nga_Qeveria-finale.pdf. Ministria e Financave Shqipërisë. *Iniciativa e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, doracak*. Shqipëri: UNDP.
- Palairt, Michael for European Stability Initiative, Lessons Learned and Analysis. *Trepca 1965-2000*, ESI/LLA. 2003. Në: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf.
- Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave. *Qarkorja buxhetore 2014/01*. 2014.
- _____. Ministria e Forcave të Sigurisë (MFS). *Të drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore në MFS/FSK*. 2013.
- _____. Ministria e Punëve të Brendshme. *Strategjia nacionale dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2011-2014*. maj 2011. Në: <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/TQNJAnglisht.pdf>.
- _____. Vendimi i Qeverisë 01/176. 2014. Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_176-te_te_Qeverise_2014.pdf.
- _____. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, *Strategjia sektoriale 2009-2013*. MPMS. 2009. Në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Aktiviteti%20javor/Strategjia%20Sektoriale%20MPMS-se%202009-2013%20Ang.pdf>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, *Strategjia Sektoriale 2014-2020*, Prishtinë: 2014.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, *Udhëzimi administrativ nr. 15/2009, për rritjen e pensioneve për zbatimin e vendimit të qeverisë nr. 02/51*. 2009. Në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.15-2009%20Për%20Rritjen%20e%20pensioneve%20për%20zbatimin%20e%20Vendimit%20të%20Qeverisë%20Nr.02-51.pdf>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, DPP. Raporti i performancës, raporti vjetor 2011. Prishtinë: DPP, 2012.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, DPP. Raporti i performancës, raporti vjetor 2012. Prishtinë: DPP, 2013.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, DPP. Raporti i performancës, raporti vjetor 2013. Prishtinë: DPP, 2014.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Udhëzimi Administrativ për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave administrative të pagesës financiare për pushimin e lehonisë, U.A. Nr.05/2011. 2011. Në: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.05-2011%20Për%20Rregullimin%20dhe%20Përcaktimin.pdf>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Udhëzimi për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Udhëzimi administrativ nr. 07/2011. 2011. Në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7980>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Udhëzim për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore – ngecje të zhvillimit mendor, në institutin special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, Udhëzimi administrativ nr.

- 06/2011. 2011. Në: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20nr.06-2011.pdf>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Udhëzim për pensionim të parakohshëm për punëtorët e kompleksit “Trepça”, dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë, Udhëzimi administrativ nr. 10/2007. 2007. Në: : <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.10-2007%20Për%20Pensionim%20të%20Parakohshëm%20për%20Punëtorët%20e%20Kompleksit%20TREPCA.pdf>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Udhëzim për vlerësimin dhe ekzaminimin e shkallës së invaliditetit të invalidit civil dhe invalidit të luftës <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8187>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Udhëzimi Administrativ No 01/2006 mbi themelimin e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare. 2006. Në: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.01-2006%20On%20Establishment%20of%20General%20Council.pdf>.
- _____. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Udhëzimi administrativ, nr.05/2006 për themelimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim. 2006. Në: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.05-2006%20On%20Establishment%20of%20the%20Panel%20for%20Placing%20Childre.pdf>
- _____. Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara i Republikës së Kosovës 2009-2011. Në: http://www.cooperazioneallosviluppo.esteri.it/pdgcs/italiano/iniziative/pdf/Kosovo_Plan.pdf.
- _____. Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore, *Programi i Kosovës kundër dhunë në familje dhe plani i veprimit 2011-2014*. 2011. Në: <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>.
- Ramosaj, A. Challenges in implementation of the maternity leave in Kosovo. University of Munich: 2012. Munich Personal RePREc Archive. Në: <http://mpr.ub.uni-muenchen.de/38913/>.
- Rosenthal, Eric., & Szeli, Eva. Human Rights of People with Disability in Kosovo. *Mental Disability Rights International*. 2005. Në: <http://www.disabilityrightsintl.org/wordpress/wp-content/uploads/KosovoReport.pdf>.
- RrGGK, *Me çfarë çmimi? Buxhetimi për zbatimin e kornizës ligjore kundër dhunës në familje në Kosovë*, Prishtinë: UNDP, 2012. Në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130211130931258.pdf>
- _____. *1325 fakte dhe fabula*. Prishtinë: RrGGK, 2011. Në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130120165559661.pdf>.
- Surtees, Rebecca for UNIFEM. *Women at Work: The economic situation and opportunities for women in Kosovo*. Prishtinë: UNIFEM. 2000.
- United Nations General Assembly. Convention on the Rights of Persons with Disabilities, 2007. Në: <http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>.
- _____. The Universal Declaration of Human Rights, United Nations. Në: <http://www.un.org/en/documents/udhr/1948>.
- UNDP. *Vlera Reale e Asistencës Sociale: një Vlerësim i Mjaftueshmërisë së Asistencës Sociale*. Prishtinë: UNDP, 2014. Në: <http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Communications/Dokumenti%20The%20Real%20Value%20of%20Social%20Assistance%20ONLINE.pdf>.
- UNIFEM. *GRB South Eastern European Experiences*. 2010.

World Bank, Kosovo Public Expenditure Review, Report No. 53709-XK. Poverty Reduction and Economic Management Unit. 2010.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: BUXHETIMI I PËRGJEGJESHËM GJINOR: NJË UDHËRRËFYES PRAKTIK PËR PËRDORUES¹⁶⁴

Baza ligjore

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) është dokumenti kryesor i planifikimit për politikat ekonomike të qeverisë. Qeveria e Kosovës e përgatit KASH-in në përputhje me vizionin e zhvillimit kombëtar, i cili përfshin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit; zhvillimin e kapitali njerëzor; dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.¹⁶⁵ Qeveria e Kosovës duhet ta integrojë aspektin gjinor në planifikimin, implementimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha ligjeve, strategjive dhe politikave si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.¹⁶⁶ Këtu përfshihen edhe proceset buxhetore. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) prezanton një qasje përmes të cilës perspektiva gjinore mund të integrohet në proceset buxhetore.


Pse është i rëndësishëm Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor?

BPGJ përfshinë një proces përmes të cilit prezantohen në buxhet qëllimet strategjike drejt përforcimit të barazisë gjinore. Kjo mund të rris transparencën, efektivitetin e shpenzimeve publike, dhe monitorimin e zbatimit. Procesi i analizës së BPGJ mund të ndihmojë për të kuptuar nëse gratë dhe burrat, ose grupet e ndryshme të burrave dhe grave, përfitojnë nga shpenzimet publike; sa efektive janë alokimet buxhetore në trajtimin e nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave; sa efektiv është zbatimi i politikave dhe i buxhetit në arritjen e qëllimeve gjinore; dhe sa mund të ndikojë (pa)barazia gjinore në arritjen e këtyre qëllimeve. Për më tepër, zyrtarët buxhetor, departamentet buxhetore dhe institucionet në nivel komunal dhe qendror mund ta përdorin BPGJ për t'i arsyetuar nevojat buxhetore të departamenteve të tyre dhe për të komunikuar më mirë me institucionet apo akterët e tjerë, përfshirë këtu edhe Ministrinë e Financave.

Qasja e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor¹⁶⁷

BPGJ mund të zbatohet me anë të një qasje të thjeshtë prej tre hapash, përmes të cilës perspektiva gjinore mund të përfshihet në proceset dhe dokumentet buxhetore (shih figurën 1).

Figura 1. Qasja me tre hapa drejt BPGJ



¹⁶⁴ Ky udhërrëfyes është zhvilluar nga Ada Shima dhe Nicole Farnsworth në RrGGK, në bashkëpunim me Dr. Elisabeth Klatzer, eksperte ndërkombëtare, për të mbështetur institucionet e Kosovës në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Për më tepër informacion ose asistencë në përdorim të këtij udhërrëfyesi, luteni të na kontaktoni në info@womensnetwork.org ose 038 245 850.


¹⁶⁵ Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015, Prishtinë, Prill 2012: në: <http://mf.rks-gov.net/Portals/0/Raporte%20dhe%20publikime/KASH/KASH%202013-2015%20aprovuar%20ne%20Qeveri%20ANGL.pdf>.

¹⁶⁶ Republika e Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji 2004/2, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130510160346132.pdf>.

¹⁶⁷ Kjo qasje bazohet në praktikat ndërkombëtare të BPGJ dhe është adoptuar për kontekstin e Kosovës nga Dr. Elisabeth Klatzer, eksperte ndërkombëtare, në bashkëpunim me RrGGK.

Në hapin 1, analiza BPGJ ka për qëllim t'i kuptojë çështjet dhe hendekun gjinor. Figura 2 nënvizon aspektet themelore për kryerjen e kësaj analize.

Figura 2. Kuptimi i çështjeve gjinore dhe zhvillimi i qëllimeve



Në bazë të analizës së situatës së grave dhe burrave në sektorët specifik, bëhet edhe analiza e numrit të përfituesve gra dhe burra në një program të caktuar (p.sh. nga shërbimet publike ose transferet) në departamentet apo projektet e ministrisë dhe/ose komunës. Kjo ndihmon në identifikimin e dallimeve mes numrit të përfituesve apo pjesëmarrësve gra dhe burra në programe të caktuara. Në hapin e radhës identifikohen alokimet buxhetore dhe kostot për shërbimet e caktuara. Sipas kësaj, mund të përlogaritet shuma e buxhetit të shpenzuar prej të cilit kanë përfituar burrat dhe gratë. Ky mund të jetë themeli i analizës që nxjerr në pah nëse ka ndonjë hendek të dukshëm se si shpenzimet ndikojnë në rritjen e barazisë mes grave dhe burrave. Tabela e mëposhtme ilustron një shembull se si mund të mblidhen të dhënat për përfituesit gra dhe burra, dhe si të identifikohet ndonjë hendek potencial gjinor në alokimet buxhetore (shih figurën 3). Mbledhja e të dhënave për vite të ndryshme ndihmon paraqitjen e ndryshimeve në numrin e përfituesve ndër vite.

Figura 3. Shabllon për Analizën e Rasteve të BPGJ

Lloji i shërbimit apo transferet	Buxheti total	Numri total i përfituesve	Buxheti për kapita	Numri i përfituesve		Buxheti i shpenzuar për gra	Buxheti për capita gra	Buxheti i shpenzuar për burra	Buxheti për capita burra
				gra	burra				
Shërbimi A									
Shërbimi B									
...									

Përpos analizës sasiore është e rëndësishme të identifikohen nevojat, interesat dhe prioritetet e grupeve të ndryshme të përfituesve, p.sh. duke i pyetur në fokus grupe me pyetësorë. Gjithashtu, është e rëndësishme që në vlerësimin e programeve apo shërbimeve të përfshihen edhe përfituesit. Gjatë analizës duhet t'i kushtohet kujdes identifikimit të akterëve të përfshirë në vendimmarrjen për llojet e programeve dhe kush përfiton nga këto shërbime apo transfere.

Në Hapin 2 të qasjes BPGJ, dhe bazuar në rezultatet e analizës, duhet të hartohen apo ndryshohen qëllimet dhe aktivitetet për trajtimin e ndonjë hendeku të identifikuar gjinor. Po ashtu, duhet të hartohen treguese në bazë të qëllimeve për barazi gjinore.

Hapi 3 i BPGJ e hedh vëmendjen te integrimi i perspektivës gjinore në proceset dhe dokumentet buxhetore. Kjo mund të bëhet si më poshtë:

1. Përgatitja e një paragrafi që i përshkruan rezultatet e analizës së BPGJ, i cili përfshihet në KASH dhe/ose dokumente buxhetore;
2. Përcaktim i qëllimeve dhe aktiviteteve për përmirësimin e barazisë gjinore;
3. Përcaktimi i treguesve specifik për të matur progresin për arritjen e qëllimeve të përcaktuara për barazi gjinore;
4. Zbërthimi apo ndarja e cilitdo tregues që ka të bëjë me njerëz të mund të bëhet sipas kategorisë së grave dhe burrave.

SHTOJCA 2: BUXHETI PËR FINANCIM TË QPS-VE SIPAS KOMUNAVE DHE PËRFITUESIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE SIPAS GJINISË

Komuna	Viti	Nr. totali përfituesve	gra	burra	Nr. total i vizitave	gra	burra	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
Gjilan	2011	648	126	522	2,592	504	2,088	€ 70,396	€ 12,998	€ 3,995		
	2012	926	160	865	3,704	640	3,460	€ 78,771	€ 12,773	€ 4,980		
	2013	818	180	638	3,272	720	2,552	€ 77,366	€ 10,000	€ 3,150		
	2014	249	50	199	996	200	796	€ 11,272	€ 2,117	€ 1,788		
	2015 (plane)											
Deçan	2011	668	280	388	700	500	200	€ 3,397	€ 4,000			
	2012	626	300	326	680	300	380	€ 3,397	€ 4,000			
	2013	681	250	431	690	300	390	€ 3,397	€ 4,000			
	2014	255	100	155	270	170	100	€ 4,172	€ 3,400			
	2015 (plane)											
Dragash	2011	48	18	30	74	28	46	€ 37,005	€ 8,910	€ 3,000		
	2012	52	19	33	93	39	54	€ 41,700	€ 8,000	€ 3,000		
	2013	46	18	28	81	45	36	€ 41,700	€ 10,000	€ 3,000		
	2014	21	7	14	27	11	16	€ 40,700	€ 10,000	€ 3,000		
	2015 (plane)											
Drenas / Gillogoc	2011	834	350	484	1,236	432	804	€ 66,500	€ 18,000	€ 3,900		
	2012	1,185	414	771	1,662	548	1,114	€ 66,500	€ 16,880	€ 400		€ 25,000
	2013	765	267	498	1,071	353	718	€ 66,500	€ 21,800	€ 4,300		
	2014	442	154	288	618	197	421	€ 66,500	€ 20,700	€ 4,000		
	2015 (plane)											€ 20,000
Kaçanik	2011	251	80	171	298	100	198	€ 31,186	€ 3,000	€ 3,000	€ 37,186	
	2012	360	110	250	400	130	270	€ 31,186	€ 3,000	€ 3,000	€ 37,186	
	2013	257	117	144	290	140	150	€ 31,186	€ 3,000	€ 3,000	€ 37,186	
	2014	114	50	64	105	70	35	€ 38,982	€ 3,000	€ 3,000	€ 44,982	
	2015 (plane)	380	180	200	400	190	210	€ 42,880	€ 3,800	€ 3,800	€ 50,480	
Podujevë	2011	456	142	313	790			€ 43,000	€ 8,000	€ 5,000		
	2012	750	164	586	1,138			€ 54,000	€ 8,000	€ 5,000		
	2013	728	183	544	1,071			€ 54,186	€ 28,000	€ 5,000		
	2014	58	15	43	226			€ 55,000	€ 20,000	€ 8,000		
	2015 (plane)							€ 58,000	€ 21,000	€ 8,000		€ 20,000
Shtime	2011	221	66	155	258	78	180	€ 35,444	€ 10,000	€ 2,500		
	2012	320	103	217	612	196	416	€ 39,100	€ 10,500	€ 3,500		
	2013	316	104	212	621	205	416	€ 40,371	€ 12,800	€ 2,700	€ 7,500	
	2014	200	54	146	273	54	146	€ 45,000	€ 12,800	€ 2,700	€ 29,000	
	2015 (plane)							€ 45,000	€ 15,000	€ 2,800	€ 35,000	€ 10,000
Skender	2011	259	111	148	84	55	29	€ 69,263	€ 8,600	€ 5,500		

Komuna	Viti	Nr. totali përfituesve	gra	burra	Nr. total i vizitave	gra	burra	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
aj	2012	666	319	347	94	61	33	€ 72,454	€ 8,000	€ 5,000		
	2013	549	243	306	158	109	49	€ 70,800	€ 18,500	€ 5,000	€ 7,000	
	2014	140	65	75	52	27	25	€ 70,250	€ 18,500	€ 8,500		
	2015 (plane)	430	205	225	255	132	123	€ 73,762	€ 19,000	€ 8,900		
Suharekë / Therandër	2011	322	96	226	98	32	66	€ 52,030	€ 12,974	€ 3,000		
	2012	573	179	394	142	56	86	€ 54,946	€ 12,954	€ 3,000		
	2013	477	145	332	96	52	44	€ 52,520	€ 13,000	€ 2,561		
	2014	524	159	365	105	57	48	€ 55,000	€ 13,000	€ 3,000		
	2015 (plane)	576	175	401	116	63	53	€ 60,000	€ 15,000	€ 3,500		
Viti	2011	1,292	495	797	2,394	961	1,433	€ 38,854	€ 2,500	€ 2,200		
	2012	1,250	475	775	2,548	998	1,550	€ 40,303				
	2013	1,284	463	821	2,160	742	1,418	€ 40,303				
	2014	779	238	541	460	210	250	€ 10,076				
	2015 (plane)	1,350	950	400	2,625	1,025	1,600	€ 54,036				
Kamenicë/Dardanë	2011	275	116	177	550	230	320	€ 59,934	€ 8,000	€ 3,000		
	2012	377	104	273	754	208	546	€ 59,934	€ 8,000	€ 3,000		
	2013	428	112	328	856	200	656	€ 59,728	€ 1,200	€ 5,000		
	2014	107	29	86	214	58	156	€ 59,728	€ 1,200	€ 5,000		
	2015 (plane)											
Istog	2011	241	93	148	180	72	108					
	2012	578	219	359	529	249	280	€ 454,356	€ 5,000	€ 1,810		
	2013	505	181	324	456	202	254	€ 454,356	€ 11,739	€ 2,078		
	2014	212	84	132	140	52	88	€ 53,800	€ 9,000	€ 2,000		
	2015 (plane)							€ 55,683	€ 9,315	€ 2,070		
Fushë Kosovë	2011	253	33	132	330	108	210	€ 2,219	€ 267,030	€ 123,806	€ 73,476	
	2012	501	82	251	660	164	230	€ 827,567	€ 118,613	€ 36,743	€ 199,415	
	2013	325	62	223	570	124	251	€ 827,567	€ 118,613	€ 36,743	€ 473,631	
	2014	151	12	63	75	75	71	€ 827,567	€ 118,613	€ 36,743	€ 69,565	
	2015 (plane)											
Ferizaj	2011	539	211	328	2,695	1,055	1,640	€ 52,480	€ 12,550	€ 7,500		
	2012	628	207	421	3,140	1,035	2,105	€ 61,733	€ 18,150	€ 6,000		
	2013	694	261	433	3,470	1,305	2,165	€ 61,733	€ 11,850	€ 3,500		
	2014	220	65	155	1,100	325	775	€ 68,558	€ 13,720	€ 4,700		
	2015 (plane)											
Lipjan	2011	272	80	192	407	94	313	€ 41,149	€ 12,000	€ 3,500		
	2012	583	102	181	611	125	486	€ 53,040	€ 10,000	€ 3,000		
	2013	378	77	301	542	112	542	€ 53,042	€ 20,000	€ 3,000		
	2014	312	68	144	280	72	280	€ 53,042	€ 15,000	€ 3,000		
	2015 (plane)	624	230	394	684	134	550	€ 65,062	€ 26,650	€ 5,150		€ 25,000
Pejë	2011	470	101	110				€ 77,048	€ 12,056	€ 9,200	€ 30,000	€ 15,000

Komuna	Viti	Nr. totali përfituesve	gra	burra	Nr. total i vizitave	gra	burra	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
	2012	456	150	203				€ 82,500	€ 25,000	€ 9,000	€ 30,000	
	2013	469	105	192				€ 86,000	€ 35,300	€ 7,200	€ 30,000	€ 30,000
	2014	129	3	7				€ 86,000	€ 35,300	€ 6,500	€ 30,000	€ 30,000
	2015 (plane)											
Vushtrri	2011	502	127	375				€ 34,000	€ 21,000	€ 4,500		
	2012	276	84	192				€ 48,843	€ 21,000	€ 4,500	€ 10,000	
	2013	437	108	329				€ 48,843	€ 21,000	€ 4,500		€ 5,000
	2014	44	8	36				€ 48,843	€ 21,000	€ 4,500		
	2015 (plane)							€ 60,660	€ 25,000	€ 3,500		€ 9,000
Prishtinë	2011	840	630	210	800	600	200	€ 190,000	€ 40,000	€20,000	€ 120,000	
	2012	800	600	200	800	600	200	€ 190,000	€ 40,000	€20,000	€ 120,000	€ 50,000
	2013	880	660	220	800	600	200	€ 190,000	€ 40,000	€20,000	€ 120,000	€ 50,000
	2014	920	690	230	800	600	200					
	2015 (plane)											

SHTOJCA 3: LLOJET E AFTËSIMEVE PROFESIONALE SIPAS QAP-VE NË KOMUNAT PËRKATËSE

Prishtinë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Mitrovicë	Gjakovë	Gjilan	Dolan
Asistent administrativ	Kuzhinier	Asistent administrativ	Zdrukthëtari	Zdrukthëtari	Bazat e kompjuterit	Zdrukthëtari - plastikë punues	Zdrukthëtari
Administrim biznesi	Kamerier	Kontabilist	Elektricitist	Kuzhinier	Kontabilitet	Bazat e kompjuterit	Kuzhinier
Servisim i pajisjeve të zërimit	Auto-elektricitist	Ndërtimtari	Saldues	Tekstil	Administrim biznesi	Dizajn grafik	Tekstil
Furrтари	Riparues i pajisjeve elektrike shtëpiake	Elektricitist	Hidro-instalues	Bazat e kompjuterit	Instalim elektrik	Kontabilitet	Bazat e kompjuterit
Pastiçeri	Hidraulik	Bujqësi	Bazat e kompjuterit	Ndërtimtari	Saldues	Saldim	Administrim biznesi
Ndërmarrësi	Administrim biznes	Administrim biznesi	Administrim biznesi	Saldues	Vetëpunësim	Ndërmarrësi	Saldues
Instalues i ngrohjes qendrore	Elektricitist industrial	Ndërmarrësi	Ndërmarrësi	Administrim biznesi	Ndërmarrësi	Kuzhinier	
Hidraulik	Ndërmarrësi	Hidro-instalues	Kuzhinier	Bazat e kompjuterit			
Elektricitist industrial	Saldues	Kuzhinier	Shërbime				
TI dhe komunikim	Turizëm	Zdrukthëtari	Mirëmbajtës				
Ndërtimtari	Bazat e kompjuterit	Saldues					
Auto-elektricitist	Berber	Braj					
Kontabilist	Përpunim i qumështit						
Njësia mobile në Podujevë	Bazat e kompjuterit/ njësia mobile në /Dragash						

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

36.07(496.51)(048)

Shima, Ada

Buxheti drejt Mirëqenies Sociale : Analizë e shpejtë
gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm
gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë
/ Ada Shima, Nicole Fransworth. – Prishtinë : Rrjeti i Grupeve
të Grave të Kosovës, 2014. – 74 f. : ilustr. ; 21 cm.

Bibliografia : f. 64-67

1. Fransworth, Nicole

ISBN 978-9951-8848-5-3



ISBN 978-9951-8848-5-3



9

789951

884853